<i>Java 12:</i>	Ekulibrat acido-bazik, pufferet
<i>Java 13:</i>	Metodat titrimetrike I
<i>Java 14:</i>	Metodat titrimetrike II
<i>Java 15:</i>	Vlerësimi II

Politikat akademike dhe Kodi i Sjelljes

Afati kohorë për dorëzimin e detyrave është 7 nga dita kur ipen detyrat. Detyrat të cilat dorezohen me vonëse nuk do të vlerësohen me pike. Kuizet online do të organizohen brenda një intervallit kohorë 1 deri 2 orë brenda javës. Seminarët e zgjedhura duhet të dorëzohen deri në javën e 11 dhe të mbrohen para javës së 15. Ndalohet përdorimi nga ana e studenteve i telefonave celular, dhe të gjitha mjeteve tjera të teknologjise informatike si kompjutere laptop, tablet etj. Vetëm në rastet kur lejon mësimdhënësi. Telefonat mund të përdoren vetëm në rastet emergjente jashtë nga klasa me leje të mësimdhënësit. Studentet duhet të mbajnë qetesinë gjatë leksioneve. Studenti para se të filloj punën eksperimentale duhet të kuptoj qëllimin e eksperimentit dhe objektivat të cilat do të arrihen nga eksperimenti. Studenti vlerësohet nga asistenti për njohuritë e tij para se të filloj punën në laborator dhe kalueshmëria është kusht për zhvillimin e eksperimentit. Mos respektimi i rregullave rezulton me përjashtim nga mundësia e hyrjes në provim pefundimtar.

8. Anatomia

Informatat themelore për lëndën	
Njësia akademike:	Fakulteti i Mjekësisë
Titulli i lëndës:	Anatomia
Niveli:	Studime themelore te integruara
Statusi i lëndës:	I obligueshëm
Viti i studimeve:	Viti i I-rë Semestri i II-të
Numri i orëve në javë:	Ligjerata: 2 Ushtrime praktike: 2 2+0+2
Kreditë ECTS:	4 ECTS
Koha / Vendi:	Instituti i Anatomisë Sipas orarit
Mësimdhënësi:	Prof. dr Sadi Bexheti Prof. Ass.dr. Afrim Shabani Prof. Ass.dr. Premtim Rashiti Prof. Ass.dr. Jeton Shatri Ass.Dr. Alije Keka Sylaj Ass.Dr. Atifete Ramosaj Morina Ass.Dr. Zgjim Limani
Të dhënat kontaktuese:	Shefi i katedrsadrës Prof. dr Sadi Bexheti sadi.bexheti@uni-pr.edu Tel. 038 500 600 ex 2031 Zv. Shefi i katedrës Prof. Ass.dr. Jeton Shatri jeton.shatri@uni-pr.edu Sekretari i katedrës Ass.Dr. Alije Keka-Sylaj alije.keka@uni-pr.edu
Përshkrimi i lëndës:	Lënda e Anatomisë do të ofrojë studentëve njohuri mbi ndërtimin anatomik të trupit të njeriut në funksion të arritjes së njohurive të domosdoshme për ndërtimin trupor të tyre. Këto njohuri do të mundësojnë kuptimin e lokalizimit të indeve, organeve dhe sistemeve të ndryshme të organeve. Ndërtimin e detajuar anatomikë të organeve dhe sistemeve të organeve si bazë themelore e domosdoshme për kuptimin e mëtutjeshëm e më të detajuar të funksionit, ndërtimit histologjikë, ndryshimet patologjike, rëndësinë klinike, radiologjike, kirurgjike, ortopedike, etj që do të plotësohet nga lëndët e tjera.
Qëllimet e lëndës:	Qëllimet e lëndës së Anatomisë janë të ofroj studentëve njohuri nga: a) Anatomia normale (forma dhe ndërtimi i organizmit të njeriut, duke filluar nga qeliza, indet, organet dhe sistemet e organeve) b) Anatomia topografike e trupit të njeriut; ndarja e tij në zona (regjione), raportet topografike të tija me organet dhe elementet vaskulare e nervore, projektimin e tyre në sipërfaqen e trupit duke u bazuar në pikat dhe vijat orientuese të prekshme dhe ato konvencionale

	<p>c) Anatomia funksionale; ndërlihdja e formës së organit dhe sistemit të organeve me funksionin,</p> <p>d) Anatomia klinike; problemet më të shpeshta klinike me të cilat atakohet organi dhe organizmi në terësi si dhe rugët më të sigurta të ndërhyrjes për eliminimin e tyre</p> <p>e) Të përvetësojë emërtimet latine sipas terminologjisë anatomike (nomenklaturës anatomike 1998) që do tju mundësojë komunikimin në mënyrë efektive/adekuate me kolegët e tyre.</p>
Rezultatet e pritshme të nxënies:	<p>Pas përfundimit të mësimit studenti duhet të jetë në gjendje të:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Kuptojnë qëllimin e studimit të anatomisë 2. Përshkruaj karakteristikat themelore anatomike 3. Kenë njohuri të përgjithshme mbi qelizat, indet dhe sistemet funksionale të organeve 4. Njohin ndarjen e Anatomisë; pjesët kryesore të trupit të njeriut, regjionet, vijat orientuese dhe pikat referente, pozicionin dhe planet/rrafshet anatomike, nomenklaturën anatomike 5. Njohin ndërtimn dhe rëndësinë e sistemeve të organeve të ndryshme, siç janë: sistemi osteomuskular, kardiovaskular, sistemi respirator, sistemi digjektiv, sistemit urinar, sistemi i organeve gjinore mashkullore dhe femerore, sistemin endokrin, 6. Kuptojnë metodën e studimit që do të përdoret dhe mënyrën se si lënda është e organizuar.

Obligimet e studentit (duhet të jetë në përputhje me Rezultatet e Nxënies të studentit)

Aktiviteti	Orë mësimore	Ditë/Javë	Gjithsej
Ligjëratat	2	1/15	30
Teori/Punë në laborator/Ushtime	2	1/15	30
Punë praktike			
Konsultime me mësimdhënësin	1	1/8	8
Puna në terren			
Testi, punimi seminarik			
Detyrë shtëpie			
Mësimi individual (në bibliotekë apo në shtëpi)	2	1/15	30
Përgatitja për provimin final	1	1/15	10
Koha e vlerësimit (testi, kuizi, provimi final)	1 provim praktik 1 provim final	1 1	1 1
Projektet, prezantimet, etj.			
Total			100

Metodat e mësimdhënies:	<p>Mësimi do të realizohet në formë të: ligjëratave, seminareve dhe ushtrimeve praktike - të cilat mbahen në grupe të vogla, duke përdorë materiale të ndryshme, si imazhet nga atlaset, shfrytëzimit të modeleve (mulazhave) të ndryshme si dhe organeve të ruajtura në formalin.</p>
--------------------------------	--

	Prezantimi i temave/aktiviteteve nga ana e studentëve, përsëritja dhe diskutimet gjatë ushtrimeve praktike
Metodat e vlerësimit:	Me teste formative, seminare, provimi praktikë dhe provim final (me gojë dhe test).
Literatura primare:	<ul style="list-style-type: none"> • Alush Gashi, Agim Vela: Osteologjia, 1984 • Hilmi Dauti, Bajram Nuraj: Kombliku, 1995 • Bajram Nuraj: Sistemi nervor periferik, 1998 • Agim Vela: Abdomeni, 2001 • Agim Vela, Sadi Bexheti, Sistemi nervor qendror 1987 • Agim Vela, Bjram Nuraj, Koka dhe Qafa 2000 • Sadi Bexheti, Jeton Shatri me bp. Anatomia e Njeriut- gjymtyra e sipërme dhe e poshtme, 2019 • Sadi Bexheti, Jeton Shatri me bp. Anatomia e Njeriut- Osteologjia membrum suoerius dhe inferius, 2018
Literatura shtesë:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Putz R. Pabst R: Sobotta I, II 2. Bertolini / Leutert: Atlas i anatomisë I, II, III 3. Frank H. Netter: Atlas i anatomisë së njeriut 4. Gray's Anatomy for Student's
Hartimi i planit mësimor	
Java	Titulli i ligjëratës
<i>Java 1:</i>	Hyrje: Anatomia si shkencë dhe rëndësia e saj për studentët e farmacisë. Historiku i shkurtër i anatomisë. Vështrim mbi qelizat, indet dhe sistemet funksionale. Ndarja e anatomisë: pjesët kryesore të trupit të njeriut, vijat (rrafshet) orientuese. Nomenklatura anatomike.
<i>Java 2:</i>	Apparatus digestorius: Cavitas oris: muret dhe organet (dentes et lingua), Gll.oris (gll.salivariae majores et minores)
<i>Java 3:</i>	Pharynx, Oesophagus, Gaster, Duodenum.
<i>Java 4:</i>	Hepar. Rrugët biliare. Pancreas, Splen
<i>Java 5:</i>	Intestinum tenuae et intestinum crassum (caecum, appendix vermiformis, colon, rectum).
<i>Java 6:</i>	Apparatus respiratorius:

	Nasus externus, cavitas nasii et sinus paranasales. Larynx, gl.thyroidea, gll.parathyroideae
Java 7:	Cavitas thoracis: Thymus. Trachea et bronchi principales, pulmones et pleura
Java 8:	Apparatus urogenitalis: Ren. Rrugët urinare (calyces renales, pelvis renalis, ureter, vesica urinaria). Gl.suprarenalis
Java 9:	Organa genitalia masculina
Java 10:	Organa genitalia feminina
Java 11:	Systema cardiovasculare.Zemra (cor) et pericardium.
Java 12:	Enët e gjakut: arteriae, venae, systema lymphaticum
Java 13:	Systema nervosum: Sistemi nervor qendror; medulla spinalis, truncus encephali (medulla oblongata, pons, mesencephalon). Cerebellum
Java 14:	Diencephalon: ventriculus tertius, thalamus, hypothalamus. Hypophysis. Telencephalon, Ventriculus lateralis. Sistematizimi i rrugëve trurorë. Meninges. LCS. Bariera kematoencefalike
Java 15:	Nervat periferik:nn.spinales et nn.craniales Organa sensoria

Politikat akademike dhe Kodi i Sjelljes

Ora mësimore fillon dhe përfundon me kohë.

Studenti gjatë semestrit duhet të jetë i rregullt në ligjëratat dhe ushtrime, duhet ti përmbahet orarit të fillimit të mësimin, të ketë njohuri paraprake mbi ligjëratën/ushtrimin, të jetë i sjellshëm dhe të mos pengojë mbajtjen e mësimin.

Studentët duhet të kenë të veshur mantelat e bardhë dhe rekomandohet të kenë atlasat e anatomisë në dispozicion për ushtrimet praktike.

Mjetet praktike (mulazhat ose organat forma-kadaver) që përdorën gjatë orëve të mësimin duhet të pastrohen dhe të ruhen në fund të orës mësimore.

Telefonat mobil/të mençur dhe pajisjet tjera elektronike (p.sh. iPod-ët) duhet të fikën (apo të kurdisen në vibrim) dhe të mos ekspozohen gjatë orëve të mësimin.

Laptopët dhe kompjuterët tabletë lejohen të përdorën vetëm në heshtje dhe për qëllime mësimore-teorike dhe praktike; aktivitetet tjera siç janë kontrollimi i e-mailit personal apo shfletimi i ueb-faqeve në internet janë të ndaluara.

Shënim | Nëse 3 detyra të klasës të një studenti vlerësohen nën 50%, atëherë ai/ajo do ta humbë të drejtën që t'i nënshtrohet provimit final. Vlerësimi bëhet nga 0-100 %.

9. BIOLOGJI DHE GJENETIKË

Informatat themelore për lëndën	
Njësia akademike:	Fakulteti i Mjekësisë. Drejtimi: Farmaci
Titulli i lëndës:	Biologji dhe Gjenetikë
Niveli:	Studime themelore të integruara/BA
Statusi i lëndës:	Obligative
Viti i studimeve:	Viti i I-rë Semestri i II-të
Numri i orëve në javë:	2+0+2
Kreditë ECTS:	5 ECTS
Koha / Vendi:	Amfiteatër Sipas orarit
Mësimdhënësit:	Prof. Ass.Dr.Ramadan Sopi dhe Prof. Ass.Dr.Mentor Sopjani
Të dhënat kontaktuese:	ramadan.sopi@uni-pr.edu , mentor.sopjani@uni-pr.edu
Përshkrimi i lëndës:	Lënda biologjia me gjenetikë i trajton aspektet e caktuara të biologjisë, me theks të veçantë në biologjinë e qelizës, njohuri bazë mbi gjenetikën, dogmën qendrore të biologjisë molekulare dhe njohuri të përgjithshme nga mjedisi dhe ndotja e tij.
Qëllimet e lëndës:	<ul style="list-style-type: none"> - Njohja me strukturën dhe funksionin e qelizës dhe organeleve të saja. - Njohja me proceset metabolike në qelizë dhe organizëm, si: anabolizmi, katabolizmi, shkëmbimin dhe ruajtjen e energjisë. - Shtjellimi i ciklit qelizor dhe njohja me ndarjet qelizore – mitozën dhe mejozën. - Sqarimi i dogmës qendrore të biologjisë molekulare, organizimit të kromozomeve dhe ligjshmëritë e trashëgimisë.
Rezultatet e pritshme të nxënies:	<p>Pas përfundimit të kësaj lënde studentet do të jenë në gjendje të:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Kenë njohuri të duhura mbi organizimin molekular të së gjallës, organizimin e qelizave prokariote dhe eukariote, si dhe të demonstrojnë shkathtësi të duhura praktike laboratorike. - Kuptojnë organizimin e membranës qelizore dhe transporteve membranore.

	<ul style="list-style-type: none"> - Dinë për strukturën dhe funksionin e organeleve qelizore dhe të kenë aftësi të duhura demonstrimi praktik laboratorik. - Njohin proceset e qarkullimit të materies dhe rrjedhës së energjisë në qelizë. - Kuptojnë ndarjet qelizore dhe procesin e formimit të gameteve. - Tregojnë ndërtimin dhe rolin e ADN-së, ARN-së dhe kodit gjenetik, si dhe të kuptojnë rregullimin e ekspresionit të gjeneve dhe rëndësinë e tij. - Dinë mënyrën e trashëgimit të veçorive normale dhe mutante, si dhe njohin shkaktarët e sëmundjeve trashëguese të njeriu.
--	---

Obligimet e studentit (duhet të jetë në përputhje me Rezultatet e Nxënies të studentit)

Aktiviteti	Orë mësimore	Ditë/Javë	Gjithsej
Ligjëratat	2	1/15	30
Teori/Punë në laborator/Ushtime	2	1/15	30
Punë praktike			
Konsultime me mësimdhënësin	1	1/5	5
Puna në terren	-	-	
Testi, punimi seminarik	2	½	4
Detyrë shtëpie	-	-	
Mësimi individual (në bibliotekë apo në shtëpi)	2	1/15	30
Përgatitja për provimin final			24
Koha e vlerësimit (testi, kuizi, provimi final)	2	1/1	2
Projektet, prezantimet, etj.			
Total			125

Metodat e mësimdhënies:	Ligjëratat me grupe të mëdha duke nxitur ndërveprimin dhe mendimin kritik dhe shfrytëzuar metodat bashkëkohore të mësimdhënies, si: diskutimin interaktiv, përdorimin e animacioneve, ndërsa praktika laboratorike (ushtrimet) do të organizohet me grupe të vogla të studentëve.										
Metodat e vlerësimit:	<table style="width: 100%; border-collapse: collapse;"> <tr> <td style="width: 80%;">Testimi i parë:</td> <td align="right">10%</td> </tr> <tr> <td>Testimi i dytë:</td> <td align="right">10%</td> </tr> <tr> <td>Pjesa praktike</td> <td align="right">10%</td> </tr> <tr> <td>Provimi final</td> <td align="right">70%</td> </tr> <tr> <td>Gjithsej</td> <td align="right">100%</td> </tr> </table>	Testimi i parë:	10%	Testimi i dytë:	10%	Pjesa praktike	10%	Provimi final	70%	Gjithsej	100%
Testimi i parë:	10%										
Testimi i dytë:	10%										
Pjesa praktike	10%										
Provimi final	70%										
Gjithsej	100%										

Literatura primare:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Essential Cell Biology- Bruce Alberts et al., 4th ed. 2014, or 4th ed., USA (e përkthyer në gjuhën shqipe). 2. Campbell Biology , 12th ed. Pearson-prentice Hall; 12th edition, 2020, USA. 3. Gjenetika – Adem Salillari & Sami Hoxha, 2005, Tiranë.
----------------------------	--

Literatura shtesë:	1. Biologjia e përgjithshme (General Biology) - Lekë
---------------------------	--

	Gjikhuri dhe Tefta Rexha, Tiranë, 1989. 2. Biology - Burton S. Guttman. Boston, MA, USA, 2008.
--	---

Hartimi i planit mësimor	
Java	Titulli i ligjëratës
<i>Java 1:</i>	Biologjia e qelizës: Përbërja kimike e qelizës.
<i>Java 2:</i>	Struktura molekulare e membranës qelizore dhe matriksi jashtëqelizor
<i>Java 3:</i>	Transporti i materieve nëpër membranën plazmatike.
<i>Java 4:</i>	Organelet membranore dhe transporti brenda qelizor.
<i>Java 5:</i>	Frymëmarrja qelizore: glikoliza, cikli i Krebsit dhe fosforilimi oksidues.
<i>Java 6:</i>	Fotosinteza: Reaksionet e varura dhe te pavarura nga drita.
<i>Java 7:</i>	Bërthama e qelizës: <i>Acidet nukleike dhe replikimi i ADN-së.</i>
<i>Java 8:</i>	Testimi i parë
<i>Java 9:</i>	Sinteza e ARN-së – transkriptimi dhe sinteza e proteinave – translatimi.
<i>Java 10:</i>	Kontrolla e ekspresionit të gjeneve.
<i>Java 11:</i>	Cikli qelizor dhe ndarjet qelizore: mitozja, mejoza dhe gametogjeneza.
<i>Java 12:</i>	Gjenetika – Trashëgimia Mendeliane dhe jo Mendeliane
<i>Java 13:</i>	Mutacionet gjenike dhe sëmundjet monogjenike.
<i>Java 14:</i>	Ndryshimet numerike dhe strukturore në kromozome.
<i>Java 15:</i>	Testimi i dytë

Politikat akademike dhe Kodi i Sjelljes
<p><i>Ora mësimore fillon dhe përfundon me kohë. Mjetet që përdorën gjatë orëve të mësimt duhet të pastrohen dhe të ruhen në fund të orës mësimore. Telefonat mobil/të mençur dhe pajisjet tjera elektronike (p.sh. iPod-ët) duhet të fikën (apo të kurdisen në vibrim) dhe të mos ekspozohen gjatë orëve të mësimt. Laptopët dhe kompjuterët tabletë lejohen të përdorën vetëm në heshtje; aktivitetet tjera siç janë kontrollimi i e-mailit personal apo shfletimi i ueb-faqeve në internet janë të ndaluara.</i></p>

Shënim | Nëse studenti nuk ndjek të paktën 75% të ligjëratave dhe ushtrimeve laboratorike, atëherë ai/ajo do ta humb të drejtën që t'i nënshtrohet provimit final. Vlerësimi bëhet nga 0-100 %.

10. Bazat e Teknologjisë Farmaceutike

Informatat themelore për lëndën	
Njësia akademike:	Fakulteti i Mjekësisë/Dega Farmaci
Titulli i lëndës:	Bazat e Teknologjisë Farmaceutike
Niveli:	Mpharm
Statusi i lëndës:	Obligative
Viti i studimeve:	Viti I-rë/Semestri II-të
Numri i orëve në javë:	2+0+1
Kreditë ECTS:	4 ECTS
Koha / Vendi:	Salla F1 Sipas orarit

Mësimdhënësi:	Prof.ass.dr.Mimoza Basholli-Saliu		
Të dhënat kontaktuese:	Mimoza.basholli@uni-pr.edu		
Përshkrimi i lëndës:	Lënda Bazat e Teknologjisë Farmaceutike është hyrje në shkencat farmaceutike që përfshin njohjen e koncepteve bazë të farmaceutikës. Kjo lëndë shtjellon njohjen e barit dhe formave të dozimit të barit dhe operacionet teknologjike që aplikohen për formulimin/përgatitjen e formave të dozimit. Gjithashtu në këtë lëndë do të trajtohet parimet bazë të praktikës së mirë të prodhimit dhe laboratorit. Kjo lëndë mbulon poashtu kalkulimet farmaceutike të rëndësishme në përcaktimin e dozës dhe dozimit të barit, si dhe në përgatitjen e formulimeve të ndryshme farmaceutike, duke siguruar kështu një themel të fortë bazik për kalkulimet në praktikën farmaceutike.		
Qëllimet e lëndës:	<p>-Njohja e koncepteve bazë të teknologjisë farmaceutike dhe zhvillimi i aftësive për integrimin e karakteristikave fizike, kimike dhe biologjike që qëndrojnë në themel të dizajnit dhe zhvillimit, si dhe përgatitjes së formave të ndryshme të dozimit të barit.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Njohja me rëndësinë e vetive fiziko-kimike të barnave dhe ekscipientëve në optimizimin e karakteristikave të shpërndarjes së barit nga format e dozimit. - Zotërimi i aftësive për të kryer llogaritjet e sakta të formulimit të barit dhe regjimit të dozimit të dozimit të barit. - Kuptimi i hershëm i këtyre koncepteve do të lejojë përfundimin dhe kuptimin më të thellë të koncepteve të tjera të ndërlidhura me lëndët e tjera. 		
Rezultatet e pritshme të nxënies:	<p>Kupton rolin e teknologjisë farmaceutike në fushën e Farmacisë</p> <p>Kategorizon lëndët aktive/ lëndët ndihmëse/ekscipientët e ndryshëm</p> <p>Përshkruan arsyet e inkorporimit të barit në forma të ndryshme të dozimit të barit</p> <p>Dallon dhe krahason format e ndryshme të dozimit të barit dhe rrugët e administrimit të barit</p> <p>Kupton dhe përshkruan konceptet bazë të praktikës së mirë të prodhimit dhe laboratorit</p> <p>Përcakton dhe përshkruan operacionet teknologjike që aplikohen në përgatitjen e formave të ndryshme të dozimit të barnave,</p> <p>Demonstron aftësi për të bërë kalkulimet farmaceutike që kërkohen në përcaktimin e dozave si dhe në përgatitjen e përgatesave farmaceutike.</p>		
Obligimet e studentit (duhet të jetë në përputhje me Rezultatet e Nxënies të studentit)			
Aktiviteti	Orë mësimore	Ditë/Javë	Gjithsej
Ligjëratat	2	1/15	30

Teori/Punë në laborator/Ushtrime	1	1/15	15
Punë praktike			
Konsultime me mësimdhënësin	0.5	1/15	4
Puna në terren			
Testi, punimi seminarik			
Detyrë shtëpie	1	4	4
Mësimi individual (në bibliotekë apo në shtëpi)	2	15	30
Përgatitja për provimin final	3	3	9
Koha e vlerësimit (testi, kuizi, provimi final)	1	6	6
Projektet, prezantimet, etj.	1	2	2
Total			100

Metodat e mësimdhënies: Ligjëratat, ushtrimet laboratorike, detyrë shtëpie individuale, detyra grupore.

Metodat e vlerësimit:
Detyrat në grupe 10%
Detyrat e shtëpise 5%
Provimi praktik 10%
Aktiviteti në ligjëratat 5%
Provimi final 70%

Ne provimin teorik studenti mund të hyjë, nëse paraprakisht ka arrit 51% të provimit praktik.
Vlerësimi përfundimtar:
55-64% -6
65-74% -7
75-84% -8
85-94% -9
95%-100% -10

Literatura primare:
1.Ligjëratat të përgatitura nga Prof.ass.dr.Mimoza Basholli
2. Teknologjia Farmaceutike, Prof. Dr. Skënder Durrësi
3. Pharmaceutical dosage form and drug delivery system, Loyd V. Allen, Nicholas G. Popovich, Hoëard C. Ansel
4.Pharmaceutical Calculations, Michalakis Savva, 2019

Literatura shtesë:
1. Pharmaceutics, The science of dosage form design, M.E. Aulton
2. Encyclopedia of Pharmaceutical Technology, volume 17, James Boylan, James Blertrick
3. The science and practice of Pharmacy, Remington, 21st edition
4. Përgatitjet galenike dhe kozmetike në laborator, Prof. Dr. Skënder Durrësi
5. Pharmaceutical preformulation and formulation, Mark Gibson

Hartimi i planit mësimor
Java **Titulli i ligjëratës**

Java 1:	Hyrje në Farmaci dhe shkencat farmaceutike
Java 2:	Barnat dhe format farmaceutike
Java 3:	Doza dhe dozimi i barnave
Java 4:	Lënda aktive, Karakteristikat fiziko-kimike
Java 5:	Lëndët ndihmëse/ekspientët farmaceutike
Java 6:	Konceptet bazë të Sigurimit të Cilësisë së Barnave, Praktikës së mirë të prodhimit dhe Praktikës së mirë të laboratorit
Java 7:	Parimet baze në zhvillimi i barnave të reja
Java 8:	Hyrje në dizajnimin e formave të dozimit-aspektet farmaceutike dhe te formulimit
Java 9:	Hyrje në dizajnimin e formave të dozimit-aspektet biofarmaceutike dhe te formulimit
Java 10:	Operacionet farmaceutiko-teknologjike 1-operacionet mekanik
Java 11:	Operacionet farmaceutiko-teknologjike 2 –operacionet termike
Java 12:	Operacionet farmaceutiko-teknologjike 3-operacionet difuzive
Java 13:	Kalkulimet farmaceutike 1
Java 14:	Kalkulimet farmaceutike 2
Java 15:	Kalkulimet farmaceutike 3

Politikat akademike dhe Kodi i Sjelljes

Ora mësimore fillon dhe përfundon me kohë.

Mësimdhënësi dhe asistentët njoftojnë studentët për kriteret e vijueshmërisë së rregullt në ligjerata dhe ushtrime teorike dhe praktike. Ata caktojnë rregullat e mirësjelljes, mbajtje të qetësisë në ligjerata dhe ushtrime, ç'kyqjen e celularëve, ardhjen me kohë në ligjeratë/ushtrim.

Laptopët dhe kompjuterët tabletë lejohen të përdorën vetëm në heshtje; aktivitetet tjera siç janë kontrollimi i e-mailit personal apo shfletimi i ueb-faqeve në internet janë të ndaluara.

11. BAZAT E SINTEZËS DHE NOMENKLATURËS SË BARNAVE

Informatat themelore për lëndën	
Njësia akademike:	Fakulteti i Mjekësisë/Departamenti i Farmacisë
Titulli i lëndës:	BAZAT E SINTEZES DHE NOMENKLATURES SE BARNAVE
Niveli:	Studimet themelore
Statusi i lëndës:	obligative
Viti i studimeve:	Viti i I-rë Semestri i II-të
Numri i orëve në javë:	2+1+0
Kreditë ECTS:	4 ECTS
Koha / Vendi:	Departamenti i Farmacisë Sipas orarit
Mësimdhënësi:	Prof. Asist. Pranvera Breznica Selmani
Të dhënat kontaktuese:	pranvera.breznica@uni-pr.edu
Përshkrimi i lëndës:	Në këtë kurs do të adresohen disa koncepte themelore të kimisë organike, klasave të komponimeve organike dhe në një masë të

	shpjegohen edhe mekanizmat kryesorë të reaksioneve duke marr si shembull sintezat e barnave të zgjedhura. Gjithashtu, duke u bazuar në një numër të madh të shembujve të komponimeve me rëndësi terapeutike do të përcaktohen qartë edhe rregullat me të rëndësishme të nomenklaturës së barnave.
Qëllimet e lëndës:	Qëllimi kryesor i këtij kursi është që: <ul style="list-style-type: none"> • Studentet të fitojnë njohuri bazike të strukturës, sintezës, reaksioneve dhe nomenklaturës së klasave kryesore të komponimeve organike të cilat kanë veprim terapeutik, duke venë në pah parimet themelore të mekanizmave të reaksioneve kimike • Në veçanti do të trajtohet analiza retrosintetike e aplikuar në sintezën e barnave. • Sintezat e barnave të cilat i takojne klasave kryesore të komponimeve organike do të përdoren si shembuj ilustrativ. • Gjithashtu ky kurs do të adresoj edhe konceptet themelore të nomenklatures organike, emertimit sistematik sipas IUPAC, emrave triviale, nomenklatures R, S të molekulave kirale dhe E/Z të izomereve gjeometrike.
Rezultatet e pritshme të nxënies:	Pas përfundimit të suksesshëm të këtij kursi <ul style="list-style-type: none"> • studentët do të sigurojnë njohuritë e mjaftueshme mbi sintezat organike të aplikuara në përfitimin e barnave, kuptojnë shumë reaksione të grupeve kryesore funksionale si dhe do të jenë në gjendje të parashikojn reaksionet kimike të cilat përfshijnë këto grupe. • Studentet gjithashtu do të jenë në gjendje të aplikojnë reaksionet e mësuara për dizajnimin e sintezave organike shumë-shkalleshe. • Në anen tjetër, studentët do të fitojnë njohuri mbi nomenklaturën sistematike dhe triviale të komponimeve organike me rëndësi farmaceutike. • Një rezultat i pritshëm i këtij kursi është edhe përmirësimin e strategjisë së mesimit, mendimit kritik dhe aftësive për zgjidhjen e problemeve.

Obligimet e studentit (duhet të jetë në përputhje me Rezultatet e Nxënies të studentit)

Aktiviteti	Orë mësi more	Ditë/Javë	Gjithsej
Ligjëratat	2	15	30
Teori/Punë në laborator/Ushtime			
Punë praktike			
Konsultime me mësimdhënësin	1	3	3
Puna në terren			
Testi, punimi seminarik	1	15	15
Detyrë shtëpie			
Mësimi individual (në bibliotekë apo në shtëpi)			25
Përgatitja për provimin final			25

Koha e vlerësimit (testi, kuizi, provimi final)			2
Projektet, prezantimet, etj.			
Total			100
Metodat e mësimdhënies:	Ligjerata, ushtrime përmes punës në grupe, seminare, mësimi i vetëdrejtuar, workshop.		
Metodat e vlerësimit:	Kolokfium 20%; prezantimet 20%; vijimi i rregullt 10%; provimi final 50%.		
Literatura primare:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Nomenclature of Organic Chemistry, Sections A, B, C, D, E, F, and H, Pergamon Press, Oxford, 1979. 2. Jie Jack Li , Douglas S. Johnson Drago R. Sliskovic Bruce D. Roth. Contemporary Drug Synthesis, Wiley-Interscience. USA. 2004. ISBN-13: 978-0471214809 		
Literatura shtesë:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Herbert Bartsch. Die systematische Nomenklatur organischer Arzneistoffe. Springer, 2013 2. Maria Del Carmen Avendaño Lopez Introduccion a la Quimica farmaceutica. 2nd Edition. MCGRAW-HILL, 2001. ISBN 9788448603618 		
Hartimi i planit mësimor			
Java	Titulli i ligjeratës		
<i>Java 1:</i>	Hyrja, njoftimi me lëndën (prezentimi i Syllabusit)		
<i>Java 2:</i>	Klasat e komponimeve organike me rendesi terapeutike: hidrokarburet e ngopura dhe te pa ngopura, komponimet aromatike, alkilhalogjenuret,		
<i>Java 3:</i>	Efekti mezomerik dhe induktiv, energjetika dhe kinetika , fortesia e acideve dhe bazave		
<i>Java 4:</i>	Mekanizmat e reaksioneve (reaksionet e substituimit nukleofil, reaksionet e eliminimit, lidhjet shumfishe karbon-heteroatom, reaksionet e substituimit ne sistemet aromatike,		
<i>Java 5:</i>	Oksidimet, reduktimet, transpozicionimet		
<i>Java 6:</i>	Konvertimi ne grupe tjera funksionale		
<i>Java 7:</i>	Sinteza e komponimeve heterociklike		
<i>Java 8:</i>	Nomenklatura sistematike e hidrokarbureve,		
<i>Java 9:</i>	nomenklatura e sistemeve te zevendesuara,		
<i>Java 10:</i>	Nomenklatura e hidrokarbureve te fuzionuara		
<i>Java 11:</i>	Nomenklatura e heterocikleve nje apo me shume unazore		
<i>Java 12:</i>	Nomenklatura e komponimeve spiro dhe unazore me ure lidhese		
<i>Java 13:</i>	Nomenklatura stereokimike		

Java 14:	Nomenklatura e hidrokarbureve terpenike
Java 15:	Kollokviumi.

Politikat akademike dhe Kodi i Sjelljes

- Këshilli i njësisë akademike i përjashton nga Universiteti përgjithmonë ose përkohësisht studentët që i shkelin rëndë rregullat. Studentët e akuzuar për shkelje kanë të drejtë të dëgjohen nga komisioni disiplinor i cili e këshillon këshillin e njësisë akademike. Studentët e përjashtuar kanë të drejtë t'i ankohen Senatit i cili mund të konfirmojë ose të refuzojë vendimin e këshillit të njësisë akademike.
- Rregulloret që i elaborojnë këto procedura nxirren nga Senati pasi të jenë konsultuar me parlamentin e studentëve.
- Studentët kanë të drejtë të ankohen kundër vendimit të marrë prej organeve të Universitetit, të njësisë akademike dhe njësisë organizative që kanë të bëjnë me të drejtat, obligimet dhe përgjegjësitë e tyre.
- Ankesat e tilla i dorëzohen komisionit të studimeve të njësisë akademike brenda 15 ditëve të punës pas shpalljes së vendimit.
- Komisioni i studimeve është i obliguar t'ia dorëzojë raportin për vendimin e marrë këshillit të njësisë akademike brenda 30 ditëve të punës pas pranimit të ankesës.
- Ankesa rreth vendimit në shkallë të parë vendoset nga Senati.

12. TEKNIKË INSTRUMENTARE NË LABORATOR

Informatat themelore për lëndën	
Njësia akademike:	Fakulteti i Mjekësisë/Departamenti i Farmacisë
Titulli i lëndës:	Teknika instrumentare në laborator
Niveli:	Studimet themelore
Statusi i lëndës:	zgjedhore
Viti i studimeve:	Viti i I-të Semestri i II-të
Numri i orëve në javë:	1+1+0
Kreditë ECTS:	3 ECTS
Koha / Vendi:	Departamenti i Farmacisë Sipas orarit
Mësimdhënësi:	Prof. Asist. Pranvera Breznica Selmani
Të dhënat kontaktuese:	pranvera.breznica@uni-pr.edu
Përshkrimi i lëndës:	Ky modul mundëson njohjen e koncepteve të të mësuarit, metodave të ndryshme instrumentare të cilat janë shumë të përdorshme në të gjitha fushat me interes farmaceutik respektivisht duke filluar nga identifikimi i substancave aktive të barnve, përcaktimi i pastërtisë, përcaktimit të profilit farmakokinetik/ farmakodinamik, formulimit farmaceutik si dhe hulumtimin e stabilitetit të formave farmaceutike. Po ashtu si faktorë kyç është edhe fitimi i aftësive për të relizuar përpunimin dhe raportimin e rezultateve të fituara nga metodat e ndryshme instrumentare. Që kjo është e domosdoshme gjatë leximit dhe raportimit të rezultateve të fituara.

<p>Qëllimet e lëndës:</p>	<ul style="list-style-type: none"> Mësojë studentet për metodat e ndryshme instrumentare të domosdoshme gjatë studimeve, gjatë hulumtimeve shkencore por edhe gjatë punës si Farmacistë; Mësojë studentët me njohuri bazike për metodat instrumentare (HPLC, GC, HPLC-MS, fluorometria, HPLC-DAD, UV-VIS, etj.) e cila kërkohet për përcaktimin sasior të përbërjeve me interes farmaceutik. Këto njohuri të fituara nga ky modul gjejnë zbatueshmëri në shumë fusha duke filluar nga fusha e kimisë farmaceutike, analizë dhe kontroll i barnave, teknologji, toksikologji, hulumtimin e barnave të falsifikuara etj. Aftësojë studentët në planifikimin e pavarur të teknikave të nevojshme për hulumtim; Aftësojë studentët për përshkrimin dhe interpretimin kritik të rezultateve të fituara.
<p>Rezultatet e pritshme të nxënies:</p>	<ul style="list-style-type: none"> Të fitohen njohuri të mjaftueshme për metodat instrumentare të përdorura për përcaktimin kalitativ dhe kuantitativ të lëndëve aktive, substancave që përdoren si ekscipient dhe përbërjeve me interes farmaceutik; Të jenë në gjendje të zbatojë njohuritë e marra për problemet reale dhe çështjet e reja në lidhje me analizën e formulimeve farmaceutike. Aftësoj studentët mbi mënyrat dhe metodat e grumbullimit, përpunimit analizimin, interpretimin e rezultateve dhe raportimin rezultateve të fituara nga metodat e ndryshme instrumentare. Të jenë në gjendje të zbatojë njohuritë e marra për kualifikimi pozitiv ditor gjatë orëve praktike laboratorike, përgatitja e raporteve laboratorike dhe diskutimi mbi vetë raportet janë pjesët kryesore të provimit.

Obligimet e studentit (duhet të jetë në përputhje me Rezultatet e Nxënies të studentit)

Aktiviteti	Orë mësi more	Ditë/Javë	Gjithsej
Ligjëratat	1	15	15
Teori/Punë në laborator/Ushtime	1	15	15
Punë praktike			
Konsultime me mësimdhënësin	1	5	5
Puna në terren			
Testi, punimi seminarik	1	5	5
Detyrë shtëpie			
Mësimi individual (në bibliotekë apo në shtëpi)	1	15	15
Përgatitja për provimin final	1	15	15
Koha e vlerësimit (testi, kuizi, provimi final)	1	1	1
Projektet, prezantimet, etj.	2	2	4

Total		75
Metodat e mësimdhënies:	Ligjerata, ushtrime përmes punës në grupe, seminare, mësimi i vetëdrejtuar, workshop.	
Metodat e vlerësimit:	Kolokfium 20%; prezantimet 20%; vijimi i rregullt 10%; provimi final 50%.	
Literatura primare:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Konceptet e ligjeratave 2. Çullaj Alqi. Metodatat instrumentale të analizës kimike; UT 2004 3. Pungor E, Horvai G. A practical guide to instrumental analysis. CRC press; 1994 Oct 19. 4. European Pharmacopoeia 5.0; British Pharmacopoeia; USP/NF; other national Pharmacopoeias and Compendiums 	
Literatura shtesë:		
Hartimi i planit mësimor		
Java	Titulli i ligjeratës	
<i>Java 1:</i>	Hyrja, njoftimi me lëndën (prezentimi i Syllabusit) Definicioni dhe lënda e studimit të teknikaës instrumentare në laboratorë.	
<i>Java 2:</i>	Klasifikimi i teknikave instrumentare	
<i>Java 3:</i>	Metodat e kalibritmit gjatë aplikimit të teknikave instrumentare	
<i>Java 4:</i>	Llojet e spektrave	
<i>Java 5:</i>	Spektrofotometria në zonën UV- Vis	
<i>Java 6:</i>	Spektrofotometria në zonën IK	
<i>Java 7:</i>	Spektroskopia Ramana	
<i>Java 8:</i>	Spektroskopia e rezonancës bërthamore magnetike	
<i>Java 9:</i>	Spektroskopia e emisionit atomik	
<i>Java 10:</i>	Spektrometria e adsorbimit atomik	
<i>Java 11:</i>	Spetrometria e masës	
<i>Java 12:</i>	Xhel elektroforeza	
<i>Java 13:</i>	PCR metoda	
<i>Java 14:</i>	Prezantimet seminarë	
<i>Java 15:</i>	Kollokviumi.	

Politikat akademike dhe Kodi i Sjelljes

- Këshilli i njësise akademike i përjashton nga Universiteti përgjithmonë ose përkohësisht studentët që i shkelin rëndë rregullat. Studentët e akuzuar për shkelje kanë të drejtë të dëgjohen nga komisioni disiplinor i cili e këshillon këshillin e njësise akademike. Studentët e përjashtuar kanë të drejtë t'i ankohen Senatit i cili mund të konfirmojë ose të refuzojë vendimin e këshillit të njësise akademike.
- Rregulloret që i elaborojnë këto procedura nxirren nga Senati pasi të jenë konsultuar me parlamentin e studentëve.
- Studentët kanë të drejtë të ankohen kundër vendimit të marrë prej organeve të Universitetit, të njësive akademike dhe njësive organizative që kanë të bëjnë me të drejtat, obligimet dhe përgjegjësitë e tyre.
- Ankesat e tilla i dorëzohen komisionit të studimeve të njësise akademike brenda 15 ditëve të punës pas shpalljes së vendimit.
- Komisioni i studimeve është i obliguar t'ia dorëzojë raportin për vendimin e marrë këshillit të njësise akademike brenda 30 ditëve të punës pas pranimit të ankesës.
- Ankesa rreth vendimit në shkallë të parë vendoset nga Senati.

13. BIOLOGJI MOLEKULARE

Informatat themelore për lëndën	
Njësia akademike:	Fakulteti i Mjekësisë. Drejtimi: Farmaci
Titulli i lëndës:	Biologji molekulare
Niveli:	Studime themelore të integruara/BA
Statusi i lëndës:	Zgjedhore
Viti i studimeve:	Viti i I-rë Semestri i II-të
Numri i orëve në javë:	1+1+0 (L+S)
Kreditë ECTS:	3 ECTS
Koha / Vendi:	Amfiteatër Sipas orarit
Mësimdhënësit:	Prof. Ass.Dr.Ramadan Sopi dhe Prof. Ass.Dr.Mentor Sopjani
Të dhënat kontaktuese:	ramadan.sopi@uni-pr.edu ; mentor.sopjani@uni-pr.edu
Përshkrimi i lëndës:	<i>Kjo është një lëndë që përshkruan proceset e ekspresionit të gjeneve dhe organizimit të gjeneve të prokariotet dhe eukariotet. Më tutje, këtu përshkruhen menyrat e izolimit dhe manipulimit të gjeneve si klonimi I gjeneve me ane të teknologjise se AND-se rekombinante. Përveç kësaj kjo lëndë përfshin bioteknologjinë molekulare dhe aplikimet e saj në mjekësi e posaqërisht në terapinë gjenike dhe klonimin riprodhues dhe terapeutik.</i>
Qëllimet e lëndës:	<ul style="list-style-type: none"> - Të njohohen studentët me organizimin e gjeneve të prokariotet dhe eukariotet. - Të sqaroh menyrën e izolimit të gjeneve dhe enzimave të nevojshme për manipulim të gjeneve. Teknikat e klonimit të gjeneve. - Të njihen studentët me mundësitë e aplikimit të biologjisë molekulare për qëllime të

	diagnostikimit dhe terapive në sëmundjet trashëguese si dhe sintezes se produkteve bioteknologjike.		
Rezultatet e pritshme të nxënies:	<p>Pas përfundimit të kësaj lënde studentët do të jetë në gjendje të :</p> <ul style="list-style-type: none"> - Njohin organizimin e gjeneve ne gjenomin prokariot dhe eukariot. - Shpjegojnë menyren e izolimit te ADN-se dhe izolimit te gjeneve te caktuara me teknika molekulare. - Dijnë aplikimin e metodave te biologjise molekulare, si PCR, RT-PCR, Western blot, etj. ne diagnostikimin e semundjeve te ndryshme. - Kuptojnë mundësitë e aplikimit të biologjisë molekulare për sintezën e produkteve te ndryshme bioteknologjike per përdorim ne mjekësi. - Vleresojne llojin e terapise gjenike qe mund te aplikohet ne rastin e semundjeve te caktuara. 		
Obligimet e studentit (duhet të jetë në përputhje me Rezultatet e Nxënies të studentit)			
Aktiviteti	Orë mësimore	Ditë/Javë	Gjithsej
Ligjëratat	1	1/15	15
Teori/Punë në laborator/Ushtime			
Punë praktike			
Konsultime me mësimdhënësin	1	1/5	5
Puna në terren	-	-	
Testi, punimi seminarik	1	1/15	15
Detyrë shtëpie	-	-	
Mësimi individual (në bibliotekë apo në shtëpi)			22
Përgatitja për provimin final	1	1/15	15
Koha e vlerësimit (testi, kuizi, provimi final)	1	1/3	3
Projektet, prezantimet, etj.			
Total			75 ore
Metodat e mësimdhënies:	Mësimi është i rregullt dhe organizohet në formë të ligjëratave dhe seminareve duke shfrytëzuar metodat bashkohore të mësimdhënies si diskutimin interaktiv, prezantim ne grupe etj.		
Metodat e vlerësimit:	Testimi i parë:	10%	
	Testimi i dytë:	10%	
	Seminaret	20%	
	Provimi final	60%	
	Gjithsej	100%	
Literatura primare:	1. Biologjia molekulare- Mentor Sopjani, Universiteti i Prishtines, Prishtine 2018.		

	2. Bazat e inxhinieringut gjenetik – Nicholl Desman, AlbMed, Prishtine 2013 (version i përkthyer).
Literatura shtesë:	1. Bioteknologjia – Dhurata Frashëri, Shblu, Tiranë, 2000. 2. Biologjia qelizore dhe molekulare - Tefta Rexha, Shblu, Tiranë, 2009.

Hartimi i planit mësimor

Java	Titulli i ligjëratisë
<i>Java 1:</i>	Hyrje ne biologjine molekulare
<i>Java 2:</i>	Izolimi i acideve nukleike dhe <i>xhel elektroforeza</i> .
<i>Java 3:</i>	Aspekte molekulare te enzimeve qe shfrytezohen si mjete te manipulimit ne teknikat e biologjise molekulare.
<i>Java 4:</i>	Vektoret dhe qelizat bujtare.
<i>Java 5:</i>	Strategjite e klonimit te ADN-se.
<i>Java 6:</i>	Reaksioni zinxhiror i polimerazes (PCR bazik dhe tipet tjera te PCR) dhe sekuencimi i ADN-se.
<i>Java 7:</i>	Seleksionimi, skrinimi dhe analiza e rikombinanteve si dhe teknikat e blotimit.
<i>Java 8:</i>	Vleresimi i pare
<i>Java 9:</i>	Krijimi i hartave gjenetike dhe projekti i gjenomit human.
<i>Java 10:</i>	Sinteza e proteinave me ane te teknologjise rekombinante dhe aplikimi i produkteve bioteknologjike ne mjekesi.
<i>Java 11:</i>	Terapia gjenike.
<i>Java 12:</i>	Aspekte molekulare te fibrozës cistike dhe çrregullimeve tjera gjenetike.
<i>Java 13:</i>	Krijimi i organizmave te modifikuar gjenetikiisht dhe perdorimi i tyre ne mjekesi.
<i>Java 14:</i>	Klonimi i organizmave dhe aspektet etike te klonimit.
<i>Java 15:</i>	Vleresimi i dyte.

Politikat akademike dhe Kodi i Sjelljes

Ora mësimore fillon dhe përfundon me kohë.
Telefonat mobil/të mençur dhe pajisjet tjera elektronike (p.sh. iPod-ët) duhet të fikën (apo të kurdisen në vibrim) dhe të mos ekspozohen gjatë orëve të mësimi.
Laptopët dhe kompjuterët tabletë lejohen të përdorën vetëm në heshtje; aktivitetet tjera siç janë kontrollimi i e-mailit personal apo shfletimi i ueb-faqeve në internet janë të ndaluara.

Shënim | Nëse studenti nuk ndjek të paktën 75% të ligjëratisë dhe seminareve, atëherë ai/ajo do ta humb të drejtën që t'i nënshtrohet provimit final. Vlerësimi bëhet nga 0-100 %.


14. Kimia Organike

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti i Mjekësisë
Titulli i lëndës:	Kimia Organike
Niveli:	Bachelor
Statusi lëndës:	Obligative
Viti i studimeve:	Viti II (Sem III)
Numri i orëve në javë:	4 + 1 + 3

Vlera në kredi – ECTS:	8 ECTS
Koha / Vendi:	Fakulteti i Mjekësisë, sipas orarit të shpallur
Mësimdhënësi:	Prof. Dr. Ramiz Hoti
Të dhënat kontaktuese:	mob:+383 44 271068 e-mail: ramizhoti@yahoo.com ramiz.hoti@uni-pr.edu
Përshkrimi i lëndës	Kimia organike studion përbërjen, vetitë dhe reaksionet e komponimeve të karbonit. Komponimet organike janë të rëndësishme së veçantë për shumë lëmi shkencore. Në radhë të parë ato janë bartës të proceseve jetësore në organizmat e gjallë. Gjithashtu edhe përdorimi i tyre për nevoja të ndryshme është jashtëzakonisht i gjerë. Shumica e produkteve të konsumit të përditshëm, lëndët e djegëshme, produktet ushqimore, barnat, preparatet e ndryshme, masat plastike e shumë të tjera janë me përbërje organike. Si të tilla ato gjejnë zbatim në shkencat mjekësore, farmakologjike, në agrikulturë, kozmetikë, në teknologji ushqimore, ndërtimtari e shumë lëmenj tjerë.
Qëllimet e lëndës:	Fokusi kryesor i kësaj lënde është studimi i strukturës së komponimeve organike dhe lidhmëria me vetitë e tyre. Studentët duhet të zgjerojnë dhe të thellojnë njohuritë nga Kimia organike duke përfillur intersin dhe nevojat e tyre për zhvillim akademik dhe profesional. Ata duhet të njohin përbërjen dhe vetive të komponimeve organike dhe për kuptimin e ligjshmërive të ndryshmeve të këtyre komponimeve që ndodhen në natyrë dhe atyre që përftohen në mënyrë sintetike. Të zhvillohet personaliteti i studentit në krijimin e shprehive dhe shkathësi për punë të pavarur eksperimentale, përdorimin e drejtë të substancave kimike, të pajisjeve laboratorike dhe të edukohen për ruajtjen e shëndetit të tyre dhe të mjedisit. Përmes këtij kursi, studentëve do t'u ofrohet informacion i mjaftueshëm për bazat e kimisë organike.
Rezultatet e pritshme të nxënies:	<i>Pas përfundimit të këtij kursi (lënde) studenti do të jetë në gjendje që:</i> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Të njohin përbërjen dhe strukturën e komponimeve organike. ▪ Të kuptojnë proceset e ndryshme kimike dhe të përshkruajnë zhvillimin e tyre.. ▪ Të zbatojnë rregullat për paraqitjen e formulave, barazimeve kimike dhe ato të emërimit të komponimeve organike sipas Sistemit ndërkombëtar "IUPAC". ▪ Të Identifikojnë dhe klasifikojnë komponimet organike sipas vetive të tyre dhe grupeve funksionore. ▪ Të analizojnë përbërjen e komponimeve organike. ▪ Të sintetizojnë komponimet organike përmes reaksioneve kimike. ▪ Të vlerësojnë rëndësinë e komponimeve organike për nevoja të njerëzimit dhe ndikimin e tyre në ndotjen e mjedisit.
Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënimit të studentit)	

Aktiviteti	Orë	Ditë/Javë	Gjithsej:												
Ligjërata	4 orë	15	60												
Ushtrime laboratorike	3 orë	15	45												
Kontaktet me msimëdhënës/konsultimet	5 orë/ vit		5												
Kolokviume, seminare	1 orë	15	15												
Koha e studimit vetenak të studentit (në bibliotekë ose shtëpi)			55												
Pregatitja përfundimtare për provim	15 orë /vit		15												
Koha e kaluar në vlerësim (teste, provim final)	5 orë		5												
Totali			200												
Format e mësimdhënies:	Leksione me mësim interaktiv, diskutime, biseda, projekte, ushtrime eksperimentale individuale e grupore, punime seminarike														
Metodat e vlerësimit:	<p>Për vlerësim të studentit do të merren të gjitha aktivitetet mësimore të studentit, duke pasë në konsideratë të gjitha aspektet e matshme të vlerësimit të dijës , të shkathtësive dhe qëndrimeve</p> <table style="width: 100%; border-collapse: collapse;"> <tbody> <tr> <td style="padding-left: 20px;">▪ Pjesëmarrja aktive në leksione</td> <td style="text-align: right;">10%</td> </tr> <tr> <td style="padding-left: 20px;">▪ Kryerja e ushtrimeve</td> <td style="text-align: right;">15%</td> </tr> <tr> <td style="padding-left: 20px;">▪ Vlerësimi i testeve intermediare:</td> <td style="text-align: right;">20%</td> </tr> <tr> <td style="padding-left: 20px;">▪ Punimet seminarike</td> <td style="text-align: right;">15%</td> </tr> <tr> <td style="padding-left: 20px;">▪ Provimi final: (testi final, 30% + intervista, 10%)</td> <td style="text-align: right;">40%</td> </tr> <tr> <td style="padding-left: 20px;">▪ Total:</td> <td style="text-align: right; border-top: 1px solid black;">100%</td> </tr> </tbody> </table>			▪ Pjesëmarrja aktive në leksione	10%	▪ Kryerja e ushtrimeve	15%	▪ Vlerësimi i testeve intermediare:	20%	▪ Punimet seminarike	15%	▪ Provimi final: (testi final, 30% + intervista, 10%)	40%	▪ Total:	100%
▪ Pjesëmarrja aktive në leksione	10%														
▪ Kryerja e ushtrimeve	15%														
▪ Vlerësimi i testeve intermediare:	20%														
▪ Punimet seminarike	15%														
▪ Provimi final: (testi final, 30% + intervista, 10%)	40%														
▪ Total:	100%														
Literatura															
Literatura bazë:	<ol style="list-style-type: none"> 1. K. P. Vollhard, N. E. Schore, Organic Chemistry, Structure and function (seventh ed.) <i>H, Freeman and Company</i>, USA, 2018 2. John McMurry, Organic Chemistry, (Eight ed.) Brooks/Cole Cengage Learning, Canada, Australia, JAPAN, Korea, Mexico, Singapore, Spain, United Kingdom, USA, 2012. 3. Lajçi, V. Kalaj, Kimia, për studentë të mjekësisë, stomatologjisë dhe Biologjisë, <i>Universiteti i Prishtinës</i>, Prishtinë, 1998 														
Literatura plotësuese:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Francis Carey and Robert Giuliano, Organic Chemistry, (tenth ed.) Mc. Graw Hill Higher Education, Boston, Madison, New 														

	<p>York, San Francisco, Lisbon, London, Madrid, Mexico city, New Delhi, Santiago, Sydney, Taipei, Toronto, 2017.</p> <p>2. Paula Yurkanis Bruice, Organic Chemistry, (Fourth Ed.), Prentice Hall, 2005.</p> <p>3. R. Hoti, Kimia Organike Laboratorike, Universiteti i Prishtinës & Libri shkollor, Prishtinë, 2020.</p>
--	--

Plani i dizajnuar i mësimi:	
Java	Ligjerata që do të zhvillohet
<i>Java e parë:</i>	Njohim me planprogramin e lëndës dhe literaturën
<i>Java e parë:</i>	<p>Hyrje në Kiminë Organike</p> <p>Vetitë e komponimeve organike, përcaktimi i formulave, analiza cilësore dhe sasiore, struktura, izomeria.</p>
<i>Java e dytë:</i>	<p>Izomeria e komponimeve organike</p> <p>Llojet e izomerëve, izomeria strukturore, izomeria hapsinore, Izimeria gjeometrike, izomeria optike, komponimet hirale. Aktiviteti optik (enantiomerët, konfiguracioni, konformerët). Reaksionet organike (llojet dhe mekanizmi i tyre).</p>
<i>Java e dytë:</i>	<p>Klasifikimi i komponimeve organike, hidrokarburet</p> <p>Klasifikimi sipas strukturës dhe sipas grupeve funksionore. Hidrokarburet, klasifikimi (aciklike, ciklike, alifatike aromatike). Alkanet, struktura, nomenklatura, vetitë fizike e kimike, reaksionet e alkaneve.</p>
<i>Java e tretë:</i>	<p>Alkenet </p> <p>Struktura, klasifikimi, nomenklatura, vetitë fizike e kimike, reaksionet e alkeneve.</p>
<i>Java e tretë:</i>	<p>alkinet dhe dienet</p> <p>Klasifikimi, struktura, nomenklatura, vetitë fizike e kimike, reaksionet e alkineve dhe dieneve.</p>
<i>Java e katërt:</i>	<p>Hidrokarburet ciklike</p> <p>Cikloalkanet, cikloalkenet. Hidrokarburet aromatike, benzeni, struktura, vetitë, reaksionet, derivatet e benzenit, hidrokarburet aromatike poliunazore.</p>
<i>Java e katërt:</i>	Halogenoalkanet

	Përfaqësuesit, vetitë, sintezat.
Java e pestë:	Komponimet organike me oksigjen Alkoolet, klasifikimi, vetitë, reaksionet.
Java e pestë:	Fenolet dhe eteret Fenolet, klasifikimi, vetitë, reaksionet. Eteret, klasifikimi, nomenklatura, vetitë fizike e kimike.
Java e gjashtë:	Aldehidet dhe ketonet Aldehidet, struktura, vetitë dhe klasifikimi. Sinteza e aldehideve. Ketonet, struktura, vetitë dhe klasifikimi. Sinteza e ketoneve. Reaksionet e aldehideve dhe ketoneve Reaksionet karakteristike të aldehideve dhe ketoneve (Adicionimi nukleofil, oksidimi, reduktimi). Identifikimi spektrometrik i aldehideve dhe ketoneve.
Java e gjashtë:	Punim seminarik Mbikqyerje dhe kontrollim i punës së studentëve për seminarin e parë
Java e shtatë:	Punim seminarik Referim i studentëve
Java e shtatë:	Acidet karboksilike Struktura, vetitë fizike e kimike. Sinteza dhe reaksionet karakteristike të acideve karboksilike (Reaksionet acido-bazike, përftimi i derivateve të acideve; acil-halogjenureve, anhidruereve, amideve, esterifikimi, reduktimi). Identifikimi spektrometrik i acideve karboksilike.
Java e tetë:	Derivatet e acideve karboksilike Acil-halogjenuret, anhidrueret e acideve, esteret, amidet. Struktura, vetitë fizike e kimike. Sinteza dhe reaksionet karakteristike të derivateve të acideve karboksilike (Reaksionet e shndërrimit të derivateve, hidroliza e tyre.
Java e tetë:	Testim i parë intermedier
Java e nëntë:	Komponimet organike që posedojnë azot, nitrokomponimet dhe aminat dhe komponimet heterociklike Nitrokomponimet, emërtimi, vetitë, struktura. Aminat, struktura, emërtimi, klasifikimi, vetitë, reaksionet, aminoalkoolet.
Java e nëntë:	Komponimet heterociklike

	Komponimet heterociklike me bërthamë pesë- dhe gjashtëkëndëshe me një dhe me dy heteroatome).
Java e dhjetë:	Lipidet Gliceridet, përhapja në natyrë, vetitë, përdorimi, hidroliza e yndyrave. Lipidet e përbëra (glikoproteidet, fosfolipidet, lipoproteidet. Metabolizmi i yndyrave.
Java e dhjetë:	Terpenet dhe steroidet <i>Vajërat eterike, struktura, klasifikimi, vetitë, izolimi.</i> Struktura e steroideve, Vitaminat D, vetitë, reaksionet, acidet e tëmthit, hormonet steroidale, funksioni i tyre në organizëm.
Java e njëmbëdhjetë:	Vitaminat Struktura, vetitë, klasifikimi, funksioni në organizëm.
Java e njëmbëdhjetë:	Karbohidratet Monosakaridet, struktura (vargu i hapur dhe struktura ciklike), reaksionet, përfaqësuesit.
Java e dymbëdhjetë:	Disakaridet dhe polisakaridet Disakaridet, vetitë, përfaqësuesit. Polisakaridet, përfaqësuesit, vetitë, përhapja, përdorimi. Metabolizmi i karbohidrateve.
Java e dymbëdhjetë:	Amino acidet, struktura dhe klasifikimi Struktura, klasifikimi, vetitë, konfiguracioni, sintezat dhe reaksionet, metodat për darjen në amino-acideve. Metabolizmi i aminoacideve.
Java e trembëdhjetë:	Peptidet dhe proteinat Struktura, vetitë, sekuenca e amino-acideve në vargun peptidik, sintezat dhe reaksionet. Proteinat, klasifikimi (proteinat e thjeshta dhe të përbëra), vetitë, metabolizmi dhe funksioni biologjik, denaturimi. Proteinat e përbëra (fosfoproteidet, glikoproteidet, lipoproteidet, nukleoproteidet).
Java e trembëdhjetë:	Acidet nukleike Nukleozidet, nukleotidet, përbërja, struktura, funksioni biologjik, ADN dhe ARN.
Java e katërbëdhjetë:	Enzimat Struktura, nomenklatura, klasifikimi, koenzimat, reaksionet enzimatiqe, përcaktimi i aktivitetit enzimatik.
Java e katërbëdhjetë:	Testim i dytë intermedier

Java e pesëmbëdhjetë:	Punim seminarik Mbikqyerje dhe kontrollim i punës së studentëve për seminarin e dytë
Java e pesëmbëdhjetë:	Punim seminarik Referim i studentëve

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:

Vijimi në ligjëratat dhe ushtrime duhet të jetë i rregullt. Studentët duhet të sillen konform rregulltivave të Universitetit të Prishtinës dhe në përputhje me Ligjin mbi Arsimin e Lartë të Kosovës. Për rregullat e veçanta dhe specifikat e organizimit të ligjëratave e ushtrimeve, studentët njoftohen nga profesori i lëndës dhe asistenti i tij.

15. KIMI ANALITIKE për farmaci

Informatat themelore për lëndën	
Njësia akademike:	Fakulteti i Mjekësisë - Farmaci
Titulli i lëndës:	Kimi Analitike për farmaci
Niveli:	BA
Statusi i lëndës:	I obligueshëm
Viti i studimeve:	Viti i II-rë Semestri i III-të
Numri i orëve në javë:	2+0+2
Kreditë ECTS:	4 ECTS
Koha / Vendi:	E Hënë 08:00-09:30
Mësimdhënësi:	Prof. Ass. Dr. Liridon Berisha
Të dhënat kontaktuese:	Liridon.berisha@uni-pr.edu
Përshkrimi i lëndës:	Në kuadër të metodave instrumentale të analizës kimike shtjellohen konceptet bazë të metodave optike dhe elektrokimike të analizës. Aplikimi i metodave instrumentale të analizës në analizën kimike përfshirë teknika të ndryshme nga metodat optike edhe elektroanalitike. Në kuadër të metodave optike përfshihen spektrofotometria UV-VIS, IK, metodat luminishente, spektroskopia atmike dhe ajo e masës. Zbatimi i metodave elektrokimike si potenciometria, elektrogravimetria, kulonmetria dhe teknikat voltametrike në analizën kimike.
Qëllimet e lëndës:	Qëllimi kryesor është zhvillimi i aftësive të studentit për realizimin e një analize kimike me metodat përkatëse duke përfshirë analizën cilësore dhe atë sasiore të analitëve inorganik dhe organik. Zhvillimi i shkathtësisë së zgjidhjes së problemeve në kuadër të analizës kimike dhe përvetësimi i teknikave instrumentale në analizën cilësore dhe sasiore. Studentët me punën e tyre që zhvillojnë në këtë kurs do të jenë në gjendje të identifikojnë mundësitë e gabimeve gjatë një analize kimike gjithashtu, krijimin e shprehive dhe shkathtësisë për punë të pavarur

	eksperimentale, përdorimin e drejtë të instrumenteve përkatëse në kushte dhe situata të ndryshme eksperimentale.																
Rezultatet e pritshme të nxënies:	<ul style="list-style-type: none"> - Interpretoj konceptet bazë të metodave instrumentale të analizës kimike - Zhvillimi i shkathtesive përmes punës laboratorike në analizën kimike - Përpunimi statistikor i të dhënave - Parashikon dhe përshkruan procesin e përgatitjes dhe zgjedhjes e metodes analitike 																
Obligimet e studentit (duhet të jetë në përputhje me Rezultatet e Nxënies të studentit)																	
Aktiviteti	Orë mësimore	Ditë/Javë	Gjithsej														
Ligjëratat	2	15	30														
Teori/Punë në laborator/Ushtime	-	-	-														
Punë praktike	2	15	30														
Konsultime me mësimdhënësin			4														
Puna në terren	0	0	0														
Testi, punimi seminarik	5	1	5														
Detyrë shtëpie																	
Mësimi individual (në bibliotekë apo në shtëpi)	1	15	15														
Përgatitja për provimin final	5	2	10														
Koha e vlerësimit (testi, kuizi, provimi final)	3	2	6														
Projektet, prezantimet, etj.																	
Total			100														
Metodat e mësimdhënies:	Studentët shfletojnë materialin para ligjëratës dhe përmes shembujve dhe dhe zgjidhjes së problemeve sqarohen dhe përforcohen njohuritë e studentëve. Në ushtime eksperimentale studentët arrijnë aplikimin e njohurive teorike në punë laboratorike duke realizuar analizën kimike.																
Metodat e vlerësimit:	<table style="width: 100%; border-collapse: collapse;"> <tr> <td style="width: 80%;">Vlerësimi I</td> <td style="text-align: right;">15 %</td> </tr> <tr> <td>Vlerësimi II</td> <td style="text-align: right;">15 %</td> </tr> <tr> <td>Detyrat e shtëpisë/kuize</td> <td style="text-align: right;">5 %</td> </tr> <tr> <td>Seminari</td> <td style="text-align: right;">5 %</td> </tr> <tr> <td>Ushtimet laboratorike</td> <td style="text-align: right;">30 %</td> </tr> <tr> <td>Provimi pefundimtare</td> <td style="text-align: right;">30 %</td> </tr> <tr> <td>Numri total i pikeve</td> <td style="text-align: right;">100%</td> </tr> </table>			Vlerësimi I	15 %	Vlerësimi II	15 %	Detyrat e shtëpisë/kuize	5 %	Seminari	5 %	Ushtimet laboratorike	30 %	Provimi pefundimtare	30 %	Numri total i pikeve	100%
Vlerësimi I	15 %																
Vlerësimi II	15 %																
Detyrat e shtëpisë/kuize	5 %																
Seminari	5 %																
Ushtimet laboratorike	30 %																
Provimi pefundimtare	30 %																
Numri total i pikeve	100%																
Literatura primare:	Daniell C. Harris, Quantitative Chemical Analysis 10th ed. 2019 W. H. Freeman																
Literatura shtesë:	D. Harvey: Modern Analytical Chemistry, Mc Graw Hill, Boston, 2000. <i>Metodat instrumentale te analizës kimike, Alqi Cullaj, Tiranë.</i>																
Hartimi i planit mësimor																	
Java	Titulli i ligjëratës																

Java 1:	Bazat e spektrofotometrisë
Java 2:	Aplikimi i spektrofotometrisë
Java 3:	Aplikimi i spektrofotometrisë
Java 4:	Meodat luminishente te analizës
Java 5:	Spektrofotometrat
Java 6:	Spektroskopia atomike
Java 7:	Spektroskopia e masës
Java 8:	Vlerësimi I
Java 9:	Bazat e elektrokimisë
Java 10:	Potenciometria
Java 11:	Titullimet potenciometrike
Java 12:	Teknikat elektroanalitike
Java 13:	Hyrje ne ndarjet analitike
Java 14:	Përgatitja e mostrave
Java 15:	Vlerësimi II

Politikat akademike dhe Kodi i Sjelljes

Afati kohorë për dorëzimin e detyrave është 7 nga dita kur ipen detyrat. Detyrat të cilat dorezohen me vonëse nuk do te vleresohen me pike. Kuizet online do të organizohen brenda një intervali kohorë 1 deri 2 orë brenda javës. Seminarët e zgjedhura duhet të dorëzohen deri në javën e 11 dhe të mbrohen para javës së 15. Ndalohet përdorimi nga ana e studenteve i telefonave celular, dhe të gjitha mjeteve tjera te teknologjise informatike si kompjutere laptop, tablet etj. Vetëm në rastet kur lejon mësimdhënësi. Telefonat mund te perdoren vetem ne rastet emergjente jashte nga klasa me leje te mësimdhënësit. Studentet duhet te mbajnë qetesine gjate leksioneve. Studenti para se të filloj punën eksperimentale duhet të kuptoj qëllimin e eksperimentit dhe objektivat të cilat do të arrihen nga eksperimenti. Studenti vlerësohet nga asistenti për njohuritë e tij para se të filloj punën në laborator dhe kalueshmëria është kusht për zhvillimin e eksperimentit. Mos respektimi i rregullave rezulton me përjashtim nga mundësia e hyrjes në provim perfundimtar.

16. Kimi fizike

Informatat themelore për lëndën	
Njësia akademike:	Fakulteti i Mjekësisë
Titulli i lëndës:	Kimi fizike
Niveli:	BA
Statusi i lëndës:	I obligueshëm
Viti i studimeve:	Viti i II-të Semestri i III-të
Numri i orëve në javë:	2+0+2
Kreditë ECTS:	4 ECTS
Koha / Vendi:	Sipas orarit
Mësimdhënësi:	Prof. dr. Fetah Podvorica
Të dhënat kontaktuese:	fetah.podvorica@uni-pr.edu
Përshkrimi i lëndës:	Kimia fizike është shkencë e cila paraqet shfrytëzimin e metodave fizike për zgjidhjen e problemeve kimike. Në kuadër të lëndës do të shpjegohen bazat e termodinamikës kimike të cilat gjejnë zbatim të gjerë në shumë lëmi.

	<p>Poashtu do të trajtohen edhe ekuilibrat kimik. Një sqarim i detajuar do të jepet edhe për termodinamikën elektrokimike.</p>
Qëllimet e lëndës:	<p>Qëllim kryesor do të jetë njohja e sistemeve dhe proceseve termodinamike duke përfshirë edhe ekuilibrin kimik. Studentët do të mësojnë edhe bazat e termodinamikës elektrokimike e cila gjen zbatim në shumë procese tjera.</p>
Rezultatet e pritshme të nxënies:	<p>Pas përfundimit të këtij kursi (lënde) studenti do të jetë në gjendje që:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Të kuptoj dhe interpretoj proceset kimike në aspektin fiziko-kimik 2. Të shpjegoj parimet bazë të termodinamikës kimike dhe të përdorë këto të parime në termokimi. 3. Studenti do të dijë t'i dalloj dhe interpretoj proceset spontane dhe jospontane, ekuilibrat kimik etj. 4. Studenti do të njoh parimet bazë të elektrokimisë dhe zbatimin e tyre në farmaci, biokimi etj. 5. Studenti do të jetë në gjendje të përdorë teknikat e ndryshme në elektrokimi për përcaktim të substancave të ndryshme.

Obligimet e studentit (duhet të jetë në përputhje me Rezultatet e Nxënies të studentit)

Aktiviteti	Orë mësimore	Ditë/Javë	Gjithsej
Ligjëratat	2	15	30
Teori/ Ushtrime	-	-	-
Punë praktike/ Punë në laborator/	2	15	30
Konsultime me mësimdhënësin	1	5	5
Puna në terren	-	-	-
Testi, punimi seminarik	2	2	4
Detyrë shtëpie	-	-	-
Mësimi individual (në bibliotekë apo në shtëpi)	2	5	10
Përgatitja për provimin final	3	5	15
Koha e vlerësimit (testi, kuizi, provimi final)	2	3	6
Projektet, prezantimet, etj.	-	-	-
Total			100

Metodat e mësimdhënies:	<p>Ligjëratat, ushtrimet gjatë orëve të mësimit duke përdorë materiale të ndryshme, punë në grup prej 2-3 studentëve në një projekt (punë e pavarur), detyrë shtëpie individuale.</p>
Metodat e vlerësimit:	<p>Testi i parë provues: 15 % ; Testi i dytë provues: 15 % ; Ushtrimet: 20 % ; Provimi final: 50 %</p>

Literatura primare:	<p>1. P. Atkins P.; J. De Paula.; <i>Physical chemistry for the life sciences</i>, 2nd edition 2011, Oxford University Press Inc., New York, USA.</p> <p>2. R. Chang R., <i>Physical Chemistry for the Biosciences</i>, 1st edition 2005, University Science Books, California, USA.</p> <p>3. F. Podvorica, <i>Kimia fizike për studentët e Farmacisë</i>, dispencë, UP 2005.</p>
Literatura shtesë:	<p>1. Price N. C.; Dwek R. A.; Ratcliffe R.; Wormald M.; <i>Physical Chemistry for Biochemists</i>, 3rd edition 2001, Oxford University press Inc., New York, USA.</p>
Hartimi i planit mësimor	
Java	Titulli i ligjëratës
Java 1:	<p><i>Struktura e materies (lëndës)</i></p> <p>Struktura e atomit, përcaktimi i ngarkesës së elektronit, efekti fotoelektrik, modeli kuantik i atomit, spektrat atomik.</p>
Java 2:	<p>Modeli valor i atomit, funksionet valore, ekuacioni i Schrodinger-it, orbitalet atomike, sistemet hidrogjenoide dhe johidrogjenoide.</p>
Java 3:	<p>Lidhja kimike në molekula, molekulat dyatomike, mbimbulimi i orbitaleve atomike, molekula e hidrogenit, orbitalet molekulare lidhëse, antilidhëse dhe jolidhëse. Rendi i lidhjes.</p>
Java 4:	<p>Variablat mikroskopike dhe ato makroskopike. Funksionet e gjendjes. Proceset e prapsueshme dhe ato të paprapsueshme. Ligji i parë i termodinamikës.</p>
Java 5:	<p>Energjia, nxehtësia dhe puna. Ngjeshja dhe bymimi i prapsueshëm izotermik. Ngjeshja e prapsueshme në shtypje dhe vëllim konstant. Ngjeshja e prapsueshme adiabatike. Entalpia. Kapaciteti i nxehtësisë.</p>
Java 6:	<p>Avansimi i reaksionit. Gjendjet standarde. Matja e ndryshimeve të entalpisë. Kalorimetria. Marrëdhënia në mes ΔU dhe ΔH. Entalpitë e formimit. Entalpitë e lidhjeve. Varësia e entalpisë së reaksionit nga temperatura.</p>
Java 7:	<p>Ligji i dytë i termodinamikës. Cikli i Carnot-it. Rendimenti i makinës së Carnot-it. Interpretimi molekular i entropisë. Llogaritja e ndryshimit të entropisë. Ligji i tretë i termodinamikës.</p>
Java 8:	<p>Interpretimi molekular i energjisë së lirë të Gibbs-it. Energjitë e lira të Gibbs-it të formimit. Energjia e Gibbs-it dhe puna e prapsueshme. Ekuacioni i Gibbs – Helmholtz-it.</p>
Java 9:	<p>Madhësitë molare parcialesh. Potenciali kimik. Ekuilibri kimik i gazeve ideale dhe atyre joideale. Ekuilibri kimik në tretësira. Ekuilibri heterogjen. Varësia nga temperatura e konstantës së ekuilibrit.</p>
Java 10:	<p>Ligji i Raoult-it. Tretësirat ideale. Tretësirat joideale; aktiviteti dhe koeficientët e aktivitetit. Vetitë koligative të tretësirave. Osmoza. Potenciali kimik i tretësirave.</p>
Java 11:	<p>Ligjet e Faraday-it për elektrolizën. Përçueshmëria molare e elektrolitëve. Udhëtimi i pavarur i joneve në tretësirë, numrat e transportit. Përçueshmëritë jonike. Titullimi konduktometrik.</p>
Java 12:	<p>Teoria e Debye-Hückel-it për elektrolitët e fortë. Koeficientët e aktivitetit. Ekuilibri jonik. Jonizimi i ujit. Produkti i tretshmërisë. Asnjësimi i acideve me baza.</p>

Java 13:	Elementet galvanike. Potencialet standarde të elektrodave. Ekuacioni i Nernst-it. Potencialet e Nernst-it. Llojet e celulave elektrokimike. Potencialet membranore. Ekuilibri i Donnan-it.
Java 14:	Matja e pH-së. Koeficientëve të aktivitetit. Konstantave të ekuilibrit. Produktit të tretshmërisë.
Java 15:	Titullimet potenciometrike. Titullimet amperometrike

Politikat akademike dhe Kodi i Sjelljes

Ora mësimore fillon dhe përfundon me kohë.

Mjetet që përdorën gjatë orëve të mësimit duhet të pastrohen dhe të ruhen në fund të orës mësimore. Telefonat mobil/të mençur dhe pajisjet tjera elektronike (p.sh. iPod-ët) duhet të fikën (apo të kurdisen në vibrim) dhe të mos ekspozohen gjatë orëve të mësimit.

Laptopët dhe kompjuterët tabletë lejohen të përdorën vetëm në heshtje; aktivitetet tjera siç janë kontrollimi i e-mailit personal apo shfletimi i ueb-faqeve në internet janë të ndaluara.

17. Botanikë Farmaceutike

Informatat themelore për lëndën

Njësia akademike:	Fakulteti i Mjekësisë
Titulli i lëndës:	Botanikë Farmaceutike
Niveli:	Bachelor
Statusi i lëndës:	I obligueshëm
Viti i studimeve:	Viti i II-të Semestri i III-të dhe IV-të
Numri i orëve në javë:	2+0+2/ 2+0+2
Kreditë ECTS:	7 ECTS; për semester (3+4)
Koha / Vendi:	Klasa Sipas orarit
Mësimdhënësi:	Prof. Dr. Sc. Behxhet Mustafa
Të dhënat kontaktuese:	behxhet.mustafa@uni-pr.edu +383 (0) 44 129 671

Përshkrimi i lëndës:	<ul style="list-style-type: none"> Kursi Botanikë farmaceutike do të mbulojë aspektet të ndryshme të bimëve të cilat janë të rëndësishme në aspektin farmaceutikë, përfshirë këtu, citologjinë, histologjinë, anatominë, morfologjinë, fiziologjinë dhe klasifikimin e bimëve, me theks të veçanët atyre me përborim farmaceutik. Poashtu gjatë shtjellimi të kursit fokus i veçantë do të kushtohet përbërjes kimike të metaboliteve sekondar si dhe strukturave të veçantë të cilat përdoren për identifikimin e drogave.
Qëllimet e lëndës:	<ul style="list-style-type: none"> Të zhvilloj të njohurit lidhur me strukturat, format dhe përbërjen kimike të bimëve me rëndësi farmaceutike. Të analizojnë dhe vlerësoj aspekte të ndryshme të rëndësisë së bimëve në farmaci. Ti veçojnë dhe klasifikojnë grupet e ndryshme të bimëve me interes farmaceutikë.
Rezultatet e pritshme të nxënies:	<ul style="list-style-type: none"> Përshkruan strukturën, format dhe përbërjen kimike të llojeve të caktuara bimore dhe analizojnë rëndësinë e tyre farmaceutike. Emërton llojet e ndryshme të bimëve që kanë përdorim farmaceutik

	<ul style="list-style-type: none"> • Përshkruan dhe vlerëson rëndësinë e tyre në industrinë farmaceutike përfshinë këtu përbërjen kimike të llojeve dhe substancave bioaktive. • Analizon dhe vlerëson rëndësinë e bimëve për njeriun dhe dobitë që ai ka në shfrytëzimin e qëndrueshëm të bimëve. 		
Obligimet e studentit (duhet të jetë në përputhje me Rezultatet e Nxënies të studentit)			
Aktiviteti	Orë mësimore	Ditë/Javë	Gjithsej (për të dy semestrat)
Ligjëratat	2	30	60
Punë në laborator/Ushtime	2	25	50
Punë praktike			
Konsultime me mësimdhënësin			8
Puna në terren	2	5	10
Testi,			
Detyrë shtëpie			
Mësimi individual (në bibliotekë apo në shtëpi)			30
Përgatitja për provimin final			15
Koha e vlerësimit (testi, kuizi, provimi final)			2
Projektet, prezantimet, etj.			
Total			175
Metodat e mësimdhënies:	<ul style="list-style-type: none"> • Ligjëratat do të zhvillohen në formë të bashkëbisedimeve, punës grupore, seminare etj. • Ndërsa pjesa praktike do të realizohet në laborator si dhe punë në terren që do të përfshin përgatitjen e herbarit me bimë mjekësore. 		
Metodat e vlerësimit:	<ul style="list-style-type: none"> • Vlerësimi i parë: 25%, • Vlerësimi i dytë 25%, • Detyrat e shtëpisë ose prezantime 10%, • Vijimi i rregullt 10%, • Provimi final 30%, • Total 100%, • Nota do të llogaritet si më poshtë: <ul style="list-style-type: none"> ○ 51% - 60% = 6 ○ 61% - 70% = 7 ○ 71% - 80% = 8 ○ 81% - 90% = 9 ○ 91% - 100% = 10 		
Literatura primare:	<ul style="list-style-type: none"> • Topuzi, L. Botanika. SHLBU. Tiranë. • Xhulaj, M. Botanika-Sistematika e bimëve. Tiranë 		
Literatura shtesë:	<ul style="list-style-type: none"> • Miho, A. Topuzi, L. Marka, J. <i>Botanika e Pergjithshme</i>. Tiranë (2010) • Miho, A. Topuzi, L. Marka, J. <i>Botanika e Pergjithshme</i>. Tiranë (2008) • Pajazitaj, Q. <i>Përcaktues i bimëve (Pteridiofite dhe Spermatofite)</i>, Universiteti i Prishtinës. (2004) 		

	<ul style="list-style-type: none"> Judd, W. S., Campbell, C. S., Kellogg, E. A., Stevens, P. F. and Donoghue, M. J. <i>Plant Systematics: A Phylogenetic Approach</i>, 2nd ed. 2002. Sinauer Associates, Sunderland, MA. 576 pp. ISBN 0-87893-403-0 (2002).
--	--

Hartimi i planit mësimor për semestrin e III-të

Java	Titulli i ligjëratës
Java 1:	Hyrje në biologjinë e Bimëve (Botanikë)
Java 2:	Qeliza Bimore (Citoplazma, membrana qelizore, plastidet, mitokondriet dhe citoskeleti).
Java 3:	Nukleusi, nukleolusi, aparati mitotik, muri qelizor.
Java 4:	Vakuola dhe lëngu qelizorë (metabolitet sekondarë)
Java 5:	Hisiologjia e bimëve (Indet meristemmatike)
Java 6:	Indet mbrojtëse, indet përçuese, indet sekretuese. Vlerësimi i parë intermedier
Java 7:	Organet bimore
Java 8:	Struktura anatomike e kërcellit
Java 9:	Struktura anatomike e gjethes
Java 10:	Struktura anatomike e rrënjës
Java 11:	Frytet
Java 12:	Farat Vlerësimi i dytë intermedier
Java 13:	Fiziologjia bimore (rrjedha e energjisë, dhe transformimi i metabolitëve, përbërja kimike e bimëve)
Java 14:	Enzimet, fotosinteza, asimilimi, rregullimi i metabolizmit
Java 15:	Fiziologjia e ontogjenezës (rritja, diferencimi, organogjeneza dhe reproduktimi)

Hartimi i planit mësimor për semestrin e IV-të

Java	Titulli i ligjëratës
Java 1:	Klasifikimi, nomenklatura dhe identifikimi i bimëve
Java 2:	Talophyta- Bacteriophyta
Java 3:	Cyanophyta, Phycophyta
Java 4:	Mycophyta
Java 5:	Likenet
Java 6:	Myshqet Vlerësimi i parë intermedier
Java 7:	Pteridophyta - Ferns
Java 8:	Spermatophyta, Gymnospermae
Java 9:	Angiosperms
Java 10:	Dicotyledones- Magnoliidae
Java 11:	Chariophyllide
Java 12:	Dilleniidae Vlerësimi i dytë intermedier
Java 13:	Rosidae
Java 14:	Asteride
Java 15:	Monocotyledones

Politikat akademike dhe Kodi i Sjelljes

Studentët janë të obliguar në vijimin e rregullt në ligjëratat dhe ushtrime, marrin pjesë në vizita studimore në terren. Shkycja e telefonave celularë, hyrja me kohë në sallën e mësimi dhe mbajtja e qetësisë në mësim po ashtu janë obligative.

18. FIZIOLOGJI MJEKËSORE

Informatat themelore për lëndën			
Njësia akademike:	Fakulteti i Mjekësisë/Katedra e Fiziologjisë dhe Imunologjisë		
Titulli i lëndës:	Fiziologji Mjekësore		
Niveli:	Lëndë Paraklinike		
Statusi i lëndës:	Obligative		
Viti i studimeve:	Viti i II-të Semestri i III-të		
Numri i orëve në javë:	3+0+2		
Kreditë ECTS:	5 ECTS		
Koha / Vendi:	Sipas orarit/ Instituti B		
Mësimdhënësi:	Prof.Ass.Dr. Violeta Lokaj-Berisha		
Të dhënat kontaktuese:	violeta.lokaj@uni-pr.edu		
Përshkrimi i lëndës:	Fiziologjia është lëndë që studion proceset dhe funksionet e organizmit të njeriut. Fusha e studimit të Fiziologjisë fillon nga studimi i funksionit të molekulave dhe qelizave deri tek ndërveprimi i organizmit tonë me ambientin e jashtëm.		
Qëllimet e lëndës:	Qëllimi kryesor i lëndës Fiziologjia e njeriut është të ofroj një prezantim në detaje të funksionit të organeve dhe sistemeve të organeve të trupit të njeriut. Kjo lëndë është e dizajnuar në atë mënyrë që studentët të kuptojnë funksionin e secilit organ dhe sistem të organeve, mekanizmat rregullues në trupin e njeriut dhe integrimin fiziologjik të sistemit të organeve në ruajtjen e homeostazës		
Rezultatet e pritshme të nxënies:	<ul style="list-style-type: none"> - Përshkrimi i funksionit normal të qelizës, indeve dhe organeve në ruajtjen e pandryshueshme të ambientit të brendshëm - Dallimi i faktorëve nervor dhe endokrin në rregullimin e homeostazës - Identifikimi i veçorive funksionale të indeve të ngacmueshme - Krahasimi i funksionit të organeve përgjegjëse për shpërndarjen e materieve me qëllim të ruajtjes së homeostazës - Demonstrimi i matjes së parametrave vital - Analizimi i funksionit rregullues, integruar dhe komunikues ndërmjet shqisave dhe Sistemit neuroendokrin 		
Obligimet e studentit (duhet të jetë në përputhje me Rezultatet e Nxënies të studentit)			
Aktiviteti	Orë mësimore	Ditë/Javë	Gjithsej

Ligjëratat	3	1/15	45
Teori/Punë në laborator/Ushtrime	2	1/15	30
Punë praktike			
Konsultime me mësimdhënësin	1	1/6	6
Puna në terren			
Testi, punimi seminarik	1	1/2	2
Detyrë shtëpie			
Mësimi individual (në bibliotekë apo në shtëpi)			40
Përgatitja për provimin final			
Koha e vlerësimit (testi, kuizi, provimi final)			2
Projektet, prezantimet, etj.			
Total			125

Metodat e mësimdhënies:	Ligjëratat, ushtrimet praktike në laborator në grup prej 15 studentësh duke përdorë sistemin softverik, hardverik dhe kurrikular Biopac, punë e pavarur, detyrë shtëpie individuale
Metodat e vlerësimit:	Punim seminarik 5%; Vlerësimi i ushtrimeve 10%; Provimi përfundimtar 85%.

Literatura primare:	1. Artan Shkoza - Fiziologjia e njeriut 2. Praktikumi për punë me pajisjen Biopac 3. Praktikumi i Fiziologjisë
Literatura shtesë:	1. Guyton & Hall - Medical Physiology 2. Vander, Sherman, Luciano - Human Physiology. The mechanisms of Body Function 3. Silverthorn - Human Physiology 4. Stuart Ira Fox – Human Physiology

Hartimi i planit mësimor/ Ligjëratat	
Java	Titulli i ligjëratisë
Java 1:	Hyrje në Fiziologjinë Mjekësore - Organizimi funksional i trupit të njeriut . Homeostaza. Hapësira brendaqelizore dhe hapësira jashtëqelizore. Organizimi funksional i qelizës
Java 2:	Membrana qelizore. Transporti në nivel të membranës qelizore. Komunikimi nderqelizor dhe transduksioni i sinjaleve, Potenciali membranor në qetësi
Java 3:	Fiziologjia e nervave. Potenciali i graduar dhe potenciali i veprimit. Sinapsat nervore. Neurotransmiterët
Java 4:	Pllaka neuromuskulare. Fiziologjia e muskujve skeletike. Fiziologjia e muskulaturës së lëmuar. Fiziologjia e muskullit të zemrës.
Java 5:	Gjaku – përbërja dhe funksioni i tij. Plazma e gjakut dhe elementet e figuruar të gjakut. Hematokrit dhe sedimentimi i gjakut. Eritrocitet. Hemoglobina dhe roli i saj, Leukocitet. Grupet e gjakut. Hemostaza dhe koagulimi.
Java 6:	Zemra - Fiziologjia e zemrës. Potenciali i aksionit të muskullit të zemrës. Automatizmi i zemrës – sistemi për krijimin dhe

	përcjelljen e impulseve në zemër. Cikli i zemrës. Tonet e zemrës. Rregullimi i punës së zemrës. Elektrokardiograma.
Java 7:	Qarkullimi - Hemodinamika. Funksionet e sistemit arterial dhe venoz. Mikroqarkullimi dhe sistemi limfatik. Rregullimi i qarkullimit të gjaku. Mekanizmat për rregullimin e shtypjes së gjakut. Kontrolli humoral i rrjedhjes së gjakut në inde. Qarkullimi mushkëror. Qarkullimi koronar dhe qarkullimi i gjakut nëpër organe tjera të caktuara (tru, mëlçi etj)
Java 8:	Sistemi respirator - Mekanika e frymëmarrjes. Ventilimi mushkror. Shkëmbimi i gazrave. Transporti i gazrave. Rregullimi i frymëmarrjes. Frymëmarrja artificiale
Java 9:	Sistemi urinar - Veshkët dhe funksioni i tyre. Lëngjet e organizmit. Filtrimi glomerular. Aparati jukstglomerular. Apsorbimi dhe sekretimi në tubulet e veshkëve. Mekanizmi për eliminimin e urinës së koncentruar. Rregullimi i osmolaritetit të lëngjeve jashtëqelizore. Refleksi i urinimit
Java 10:	Sistemi gastrointestinal - Fiziologjia e sistemit gastrintestinal. Funksionet motorike të traktit gastrointestinal. Tretja dhe apsorbimi në lukth. Tretja dhe apsorbimi në zorrët e holla. Lëngu i Pankreasit. Funksionet e melcise. Tretja dhe apsorbimi në zorrët e trasha. Refleksi i defekimit
Java 11:	Metabolizmi i hidrateve të karbonit. Metabolizmi i yndyrnave. Metabolizmi i proteinave. Metabolizmi bazal dhe faktorët që ndikojnë në të. Rregulli i marrjes së ushqimit. Rregullimi i temperaturës. Qendra e termoregullimit.
Java 12:	Rolet e sistemit endokrin në kontrollin e funksionimit të organizmit. Gjëndrrat endokrine. Struktura e hormoneve. Mekanizmi i veprimit të hormoneve. Hormonet e hipofizës. Hormonet e tiroidesë. Hormonet e gjëndrrës paratiroide. Hormonet e gjëndrrës mbiveshkore. Hormonet e pankreasit. Hormonet e gjëndrrave seksuale.
Java 13:	Fiziologjia e sistemit nervor sensitiv. Fiziologjia e sistemit somatosenzor. Shqisa e të pamurit . shqisa e drejteshimit. Shqisa e të shijuarit . Shqisa e tënuhaturit.
Java 14:	Fiziologjia e sistemit motorik. Funksionet motorike të palcës kurrizore dhe ganglioneve bazale. Funksioni motorik i trurit dhe cerebellumit.
Java 15:	Funksionet integruese të sistemit nervor qendror. Te mësuarit dhe memorja. Sistemi nervor autonom.

Hartimi i planit mësimor/ Ushtrimet	
Java	Titulli i ligjëratës
Java 1:	Zgjedhja dhe përgatitja e kafshës eksperimentale për eksperiment. Dhënja e injeksioneve
Java 2:	Fiziologjia e nervave periferik (praktikum)
Java 3:	Muskujt (praktikum) Elektromiografia standarde dhe e integruar (leksioni 1) Rekrutimi i njësive motorike dhe lodhja e muskujve (leksioni 2)
Java 4:	Gjaku (praktikum)
Java 5:	Zemra (praktikum) EKG I (leksioni 5) EKG II (leksioni 6)
Java 6:	Qarkullimi I gjakut (praktikum) Shtypja e gjakut (leksioni 16)

Java 7:	Sistemi respirator (Leksioni 8) Sistemi respirator (Leksioni 12 & 13)
Java 8:	Sistemi urinar (praktikum)
Java 9:	Sistemi gastrointestinal (praktikum)
Java 10:	Metabolizmi (praktikum) Perpilimi I racioneve ushqimore
Java 11:	Sistemi endokrin (praktikum)
Java 12:	Shqisat (e të pamurit I/praktikum)
Java 13:	Shqisat (e të dëgjuarit dhe shqisat tjera)
Java 14:	Medulla spinale (praktikum) Reflekset klinike
Java 15:	Zëvendësimi i orëve të humbura

Politikat akademike dhe Kodi i Sjelljes

Ora mësimore fillon dhe përfundon me kohë.

Mjetet që përdorën gjatë orëve të mësimt duhet të pastrohen dhe të ruhen në fund të orës mësimore.

Telefonat mobil/të mençur dhe pajisjet tjera elektronike (p.sh. iPod-ët) duhet të fikën (apo të kurdisen në vibrim) dhe të mos ekspozohen gjatë orëve të mësimt.

Laptopët dhe kompjuterët tabletë lejohen të përdorën vetëm në heshtje; aktivitetet tjera siç janë kontrollimi i e-mailit personal apo shfletimi i ueb-faqeve në internet janë të ndaluara.

Shënim | Ushtrimet vlerësohen me notë prej 6 deri ne 10 ku secila notë konvertohet në pikë prej 0.1 deri ne 0.5 pikë. Në semestër do të vlerësohen 10 ushtrime kështu që studenti mund të grumbulloj maksimum 10 pikë të cilat përbëjnë 10% të notës përfundimtare (6-0.1, 7-0.2, 8-0.3, 9-0.4, 10-0.5).

Testi do të përmbaj 50 pyetje dhe do të zgjasë 60 minuta. Konsiderohet se studenti ka kaluar testin nëse arrinë 51% të pikëve maksimale. Rezultatet e testit do të shpallen një ditë pas mbajtjes së testit ndërsa pikët e fituara do të shndërrohen në notë përfundimtare. Konvertimi i notave në pike bëhet sipas skemës së mëposhtme (51-60=6, 61-70=7, 71-80=8, 81-90=8, >91=10)

19. METODOLOGJIA E PUNIMIT SHKENCOR

Informatat themelore për lëndën	
Njësia akademike:	Fakulteti i Mjekësisë/Departamenti i Farmacisë
Titulli i lëndës:	Metodologjia e punimit shkencor
Niveli:	Studimet themelore
Statusi i lëndës:	I obligueshëm
Viti i studimeve:	Viti i II-Të Semestri i III-të
Numri i orëve në javë:	2+0+0
Kreditë ECTS:	3 ECTS
Koha / Vendi:	Departamenti i Farmacisë Sipas orarit
Mësimdhënësi:	Prof. Asist. Rozafa Koliqi
Të dhënat kontaktuese:	rozafa.koliqi@uni-pr.edu
Përshkrimi i lëndës:	Ky modul mundëson njohjen e koncepteve të të mësuarit, metodologjisë së hulumtimit, studimit dhe prezentimit të punimeve shkencore, leximin- vleresimin kritik te punimeve shkencore dhe shfrytëzimin dhe kërkimin e literatures në libraritë elektoronike adekuate per punime shkencore.

Qëllimet e lëndës:	<ul style="list-style-type: none"> Mësojë studentet për llojet e hulumtimeve shkencore në mjekësi; Aftësojë studentët në planifikimin e pavarur të hulumtimit; Mënyrën e shkruarjes së punimit shkencor; Përdorimin e librarive elektronike dhe resurseve të librarive; Përshkrimi dhe interpretimin kritik të rezultateve të fituara.
Rezultatet e pritshme të nxënies:	<ul style="list-style-type: none"> Aftësojë studentët në planifikimin e pavarur të hulumtimit dhe mënyrën e shkruarjes së punimit shkencor Aftësoj studentët mbi mënyrat dhe metodat e grumbullimit të të dhënave dhe matjeve themelore për hulumtimin shkencor, analizimin dhe interpretimin e rezultateve të hulumtimit. Aftësojë studentët për shkruarjen e punimeve sipas metodologjisë së hulumtimeve shkencore Përshkrimi dhe interpretimi kritik i rezultateve të fituara Zgjedhja në mënyrë adekuate e testeve të përshtatshme statistikore, përshkrimi i limitimeve eventuale, interpretimi i rezultateve dhe intervaleve të besueshmërisë Aftësia për të shfrytëzuar faktet (të dhënat) kyçe nga burimet e të dhënave si dhe artikujt shkencor <p>Shfrytëzim i rrjeteve elektronike për mësim, kërkim të literaturës nga libraritë elektronike dhe prezantim para audiencës,</p>

Obligimet e studentit (duhet të jetë në përputhje me Rezultatet e Nxënies të studentit)

Aktiviteti	Orë mësi more	Ditë/Javë	Gjithsej
Ligjëratat	2	15	30
Teori/Punë në laborator/Ushtrime Punë praktike			
Konsultime me mësimdhënësin	1	5	5
Puna në terren			
Testi, punimi seminarik	1	5	5
Detyrë shtëpie			
Mësimi individual (në bibliotekë apo në shtëpi)	1	15	15
Përgatitja për provimin final	1	15	15
Koha e vlerësimit (testi, kuizi, provimi final)			3
Projektet, prezantimet, etj.	2	2	2
Total			75

Metodat e mësimdhënies:	Ligjerata, ushtrime përmes punës në grupe, seminare, mësimi i vetëdrejtuar, workshop.
Metodat e vlerësimit:	Kolokfium 20%; prezantimet 20%; vijimi i rregullt 10%; provimi final 50%.
Literatura primare:	1. Konceptet e ligjeratave 2. Pec B. Osnovne Statisticke Metode za Nematematicare,

	<p>3. Marušić M. i sur. Uvod u znanstveni rad u medicini. 3. izdanje. Zagreb: Medicinska naklada; 2004.</p> <p>4. Charles H. Hennekens, Julie E. Buring. Epidemiologjia në Mjekësi. Tiranë: Libri Universitar, 1998</p> <p>5. Thomas L. Najmlađa znanost: Bilješke promatrača medicine. Zagreb: Medicinska naklada; 1995.</p> <p>6. How to write scientific paper http://abacus.bates.edu/~ganderso/biology/resources/writing/HTWgeneral.html http://www.ruf.rice.edu/~bioslabs/tools/report/reportform.html#top</p> <p>7. Socijalna Medicina sa organizacijom zdravstva – Arif Smajkić</p>
Literatura shtesë:	

Hartimi i planit mësimor	
Java	Titulli i ligjeratës
<i>Java 1:</i>	Hyrja, njoftimi me lëndën (prezentimi i Syllabusit) Definicioni dhe lënda e studimit të metodologjisë së hulumtimit shkencor.
<i>Java 2:</i>	Rendesia e hulumtimeve shkencore dhe punes kerkimore shkencore. Shkenca si burim i njohurise
<i>Java 3:</i>	Llojet e hulumtimeve
<i>Java 4:</i>	Llojet e hulumtimeve –Hulumtimet Qualitative
<i>Java 5:</i>	Planifikimi i hulumtimit dhe vendosja e hipotezave te punes
<i>Java 6:</i>	Grumbullimi, perpunimi dhe komentimi i rezultateve
<i>Java 7:</i>	Indikatorët (treguesit) e shëndetit dhe rendesia e perdorimit te tyre. Madhësi të shoqërimit RISKU RELATIV , RAPORTI RELATIV I TEPRICËS (ODDS RATIO-OR) dhe RISKU ATRIBUTAR
<i>Java 8:</i>	Shkathësitë prezentuese
<i>Java 9:</i>	Kërkimi i informacionit në mjekësi. Rrjeti elektronik i te dhenave
<i>Java 10:</i>	Mjekësia e bazuar ne evidencë
<i>Java 11:</i>	Llojet e publikimeve shkencore
<i>Java 12:</i>	Ndërtimi i artikullit shkencor (Pjeset e artikullit shkencor).Shkrimi i artikullit shkencor Prezentimi i punimit ne revista
<i>Java 13:</i>	Leximi kritik i artikullit shkencor
<i>Java 14:</i>	Etika dhe puna shkencore-kerkimore

Java 15:	Rekapitulimi i lëndës dhe ligjerata përmbledhëse.
-----------------	---

Politikat akademike dhe Kodi i Sjelljes	
<ul style="list-style-type: none"> • Këshilli i njësisë akademike i përjashton nga Universiteti përgjithmonë ose përkohësisht studentët që i shkelin rëndë rregullat. Studentët e akuzuar për shkelje kanë të drejtë të dëgjohen nga komisioni disiplinor i cili e këshillon këshillin e njësisë akademike. Studentët e përjashtuar kanë të drejtë t’i ankohen Senatit i cili mund të konfirmojë ose të refuzojë vendimin e këshillit të njësisë akademike. • Rregulloret që i elaborojnë këto procedura nxirren nga Senati pasi të jenë konsultuar me parlamentin e studentëve. • Studentët kanë të drejtë të ankohen kundër vendimit të marrë prej organeve të Universitetit, të njësive akademike dhe njësive organizative që kanë të bëjnë me të drejtat, obligimet dhe përgjegjësitë e tyre. • Ankesat e tilla i dorëzohen komisionit të studimeve të njësisë akademike brenda 15 ditëve të punës pas shpalljes së vendimit. • Komisioni i studimeve është i obliguar t’ia dorëzojë raportin për vendimin e marrë këshillit të njësisë akademike brenda 30 ditëve të punës pas pranimit të ankesës. • Ankesa rreth vendimit në shkallë të parë vendoset nga Senati. 	

20. LËNDËT E PARA NË INDUSTRIJË FARMACEUTIKE

Informatat themelore për lëndën	
Njësia akademike:	Fakulteti i Mjekësisë – Dega e Farmacisë
Titulli i lëndës:	LËNDËT E PARA NË INDUSTRIJË FARMACEUTIKE
Niveli:	Studimet bazike te integruara
Statusi i lëndës:	Zgjedhore
Viti i studimeve:	Viti i II-rë Semestri i I-rë
Numri i orëve në javë:	2+0+0
Kreditë ECTS:	3 ECTS
Koha / Vendi:	Salla F2 Sipas orarit
Mësimdhënësi:	Prof.dr.ass.Arlinda Daka Grapci
Të dhënat kontaktuese:	Arlinda.daka@uni-pr.edu
Përshkrimi i lëndës:	Kjo lëndë do t’u ofroj studentëve njohuritë për proceset në zhvillimin e barnave të reja dhe gjenerike, pajisjeve dhe teknologjive të përdorura në prodhimin e barnave. Prezantimi i legjislacionit, standardeve dhe rregulloreve për industrinë farmaceutike. Ata do të mësojnë për GMP në industrinë farmaceutike .Në këtë cikël të ligjeratave poashtu trajtohen të gjitha burimet bibliografike duke filluar nga librat legjislative të njohura si “Pharmacopea” poashtu edhe një numri të konsideruar të Indeksve me rëndësi kryesore për të gjitha të dhënat me rëndësi në raport me parametrat fiziko kimike të këtyre lëndëve.

Qëllimet e lëndës:	Njohuri të mjaftueshme për lëndët e aktive dhe ato ndihmëse të cilat përdoren në industrinë farmaceutike dhe për procesin e zhvillimit të një bari të ri.		
Rezultatet e pritshme të nxënies:	Njohuri mbi ndryshimin midis një bari inovativ dhe një bari gjenerik. Njohuri për testet para-formulimit dhe çfarë mbulojnë ato, teknologjitë e përdorura për prodhimin e formave të ngurta orale, për format gjysëm të ngurta dhe të lëngshme.		
Obligimet e studentit (duhet të jetë në përputhje me Rezultatet e Nxënies të studentit)			
Aktiviteti	Orë mësimore	Ditë/Javë	Gjithsej
Ligjëratat	2	15	30
Teori/Punë në laborator/Ushtrime			
Punë praktike			
Konsultime me mësimdhënësin	0.5	8	4
Puna në terren			
Testi, punimi seminarik	1	5	5
Detyrë shtëpie	2	5	10
Mësimi individual (në bibliotekë apo në shtëpi)	1	15	15
Përgatitja për provimin final	3	3	9
Koha e vlerësimit (testi, kuizi, provimi final)	2	1	2
Projektet, prezantimet, etj.			
Total			75
Metodat e mësimdhënies:	Mësimi është i rregullt dhe organizohet në formë të ligjëratave dhe seminareve në grupe më të mëdha duke shfrytëzuar metodat moderne të mësimdhënies si diskutimin interaktiv.		
Metodat e vlerësimit:	Pjesëmarrja dhe angazhimi në ligjerata 10% Pjesëmarrja dhe angazhimi në seminare 30% Provimi final 60% Gjithsej 100%		
Literatura primare:	Engel J, Kleemann A, Kutscher B, Reichert D. Pharmaceutical Substances, 2009: Syntheses, Patents and Applications of the Most Relevant APIs. Georg Thieme Verlag; 2014 Nusim S, editor. Active pharmaceutical ingredients: development, manufacturing, and regulation. CRC Press; 2016. M. Gibson: Pharmaceutical Preformulation and Formulation, 2001, IHS Health Group, Denver, USA		
Literatura shtesë:	European Pharmacopeia British Pharmacopeia United States Pharmacopeia Swarbrick, J., Boylan, J.C. Encyclopedia of Pharmaceutical Technology, Marcel Dekker Inc., New York, Basel, 2007		

Hartimi i planit mësimor	
Java	Titulli i ligjëratës
Java 1:	Hyrja, njohimi me lëndën (prezentimi i Syllabusit) koncepti dhe objektivat e përgjithshme.
Java 2:	Përbërësit aktivë farmaceutikë
Java 3:	Metodat e prodhimit farmaceutik, dizanjimi dhe prodhimi i produkteve farmaceutike të gatshme
Java 4:	GMP
Java 5:	Format e ndryshme të dozimit dhe vetitë e tyre
Java 6:	Format e dozimit të ngurta dhe gjysmë të ngurta
Java 7:	Format të lëngshme të dozimit
Java 8:	Farmakopetë
Java 9:	Testet bazike për substancat aktive dhe produktet farmaceutike
Java 10:	Kontaminuesit
Java 11:	Ekscipientët I – një vështrim i përgjithshëm
Java 12:	Ekscipientët II
Java 13:	Vlerësimi i cilësisë së produktit
Java 14:	Biodisponueshmëria dhe bioekuivalenca, metodat e testimit, interpretimi i rezultateve, qasjet rregullatore dhe shkencore.
Java 15:	Produkte biologjike dhe bioteknologjike

Politikat akademike dhe Kodi i Sjelljes

*Ora mësimore fillon dhe përfundon me kohë.
Mjetet që përdorën gjatë orëve të mësimi duhet të pastrohen dhe të ruhen në fund të orës mësimore.
Telefonat mobil/të mençur dhe pajisjet tjera elektronike (p.sh. iPod-ët) duhet të fikën (apo të kurdisen në vibrim) dhe të mos ekspozohen gjatë orëve të mësimi.
Laptopët dhe kompjuterët tabletë lejohen të përdorën vetëm në heshtje; aktivitetet tjera siç janë kontrollimi i e-mailit personal apo shfletimi i ueb-faqeve në internet janë të ndaluara.*

21. DIETETIKA

Informatat themelore për lëndën	
Njësia akademike:	Fakulteti i Mjekësisë, Dega e Farmacisë
Titulli i lëndës:	Dietetika
Niveli:	Diplomë universitare
Statusi i lëndës:	Zgjedhore
Viti i studimeve:	Viti i II-të Semestri i III-të
Numri i orëve në javë:	1+1+0
Kreditë ECTS:	3 ECTS
Koha / Vendi:	Sipas orarit
Mësimdhënësi:	Prof.ass.dr. Zana Sulejmani-Ibraimi
Të dhënat kontaktuese:	Email: zana.ibraimi@uni-pr.edu Tel: +38344330362
Përshkrimi i lëndës:	<p>Dietetika është një disiplinë që merret me studimin e ushqimit dhe të ushqyerit dhe që përcakton se si ushqimi i mirë ndikon në shëndetin e përgjithshëm të njeriut. Kjo fushë ofron një fokus të fortë në shëndetin publik dhe qëllimi i saj kryesor është edukimi i popullatës mbi rëndësinë e zgjedhjeve të duhura dietike.</p> <p>Dietetika është një fushë shkencore që përqendrohet në përshkrimin e terapisë mjekësore ushqimore dhe konsultimin dietik për të trajtuar gjendjet shëndetësore.</p>
Qëllimet e lëndës:	<p>Qëllimi i kësaj lënde është t'i përgatis studentët që të zhvillojnë njohuritë dhe aftësitë e tyre në shkencën e të ushqyerit, dietologjinë dhe ushqimin klinik.</p> <p>Qëllim tjetër është përvetësimi i njohurive në lidhje me ushqimet funksionale dhe produktet dietetike, përfshirë llojet, kategoritë dhe karakteristikat themelore.</p> <p>Ndër objektivat e kësaj lënde është përgatitja e studentëve për njohjen e etiologjisë dhe patofiziologjisë së sëmundjeve të ndryshme, si diabetit, sëmundjeve kardiovaskulare, anemisë, sëmundjeve të aparatit tretës, njohjen e proceseve themelore biokimike në trup dhe njohjen e aspekteve fiziologjike e biokimike të të ushqyerit, si dhe kuptimin e vlerave të konsumit (marrjes) së rekomanduar ditore (DRI).</p>
Rezultatet e pritshme të nxënies:	<p>Studentët do të zhvillojnë aftësi për të identifikuar, analizuar në mënyrë kritike dhe zgjidhur problemet e të ushqyerit të pacientëve. Ata do të arrijnë të vlerësojnë statusin ushqyes të pacientit dhe të mësojnë për specifikat e dietës sipas kushteve fiziologjike. Studentët do të njihen me parametrat dhe udhëzimet themelore të dietologjisë mjekësore, do të njihen me përdorimin e duhur të suplementeve ushqimore, dozën e tyre dhe sigurinë e përdorimit, varësisht nga gjendja patologjike e pacientëve dhe nevojave sipas grup moshave. Ata do të zotërojnë aftësitë të këshillojnë pacientët e moshave të ndryshme</p>

	dhe pacientët me kushte specifike fiziologjike (shtatzëni, laktacion) për ushqimin e duhur dhe shtesat plotësuese.												
Obligimet e studentit (duhet të jetë në përputhje me Rezultatet e Nxënies të studentit)													
Aktiviteti	Orë mësimore	Ditë/Javë	Gjithsej										
Ligjëratat	1	15	15										
Teori/Punë në laborator/Ushtime													
Punë praktike													
Konsultime me mësimdhënësin	1	2	2										
Puna në terren													
Testi, punimi seminarik	1	15	15										
Detyrë shtëpie	1.5	1	1.5										
Mësimi individual (në bibliotekë apo në shtëpi)			24.5										
Përgatitja për provimin final	1	15	15										
Koha e vlerësimit (testi, kuizi, provimi final)	1	1	1										
Projektet, prezantimet, etj.	1	1	1										
Total			75										
Metodat e mësimdhënies:	Ligjëratat mbahen në formë interaktive. Prezentimi bëhet në LCD projektor, duke diskutuar me studentë për çështjet e paraqitura. Organizohen seminare të shkurtra brenda leksioneve të planifikuara.												
Metodat e vlerësimit:	<p>Metoda e vlerësimit bëhet me teste dhe kolloqfiume. Provimi zhvillohet me shkrim, ku çdo pyetje në test dhe kolloqfium vlerësohet me një numër pikësh.</p> <p>Mënyra e vlerësimit:</p> <table style="width: 100%; border: none;"> <tr> <td>Kolloqfiumi</td> <td style="text-align: right;">10 %</td> </tr> <tr> <td>Seminaret apo angazhime tjera</td> <td style="text-align: right;">20 %</td> </tr> <tr> <td>Vijimi i rregullt në ligjërata</td> <td style="text-align: right;">10 %</td> </tr> <tr> <td>Provimi final</td> <td style="text-align: right;">60 %</td> </tr> <tr> <td>Gjithsej:</td> <td style="text-align: right;">100 %</td> </tr> </table> <p>Konsultimet me studentë bëhen 2(dy) herë në javë. Seminaret organizohen gjatë semestrit.</p>			Kolloqfiumi	10 %	Seminaret apo angazhime tjera	20 %	Vijimi i rregullt në ligjërata	10 %	Provimi final	60 %	Gjithsej:	100 %
Kolloqfiumi	10 %												
Seminaret apo angazhime tjera	20 %												
Vijimi i rregullt në ligjërata	10 %												
Provimi final	60 %												
Gjithsej:	100 %												
Literatura primare:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Thomas B, Bishop J, editors. Manual of dietetic practice. John Wiley & Sons; 2013 Jul 8. 2. Lutz CA, Mazur E, Litch N. Nutrition and diet therapy. FA Davis; 2014 Aug 14. 3. Roth RA. Nutrition & diet therapy. Cengage Learning; 2013 Feb 28. 4. Lawrence J, Gandy J, Douglas P, editors. Dietetic and Nutrition Case Studies. John Wiley & Sons; 2016 Feb 11. 5. Kazaks A, Stern JS. Nutrition and Obesity: Assessment, Management & Prevention. Jones & Bartlett Publishers; 2013. 												

	6. Mosen ER, Rock C, Coulston AM. Nutrition in the Prevention and Treatment of Disease. Academic Press; 2001. 7. Mudambi SR. Fundamentals of foods, nutrition and diet therapy. New Age International; 2007.
Literatura shtesë:	Nga publikimet në internet (PubMed, MedLine, etj)
Hartimi i planit mësimor	
Java	Titulli i ligjëratisë
<i>Java 1:</i>	Hyrje, objekti i studimit dhe rëndësia e shkencës së Dietetikës
<i>Java 2:</i>	Ushqimi i ciklit jetësor, statusi ushqyes dhe koncepti i ushqimit dietetik e funksional
<i>Java 3:</i>	Produktet dietetike, lëndët ushqimore, ushqimet e fortifikuara, të pasuruara dhe modifikuara
<i>Java 4:</i>	Efekti parandalues dhe terapeutik i ushqimit funksional. Futja e përbërësve funksionalë në ushqimin e pasuruar (zhvillimi, formulimi dhe qëndrueshmëria e produktit). Siguria funksionale e ushqimit.
<i>Java 5:</i>	Ushqimi dhe plotësimi gjatë shtatëzënësisë dhe laktacionit, vitaminat, mineralet dhe suplementet ushqimore gjatë shtatëzënësisë dhe laktacionit.
<i>Java 6:</i>	Ushqyerja e foshnjave dhe fëmijëve, plotësimi i ushqimit në fëmijëri. Modele specifike dietetike të foshnjave dhe fëmijëve. Formula për foshnje dhe ushqime për fëmijë.
<i>Java 7:</i>	Ushqimi për adoleshentët, nevojat specifike ushqyese dhe modelet ushqyese
<i>Java 8:</i>	Ushqimi në moshën e rritur: ndryshimet në modelet dietike dhe plotësimi, roli në parandalimin e sëmundjeve.
<i>Java 9:</i>	Ushqimi i të moshuarve, modele të veçanta dietike, probleme të të ushqyerit, kequshqyerja dhe plotësimi i ushqimit
<i>Java 10:</i>	Ushqimi dhe të ushqyerit për atletët (sportistët)
<i>Java 11:</i>	Mbipesha dhe obeziteti, anoreksia dhe bulimia
<i>Java 12:</i>	Terapia dietike për diabetin dhe para-diabetin. Koordinimi i vakteve me terapinë me insulinë. Terapia dietike për ndërlikimet e diabetit (hipoglikemia, ketoacidoza). Shtesat dietike në diabet
<i>Java 13:</i>	Terapia dietike e sëmundjeve kardiovaskulare - arteroskleroza, hipertensioni. Parametrat bazë biokimikë. Rëndësia e mbajtjes së një peshe normale të trupit. Sindroma metabolike dhe dieta mesdhetare. Shtesat dietike në sëmundjet kardiovaskulare
<i>Java 14:</i>	Terapia dietike e anemisë, terapia dietike e anemisë me mungesë hekuri. Shtesat dietike në trajtimin e anemisë dhe parandalimi
<i>Java 15:</i>	Terapia dietike e sëmundjeve të aparatit tretës. Ushqimi për njerëzit me çrregullime metabolike. Identifikimi dhe karakterizimi i përbërësve bioaktivë të ushqimit. Probiotikët, prebiotikët dhe simbiotikët

Politikat akademike dhe Kodi i Sjelljes

Ora mësimore fillon dhe përfundon me kohë.

Mjetet që përdoren gjatë orëve të mësimit duhet të pastrohen dhe të ruhen në fund të orës mësimore. Profesori dhe asistenti i informojnë studentët për kriteret e pjesëmarrjes së rregullt në ligjërata dhe ushtrime. Ata i përcaktojnë rregullat e sjelljes, siç janë mbajtja e qetësisë gjatë ligjëratave dhe ushtrimeve, saktësia e ardhjes në kohë të duhur në ligjërata dhe ushtrime, fikja e telefonave celularë, apo ndonjë mjeti tjetër të mençur, etj.

Profesori dhe asistenti duhet të tregojnë qëndrim intelektual, pragmatik dhe kolegial, duke i inkurajuar gjithnjë studentët drejt suksesit.

Shënim | Nëse 3 detyra të klasës të një studenti vlerësohen nën 50%, atëherë ai/ajo do ta humbë të drejtën që t'i nënshtrohet provimit final. Vlerësimi bëhet nga 0-100 %.

22. HYRJE NË KIMI FARMACEUTIKE

Informatat themelore për lëndën	
Njësia akademike:	Fakulteti i Mjekësisë/Departamenti i Farmacisë
Titulli i lëndës:	HYRJE NË KIMI FARMACEUTIKE
Niveli:	Studimet themelore
Statusi i lëndës:	I obligueshëm
Viti i studimeve:	Viti i II Semestri i IV-të,
Numri i orëve në javë:	3+0+3;
Kreditë ECTS:	6 ECTS
Koha / Vendi:	Departamenti i Farmacisë Sipas orarit
Mësimdhënësi:	Prof. Asist. Pranvera Breznica Selmani
Të dhënat kontaktuese:	Pranvera.breznica@uni-pr.edu
Përshkrimi i lëndës:	<p>Kjo lëndë merret me studimin bazike duke filluar nga koncepti themelor i vetive fizikokimike të grupeve funksionale të barnave pastaj rrugët e metabolizmit, mënyrat e aplikimit si dhe vlerësimin e kualitetit të tyre. Trajtohen konceptet që të arrihet lidhja mes strukturës kimike dhe përgjigjes në nivel molekular.</p> <p>Kjo lëndë rezulton të ketë një rol esencial për tu kuptuar studimi sistematik i grupeve të ndryshme të barnave me përmbajta inorganike duke sqaruar mekanizëm të tyre të veprimit dhe përdorimit terapeutik.</p>
Qëllimet e lëndës:	<p>Qëllimi i lëndës është të fitohen njohuri të nevojshme mbi barnat, duke filluar nga vetit fizikokimike të të barnave pastaj rrugët e metabolizmit, mënyrat e aplikimit si dhe vlerësimin e kualitetit të tyre.</p> <p>Të fitohen njohuri të nevojshme që të arrihet lidhja mes të dhënave kimike dhe atyre biologjike respektivisht sqarimet mes strukturës kimike dhe përgjigjes në nivel molekular.</p> <p>Të fitohen njohuri të nevojshme që të arrihet lidhja mes komponimeve inorganike dhe aplikimi i tyre në farmaci. Objektive është që studentët të njohin konceptet kryesore të kimit inorganike dhe të ilistroj ato me shembuj të rëndësishëm për farmacinë duke filluar nga komponimet inorganike që përdoren si antacide, antimikobial për sy e deri të përdorimi i tyre si barnat antikanceroze.</p>

Rezultatet e pritshme të nxënies:	<ul style="list-style-type: none"> • Të kuptohet marrëdhënia ndërmjet strukturës kimike, vetive fiziko-kimike, veprimit farmakologjik dhe aplikimit terapeutik të barit. • Të kuptohet marrëdhënia ndërmjet strukturës kimike dhe përgjigjes biologjike respektivisht interaksionit të barit me receptorin. • Të kuptohet marrëdhënia ndërmjet strukturës kimike të barit dhe veprimit farmakologjik, • Të fitohen njohuri për profilin farmakokinetik dhe farmakodinamik të barit. • Të fitohen njohuri rreth barnave me përbmatje inorganike dhe efektet e tyre farmaceutikë. • Të fitohen njohuri për themelore për efektet sterike, induktive, elektronike dhe implikimet e tyre në veprimin e barit. • Të fitohen njohuri të nevojshme për përdorimin e metodave analitike respektivisht metodave spektrale për identifikimin e strukturës grupeve funksionale, përcaktimin kuantitativ të lëndëve aktive si dhe përcaktimin e shkallës së pastërtisë. • Njohuri për mbledhjen dhe shfrytëzimin e informacionit kimik dhe farmaceutik në lidhje me një bar të caktuar.
-----------------------------------	---

Obligimet e studentit (duhet të jetë në përputhje me Rezultatet e Nxënies të studentit)

Aktiviteti	Orë mësimore	Ditë/Javë	Gjithsej
Ligjëratat	3	15	45
Teori/Punë në laborator/Ushtime	3	15	45
Punë praktike			
Konsultime me mësimdhënësin	1	5	5
Puna në terren			
Testi, punimi seminarik	1	5	5
Detyrë shtëpie			
Mësimi individual (në bibliotekë apo në shtëpi)			25
Përgatitja për provimin final	2	10	20
Koha e vlerësimit (testi, kuizi, provimi final)			3
Projektet, prezantimet, etj.	1	2	2
Total			150

Metodat e mësimdhënies:	Mësimi do të jetë i rregullt, dhe do të organizohen ligjëratat grupore, punë seminarike në grupe të vogla, zbatim i metodës PBL (problem-based learning), dhe në kuadër ushtrimeve do të aplikohen metoda analitike dhe spektrale për identifikimin e strukturave kimike të barnave, grupeve funksionale, përcaktimin kuantitativ të lëndëve aktive si dhe përcaktimin e shkallës së pastërtisë.
Metodat e vlerësimit:	Vlerësimi i parë 15%; vlerësimi i dytë 15%; prezantimet 20%; vijimi i rregullt 10%; provimi final 40%.

Literatura primare:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Strohfeldt KA. Essentials of inorganic chemistry: For students of pharmacy, pharmaceutical sciences and medicinal chemistry. John Wiley & Sons; 2015 Feb 16. 2. J.M. Beale; J.Block. Wilson and Gisold's Textbook of Organic Medicinal and Pharmaceutical Chemistry; Lippincott Williams & Wilkins; 12-th Edition (March 2, 2010) 3. Lemke TL, Williams DA, editors. Foye's principles of medicinal chemistry. Lippincott Williams & Wilkins; 2012 Jan 24.
Literatura shtesë:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Wermuth CG, editor. The practice of medicinal chemistry. Academic Press; 2011 May 2. 2. Dashnor Nebija. Analiza farmaceutike farmakopeale. Manual laboratorik. Universiteti i Prishtines. 2005. 3. European Pharmacopoeia 5.0; British Pharmacopoeia; USP/NF; other national Pharmacopoeias and Compendiums
Hartimi i planit mësimor	
Java	Titulli i ligjeratës / Semestri i parë
Java 1:	Bazat fiziko-kimike të barnave- tretshmëria, koeficienti i ndarjës LogP, koeficienti i shpërndarjes logD, lipofiliteti ndikimi i vetive fiziko-kimike në veprimin e barit.
Metodat e mesimdhënies:	Mësimi do të mbahet në formën e ligjeratave interaktive, punes laboratorike, prezentimeve dhe diskutimeve ne klasë të seminareve, mësimi i vetëdrejtuar.		
Metodat e vlerësimit:	Studentët do të vlerësohen vazhdimisht. Vlerësimet specifike do të bëhen nëpërmjet 3 komponenteve: 1) kollokfiumit (30%); 2) punes seminarike dhe laboratorike (20%) dhe 3) provimit përfundimtar (50%). Nota përfundimtare e studentit do të llogaritet në bazë të mesatares nga tre komponentet e sipërhënuara.		
Literatura primare:	<p>- Ligjëratat dhe materialet tjera të përgatitura nga mesimdhënësit</p> <p>-Heinrich M et al. Fundamentals of Pharmacognosy and Phytotherapy. 3rd edition. Elsevier. 2018</p> <p>-US Department of Health and Human Services. National Centre for Complementary and Integrative Health (NIH), [online]: https://nccih.nih.gov/</p> <p>- EMA. Herbal Monographs . [online] https://www.ema.europa.eu/en/human-regulatory/herbal-products/european-union-monographs-list-entries</p>		
Literatura shitesë:	<p>-Natural Medicines. Databases & Effectiveness. http://naturaldatabase.therapeuticresearch.com/</p> <p>-Zef Sima dhe Vilma Papajani; Farmakognozja, Tiranë, 2008</p>		

-Trease and Evans. Pharmacognosy, Ed. WC Evans; 16th edition; London 2009

Hartimi i planit mësimor

Java (semestri 1)	Titulli i ligjëratës (Farmakognozi)
Java 1:	Rëndësia e bimëve në mjekësinë dhe farmacinë moderne
Java 2:	Farmakognozia dhe historia e saj: njerëzit, bimët dhe produktet natyrore
Java 3:	Sistemet tradicionale të barnave herbale
Java 4:	Mbledhja, tharja dhe ruajtja e substancave bimore për përdorim mjekësor
Java 5:	Bimët mjekësore në trevat tona
Java 6:	Sakaridet, acidet bimore dhe substancat përkatëse
Java 7:	Vajrat, dyllrat, mucilagjet dhe substancat përkatëse
Java 8:	Alkaloidet dhe substancat përkatëse 1
Java 9:	Alkaloidet dhe substancat përkatëse 2
Java 10:	Glikozidet dhe substancat përkatëse
Java 11:	Taninet, antraglikozidet dhe substancat përkatëse
Java 12:	Kumarinat, flavonoidet dhe substancat përkatëse
Java 13:	Vajrat eterike dhe substancat përkatëse
Java 14:	Produktet natyrore mikrobiale (bakteret dhe kërpudhat)
Java 15:	Produktet natyrore antikancerogjene

Java (semestri 2)	Titulli i ligjëratës (Barnat Komplementare)
Java 1:	Barnat komplementare dhe roli farmacistit
Java 2:	Koncepti i mjekësisë integrative
Java 3:	Shqyrtimi i evidencës në barnat komplementare
Java 4:	Siguria e barnave komplementare
Java 5:	Ndërveprimet e barnave herbale
Java 6:	Suplementet me vitaminat dhe minerale 1
Java 7:	Suplementet me vitaminat dhe minerale 2
Java 8:	Barnat komplementare për sistemin nervor qendror
Java 9:	Barnat komplementare për sistemin kardiovaskular
Java 10:	Barnat komplementare për sistemin gastrointestinal
Java 11:	Barnat komplementare për sistemin respirator
Java 12:	Barnat komplementare për sistemit muskuloskeletor
Java 13:	Barnat komplementare për sistemit endokrin
Java 14:	Barnat komplementare kundër infeksioneve
Java 15:	Barnat tjera komplementare

Politikat akademike dhe Kodi i Sjelljes

Ora mësimore fillon dhe përfundon me kohë.
Mjetet që përdorën gjatë orëve të mësimit duhet të pastrohen dhe të ruhen në fund të orës mësimore.
Telefonat mobil/të mençur dhe pajisjet tjera elektronike (p.sh. iPod-ët) duhet të fikën (apo të kurdisen në vibrim) dhe të mos ekspozohen gjatë orëve të mësimit.
Laptopët dhe kompjuterët tabletë lejohen të përdorën vetëm në heshtje; aktivitetet tjera siç janë kontrollimi i e-mailit personal apo shfletimi i ueb-faqeve në internet janë të ndaluara.

Studenti duhet të ketë ID me rastin e hyrjes në provim.

Plagjiarizmi

Plagjiarizmi do të monitorohet me rreptësi në këtë lëndë. Plagjiati ndodh kur puna ose prona e një studenti apo individi tjetër paraqitet si punë vetanake pa referim adekuat. Prandaj, punimet që dorëzohen në këtë lëndë do t'i nënshtrohen detektimit për plagjiarism.

31. BIOKIMI KLINIKE

Informatat themelore për lëndën	
Njësia akademike:	Fakulteti i Mjekësisë-Drejtimi: Farmaci; Katedra e Biokimisë
Titulli i lëndës:	Biokimi klinike
Niveli:	BA
Statusi i lëndës:	I obligueshëm
Viti i studimeve:	Viti i III-të Semestri i V
Numri i orëve në javë:	2+0+2
Kreditë ECTS:	4 ECTS
Koha / Vendi:	8.0- 10:35 ; Salla F1.
Mësimdhënësi:	Prof. Asoc. Hidajet Paçarizi; Prof. Asoc Valdete Topçiu-Shufta ; Prof. Ass. Zana Baruti Gafurri
Të dhënat kontaktuese:	Instituti i Biokimisë tel. 038/ 500-500-2302, 500-600-2309, 044 117 027, 049 137 239, 044 220 589.
Përshkrimi i lëndës:	Biokimia klinike përshkruan në terma kimik proceset patologjike, strategjinë e diagnozës së tyre si dhe mekanizmat e veprimit të medikamenteve dhe monitorimin e trajtimit me medikamente. Homeostazen e glucideve, lipideve, proteinave etj. në organizëm, patologjite që lidhen me to si dhe mekanizmat biokimike të veprimit. Pjesë e pandarë e biokimisë klinike janë dhe teknikat laboratorike

Qëllimet e lëndës:

Plan –programi i lëndës është i pregaditur me qëllim që ti aftësoi studentët për aplikimin sa më adekuat të analizave kliniko-biokimike dhe mundëson njohjen e proceseve patologjiko-biokimike, të sëmundjeve të ndryshme. Nëpërmjet të këtij kursi studenti do të përvetësojë principet e përgjithshme për vlerësimin sa më të drejtë të analizave laboratorike duke u nisur nga specifiteti, ndjeshmëria dhe rëndësia klinike e tyre. Qëllimi i studimit të Biokimisë klinike është njohja me principet dhe aplikimi i kërkimeve diagnostike në diagnostikimin, shërimin dhe prevencën e sëmundjeve të ndryshme.

Rezultatet e pritshme të nxënies:

Pas përfundimit të këtij kursi (lënde) studenti do të jetë në gjendje që:

1. Të kuptoj ndryshimet molekulare si pasojë e veprimit të faktorëve patologjik .
2. Te kuptoj rëndësinë e lëndës të Biokimisë Klinike në kuptimin e interpretimit te rezultateve, për diagnostikimin dhe trajtimin e sëmundjeve të ndryshme.
3. Të përcaktoi vlerësimin e drejtë dhe racional të parametrave specifik biokimik.
4. Aftësimi për të diskutuar shkakun dhe pasojat e sëmundjeve të njeriut që rrjedhin nga çrregullimet e proceseve normale metabolike .

Obligimet e studentit (duhet të jetë në përputhje me Rezultatet e Nxënies të studentit)

Aktiviteti	Orë mësimore	Ditë/Javë	Gjithsej
Ligjëratat	2	15	30
Teori/Punë në laborator/Ushtime	2	15	30
Punë praktike			
Konsultime me mësimdhënësin	1	3	3
Puna në terren			
Testi, punimi seminarik			
Detyrë shtëpie			
Mësimi individual (në bibliotekë apo në shtëpi)	2	15	20
Përgatitja për provimin final			15

Koha e vlerësimit (testi, kuizi, provimi final)			2
Projektet, prezantimet, etj.			
Total			100
Metodat e mësimdhënies:	Mësimi është i rregullt me ligjërime teorik, punë në grupime të caktuara, forma të paraqitjes teorike dhe realizimi praktik në laborator i funksionit të molekulave.		
Metodat e vlerësimit:	Vlerësimi bëhet me test ose me gojë. Pyetjet do të përgaditen nga banka e pyetjeve të cilat do të selektohen nga ekipi i profesorëve. Ato do të jenë të kombinuara; me një përgjigje të saktë, me disa përgjigje të sakta dhe me mundësi plotësimi me shkrim.		
Literatura primare:	<ol style="list-style-type: none"> Allan Graw and all. --Biokimi klinike ,botimi katër (perkthyer shqip).2012. Michael Murphy, Rajeev Srivastava and Kevin Deans. Clinical Biochemistry. 2018. William Marshall, Márta Lapsley, Andrew Day., Kate Shipman. Clinical Chemistry. Ninth Edition, 2021 Nader Rifai, Andrea Rita Horvath and Carl T. Wittwer. Tietz fundamentals of clinical chemistry and molecular diagnostics. Eighth edition. 2019. 		
Literatura shtesë:	<ul style="list-style-type: none"> Andrea Rita Horvath, Carl Wittwer, Nader Rifai. Tietz Textbook of Clinical Chemistry and Molecular Diagnostics Sixth Edition. 2017. Dubravka Čvorišćec , Ivana Čepelak. Strausova medicinska biokemija, 2000, Zagreb 		

Hartimi i planit mësimor

Java	Titulli i ligjëratës
Java 1:	Organizimi i punës në laboratorët klinikë dhe detyrat e biokemistit klinik
Java 2:	Parimet e teknikave laboratorike
Java 3:	Uji dhe elektrolitet
Java 4:	Ekulibri acido bazik
Java 5:	Roli diagnostik i përcaktimit të proteinave

Java 6:	Produktet azotike jo proteinike
Java 7:	Proteinat specifike të plazmës, Hemoproteinat
Java 8:	Metabolizmi i karbohidrateve dhe rëndësia e përcaktimit
Java 9:	Enzimologjia klinike
Java 10:	Aktiviteti i enzimave ne sëmundjet e organet e ndryshme
Java 11:	Rëndësia e përcaktimit të lipideve në organizem .Trigliceridet
Java 12:	Veprimi i medikamenteve ne analitë biokimik
Java 13:	Endokrinologjia klinike
Java 14:	Markuesit tumoral dhe rëndësia klinike
Java 15:	Rëndësia diagnostike e ekzaminimit të lëngjeve trupore

Politikat akademike dhe Kodi i Sjelljes

Ora mësimore fillon dhe përfundon me kohë. Telefonat mobil/të mençur dhe pajisjet tjera elektronike (p.sh. iPod-ët) duhet të fikën (apo të kurdisen në vibrim) dhe të mos ekspozohen gjatë orëve të mësimit. Studentët duhet të tregojnë respekt për ekipin dhe studentët tjerë në ligjërata dhe ushtrime laboratorike .

1970 MCMLXX

32. Fiziologjia Patologjike me Anatomi Patologjike

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti i Mjekësisë
Titulli i lëndës:	Fiziologjia Patologjike me Anatomi Patologjike
Niveli:	Bachelor (Paraklinikë)/Farmacia
Statusi lëndës:	Obligativ
Viti i studimeve:	III-të, Semestri V-të dhe i VI-të
Numri i orëve në javë:	2+0+2 (V) dhe 2+0+2 (VI)
Vlera në kredi – ECTS:	8 ECTS
Koha / lokacioni:	Përcaktohet nga orari i ligjëratave
Mësimdhënësi i lëndës:	Prof.ass. Burim Neziri Prof.dr. Ragip Shabani Prof.dr. Suzana Manxhuka Prof.ass. Argjira Juniku
Detajat kontaktuese:	Instituret/Instituti i Fiziologjisë Patologjike (IFP) Prof.ass. Burim Neziri - Shefi i Katedrës Instituret/Instituti i Anatomisë Patologjike (AP) Prof.dr. Ragip Shabani - Shefi i Katedrës
Përshkrimi i lëndës	
	<p>Plani mësimor i lëndës së Fiziologjisë Patologjike bazohet në konceptin e përmbajtjes së mësimin klinik të orientuar të Fakultetit të Mjekësisë. Kjo lëndë mund të konsiderohet si urë lidhëse në mes disiplinave mjekësore paraklinike dhe atyre klinike. Përmes mësimin të kësaj lënde studentët marrin bazat shkencore për kuptimin e mekanizmave të zanafillës së sëmundjeve të veçanta dhe shenjave të tyre, të cilat do të vërejnë më pas në lëndët klinike. Përmes studimit të Fiziologjisë Patologjike mund të njihen faktorët e veçantë etiologjik, posaçërisht vetitë e tyre të cilat mund të iniciojnë procesin patologjik. Me hulumtimin e Fiziologjisë Patologjike, fitohen njohuri mbi mekanizmat patogjenikë, të cilët janë të përbashkët për sëmundjet e shumta dhe njëherit zhvillohet kuptimi për çasje integrative të procesit patologjik të sëmurit e jo vetëm kah organet e veçanta të sëmurës.</p>
Qëllimet e lëndës:	Njohja e studentëve me çrregullimet e funksioneve fiziologjike të organizmit si pasojë e veprimin të shkaktarëve të ndryshëm patologjik.
Rezultatet e pritura të nxënies:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Të disponoj me njohuritë e nevojshme mbi faktorët etiologjik (kimikë, fizikë, biologjikë, psikosocial etj), përgjegjës për çrregullimin e funksioneve të shumta të organizmit.

	<p>2. T'i kuptoj mekanizmat, përmes të cilëve faktorët e ndryshëm etiologjik i çrregullojnë funksionet normale të organizmit.</p> <p>3. Ta bëj lidhshmërinë në mes të shkaktarëve (etiologjia) dhe mekanizmave patologjik (patogjeneza) të sëmundjes.</p> <p>4. Ta bëj krahasimin në mes të mekanizmave fiziologjik, të cilët mësohen më herët në lëndën e Fiziologjisë normale dhe mekanizmave fiziopatologjik, të cilët studenti i mëson gjatë ndjekjes së ligjëratave të Fiziologjia Patologjike.</p>
--	--

Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)

Semestri Dimëror - V

Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithësej
Ligjërata	2	15	30
Ushtrime teorike/laboratorike	2	15	30
Punë praktike	1	2	2
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	3	3
Ushtrime në teren	-	-	
Kollokfiume,seminare	2	2	4
Detyra të shtëpisë	-	-	
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	1	15	15
Përgaditja përfundimtare për provim	1	15	15
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final)	-	-	-
Projektet,prezentimet ,etj	1	1	1
Totali			100/4 ECTS
Semstri Veror - VI			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithësej
Ligjërata	2	15	30

Ushtrime teorike/laboratorike	2	15	30
Punë praktike	1	2	2
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	3	3
Ushtrime në teren	-	-	
Kollokfiume,seminare	2	2	4
Detyra të shtëpisë	-	-	
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	1	15	15
Përgaditja përfundimtare për provim	1	15	15
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final)	-	-	-
Projektet,prezentimet ,etj	1	1	1
Totali			100/4 ECTS
Metodologjia e mësimdhënies:	Organizimi i mësimit teorik dhe praktik (me metoda bashkëkohore ndërvepruese; punë seminarike në grupe të vogla).		
Metodat e vlerësimit:	Vlerësimi i parë: 10% Vlerësimi i dytë 10% Seminare ose angazhime tjera 5% Vijimi i rregullt 5% Provimi final 70% Gjithsej 100%		
Literatura			
Literatura bazë:	Teksti “ Fizpatologjia ” nga autorët: Stjepan Gamulin, Matko Marušiq dhe Sllavko Kërvarica. i përkthyer në		

	<p>gjuhën shqipe nga arsimtarët e lendës. Botimi 6-të i përtërirë – doli nga shtypi më 2011.</p> <p>Teksti Praktikum i Fiziologjisë Patologjike” nga autorët: Mazllum Belegu, Halil Ahmetaj, Ymer Mekaj, Hakif Hoxha, Neshet Rizvanolli, Shqipe Devaja-Kumnova, Burim Neziri. Prishtinë, 2002</p> <p>Anatomia Patologjike 1 (Prof. Dr. Lutfi Alia dhe Prof. Dr. Suzana Manxhuka Kërliu) 2009 – Pjesa e Përgjithshme</p>
Literatura shtesë:	<ol style="list-style-type: none"> 1. McCance LK me bp. Pathophysiology-the biological basis for disease in adults and children, ed. 6, St Louis, 2010, Mosby. 2. Stephen J. McPhee, Vishwanath R. Lingappa, and William F. Ganong McPhee Pathophysiology of Disease: An Introduction to Clinical Medicine, 4th Edition 3. OkDoKeY Handbook of Pathophysiology (January 15, 2001): by Springhouse Corporation 4. Lippincott Essentials of Pathophysiology: Concepts of Altered Health States, 2008 5. Marlene Hurst Pathophysiology Review; Mc Graw Hill 2008 6. Robbins Basic Pathology (Vinay Kumar, Abul K Abbas, Jon Aster), 2012

Plani i dizajnuar i mësimit:	
Java	Ligjerata që do të zhvillohet-Semestri Dimëror
Java e parë:	Ligjërata hyrëse-Syllabusi dhe planprogrami; Hyrje në Fiziologji Patologjike. Shëndeti, sëmundja dhe vdekja.
Java e dytë:	Bazat e Anatomisë Patologjike. Objektivat, metodat e studimit, teknikat histopatologjike dhe ekzaminiet mikroskopike (AP)
Java e tretë:	Faktorët etiologjik biologjikë
Java e katërt:	Komponimet endogjene biologjikisht aktive
Java e pestë:	Faktorët etiologjik kimikë

Java e gjashtë:	Paraqitja dhe zhvillimi i tumoreve. Dëmtimet reversibile dhe ireversibile, apoptoza dhe plakja e qelizës (AP)
Java e shtatë:	Faktorët etiologjik fizikë
Java e tetë:	Çrregullimet neuravegetative dhe ato të rritjes; Dhembja
Java e nëntë:	Temperatura si faktor etiologjik
Java e dhjetë:	Shtypja atmosferike si faktor etiologjik. Djegiet dhe mekanizmat patofiziologjik
Java e njëmbëdhjetë:	Çrregullimet e ndërtimit dhe funksionit të makromolekulave dhe strukturave subcelulare.
Java e dymbëdhjetë:	Inflamacioni-mekanizmat patofiziologjikë
Java e trembëdhjetë:	Mekanizmat imunologjikë në procesin patologjik
Java e katërbëdhjetë:	Çrregullimet e metabolizmit të lëndëve ushqyese dhe atyre energjetike
Java e pesëmbëdhjetë:	Temë e zgjedhur

Java	Ligjerata që do të zhvillohet-Semestri Veror
Java e parë:	Çrregullimet e frymëmarrjes
Java e dytë:	Çrregullimet e punës së zëmres
Java e tretë:	Çrregullimet e shtypjes dhe qarkullimit të gjakut
Java e katërt:	Çrregullimet e sistemit hepatobiliar
Java e pestë:	Çrregullimet e sistemit gastrointestinal
Java e gjashtë:	Çrregullimet e sistemit uropoetik
Java e shtatë:	Çrregullimet e ekuilibrit acido-bazik
Java e tetë:	Çrregullimet e ujit dhe elektroliteve
Java e nëntë:	Çrregullimet e hematopoezës. Anemitë.
Java e dhjetë:	Çrregullimet e hemostazës, proteinave plazmatike dhe të shpretkës
Java e njëmbëdhjetë:	Endokrinopatië
Java e dymbëdhjetë:	Çrregullimet e lëkurës dhe indit lidhor
Java e trembëdhjetë:	Leukemitë dhe limfomat (AP)
Java e katërbëdhjetë:	Çrregullimet e funksioneve motorike dhe sensorike të sistemit nervor

Java e pesëmbëdhjetë:	Çrregullimet e funksioneve të trurit
------------------------------	--------------------------------------

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:

Studentët janë të obliguar të mësimin teorik dhe praktik në përputhje me rregulloret e lëshuara nga Universiteti i Prishtinës dhe rregullorja për studime themelore e Fakultetit të Mjekësisë. Studentët duhet t'i përmbahen edhe rregullave tjera si më poshtë:

- T'i respektojnë të drejtat e personelit dhe të studentëve të tjerë.
- T'u kushtojnë vëmendje të duhur studimeve të tyre dhe të marrin pjesë në aktivitetet akademike;
- Të sillen mire si në lokalet e Universitetit, ashtu edhe jashtë tyre për të mos diskredituar Universitetin.
- Të respektojnë të gjitha rregullat e vendosura nga njësi akademike ku organizohet mësimi

33. FARMAKOLOGJI

Informatat themelore për lëndën	
Njësia akademike:	Fakulteti i Mjekësisë/Dega e Farmacisë
Titulli i lëndës:	Farmakologji
Niveli:	BA
Statusi i lëndës:	I obligueshëm
Viti i studimeve:	Viti i III-të Semestri V dhe VI
Numri i orëve në javë:	2+1+2
Kreditë ECTS:	10 ECTS
Koha / Vendi:	Dega Farmaci Sipas orarit
Mësimdhënësi:	Prof.Ass.Dr. Armond Daci Asistent: Ass.Dr.Sc. Valdet Uka
Të dhënat kontaktuese:	armond.daci@uni-pr.edu valdet.uka@uni-pr.edu

<p>Përshkrimi i lëndës:</p>	<p>-Kjo lëndë ofron njohuritë bazë mbi barnat dhe mekanizmin e veprimit të tyre. Përbëhet nga pjesët kryesore të saj si: Farmakologjia e përgjithshme ku studiohen principet farmakodinamike dhefarmakokinetike të barnave, efektet e pa dëshiruara. Farmakologjia e barnave që bashkëveprojnë në sistemit nervor autonom dhe qendror, kardiovaskular, respirator, gastrointestinal, urogjenital, hormonal, inflamator, në sëmundje autoimune, tumore, infektiv, hematopoetik, dermatologji.</p>
<p>Qëllimet e lëndës:</p>	<p>-Ofrimi i studentëve njohurive në aspektin teorik për principet e përgjithshme të farmakologjisë, njohuritë esenciale për grupet kryesore të barnave dhe bashkëveprimit të tyre duke bazuar në proceset farmakodinamike dhe farmakokinetike të tyre.</p> <p>-Ofrimi i njohurive mbi mekanizmin e veprimit të grupeve të ndryshme të barnave duke bazuar në klasifikimin dhe subklasifikimin sipas proceseve fiziologjike dhe patofiziologjike</p> <p>-Ofrimi i njohurive kryesore mbi indikacionet dhe kunderindikacionet e barnave duke bazuar nga mekanizmi i veprimit të tyre në patologji të ndryshme</p> <p>-Ofrimi i njohurive mbi efektet anësore të barnave dhe ndërveprimeve potenciale të barnave</p>


 1970 MCMLXX

Rezultatet e pritshme të nxënies:	<ul style="list-style-type: none"> - Për të njohur principet bazike të farmakologjisë së përgjithshme - Të njoh mekanizmin dhe relevancën klinike të tolerancës dhe abstinencës së barnave -Të njoh mekanizmin e barnave duke bazuar në proceset farmakodinamike si dhe proceset farmakokinetike -Të demonstrojnë njohuri mbi grupet kryesore të barnave të klasifikuar sipas klasës dhe nënklasës bazuar nga mekanizmi i veprimit të tyre -Të vlerësojnë në mënyrë kritike dhe të njoh indikacionet dhe kundëriindikacionet e barnave sipas klasifikimeve të tyre duke bazuar në efektet e tyre -Të identifikojnë efektet anësore dhe ndërveprimet potenciale të barnave me qëllim të parandalimit të tyre për ofrimin e barnave në mënyrë adekuate dhe me efikasitet maksimal të sigurtë
--	--

Obligimet e studentit (duhet të jetë në përputhje me Rezultatet e Nxënies të studentit)

Aktiviteti	Orë mësimore	Ditë/Javë	Gjithsej
Ligjëratat	2	30 Javë	60
Teori/Punë në laborator/Ushtime	2	30 Javë	60
Punë praktike			
Konsultime me mësimdhënësin	1	6 Javë	6
Puna në terren			
Testi, punimi seminarik	1	30	30
Detyrë shtëpie	1	6 Javë	6
Mësimi individual (në bibliotekë apo në shtëpi)			37
Përgatitja për provimin final	2	20 Javë	40
Koha e vlerësimit (testi, kuizi, provimi final)	5		5
Projektet, prezantimet, etj.	1	6 Javë	6

Total **250**

Metodat e mësimdhënies:	Ligjëratat, ushtrimet gjatë orëve të mësimit duke përdorë materiale të ndryshme, punë interaktive si seminarike, grupe të studentëve sipas mësimit të bazuar në problematika (PBL).
--------------------------------	---

Metodat e vlerësimit:	<p>Vlerësimi fillestar i studentit: 20 % Vlerësimi sekondar i studentit: 20 % Seminarët dhe kuizi: 10 % Pjesmarrja e studentëve 10 % Provimi final: 40 %</p>
------------------------------	--

Total: 100 %.

Literatura primare:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Ligjëratat të përgatitura nga Prof.ass.dr.Armond Daci 2. Goodman & Gilman's. <i>The Pharmacological Bases of Therapeutics</i> (Përkthim Shqip 2017). 3. Lippincott's <i>Illustrated Reviews. Pharmacology 7th Edition</i> 4. Range & Dale's <i>Pharmacology. 9th Edition</i>
Literatura shtesë:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Principles of Pharmacology: The Pathophysiologic Basis of Drug Therapy. David E Golan et al., 4th Edition 2. Basic and Clinical Pharmacology 12th Edition. Katzung et al. 3. Pharmacotherapy. Principles and Practice 5th Edition. Marie A. Chisholms – Burns et al. 4. Atlasi i Farmakologjisë. Heinz Luman et al. 2005

Hartimi i planit mësimor

SEMESTRI I PARË

Java	Titulli i ligjëratës
Java 1:	Farmakologji e Përgjithshme
Java 2:	Fati i Barit në Organizëm – Farmakokinetika (1)
Java 3:	Fati i Barit në Organizëm – Farmakokinetika (2)
Java 4:	Targetet e veprimit të barnave - Farmakodinamika (1)
Java 5:	Targetet e veprimit të barnave- Farmakodinamika (2)
Java 6:	Ndërveprimet e barnave
Java 7:	Faktorët që ndikojnë në veprimet farmakologjike të barnave
Java 8:	Vlerësimi i parë i ndërmjetëm
Java 9:	Farmakologjia e Sistemit Nervor Autonom (1)
Java 10:	Farmakologjia e Sistemit Nervor Autonom (2)
Java 11:	Autokoidet
Java 12:	Farmakologjia e Sistemit Kardiovaskukare (1)
Java 13:	Farmakologjia e Sistemit Kardiovaskukare (2)
Java 14:	Farmakologjia e Sistemit Kardiovaskukare (3)
Java 15:	Vlerësimi sekondar i ndërmjetëm

Hartimi i planit mësimor

SEMESTRI I DYTË

Java	Titulli i ligjëratës
Java 1:	Farmakologjia e Sistemit Nervor Qendor (SNQ) (1)
Java 2:	Farmakologjia e Sistemit Nervor Qendor (SNQ) (2)
Java 3:	Farmakologjia e Sistemit Nervor Qendor (SNQ) (3)
Java 4:	Farmakologjia e Sistemit Respirator
Java 5:	Farmakologjia e Traktit Gastrointestinal
Java 6:	Farmakologjia e Sistemit Urogjenital
Java 7:	Farmakologjia e Barnave Anti-inflamatore
Java 8:	Vlerësimi i parë i ndërmjetëm
Java 9:	Farmakologjia e Barnave Kemoterapeutike
Java 10:	Imunofarmakologjia
Java 11:	Farmakologjia e Sistemit Endokrin
Java 12:	Barnat Antimikrobiale (1)
Java 13:	Barnat Antimikrobiale (2)
Java 14:	Farmakologjia e organeve Hematopoetike



Politikat akademike dhe Kodi i Sjelljes

Ora mësimore fillon dhe përfundon me kohë. Mjetet që përdorën gjatë orëve të mësimi duhet të pastrohen dhe të ruhen në fund të orës mësimore. Telefonat mobil/të mençur dhe pajisjet tjera elektronike (p.sh. iPod-ët) duhet të fikën (apo të kurdisen në vibrim) dhe të mos ekspozohen gjatë orëve të mësimi. Laptopët dhe kompjuterët/tabletë lejohen të përdorën vetëm në heshtje; aktivitetet tjera siç janë kontrollimi i e-mailit personal apo shfletimi i ueb-faqeve në internet janë të ndaluara. Prishja e sjelljes penalizohet nga komisioni diciplinar i përcaktuar sipas rregullores në fuqi të përcaktuar nga senati dhe parlamenti i studentëve. Në lidhje me vendimet e marrura studentët kanë të drejtën e ankimit për gjatë 15 ditëve. Komisioni i studimeve është obliguar të raportoj vendimin të njësisë akademike për gjatë 30 ditëve të punës pas marrjes së ankesës. Kurse senati vendos në lidhje me ankesën duke bazuar në vendimin në instancën e parë.

Shënim | Nëse 3 detyra të klasës të një studenti vlerësohen nën 50%, atëherë ai/ajo do ta humb të drejtën që t'i nënshtrohet provimit final. Vlerësimi bëhet nga 0-100 %.

34. BIOKIMI E BARNAVE

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Farmacii
Titulli i lëndës:	BIOKIMI E BARNAVE
Niveli:	Diplom.
Statusi lëndës:	Obligative
Viti i studimeve:	III, semestri V
Numri i orëve në javë:	1+1+0
Vlera në kredi – ECTS:	3
Koha / lokacioni:	Sipas orarit, FM
Mësimdhënësi i lëndës:	Prof.Asoc. Dr. Dashnor Nebija, Mag.pharm.
Detajet kontaktuese:	dashnor.nebija@uni-pr.edu + 37745401585
Përshkrimi i lëndës	Në këtë kurs do të ofrohet një prezantim konceptual dhe faktik i biotransformimit të barnave dhe ksenobiotikëve tjerë duke u fokusuar në njohuritë nga Biokimia, me theks të veçantë në enzimën metabolizuese të ksenobiotikëve, reaksionet dhe rregullimin e tyre. Gjithashtu do të diskutohen edhe teknikat bashkëkohore të studimit të proceseve metabolike si dhe rëndësia e biotransformimit të barnave në dizajnin dhe zhvillimin e barnave të sigurta dhe efikase.
Qëllimet e lëndës:	Qëllimi kryesor i kësaj lende është të mundësoj arritjen e njohurive dhe të kuptuarit <ul style="list-style-type: none"> – të relacionit ndërmjet strukturës së barnave dhe proceseve biotransformuese si dhe enzimave specifike të cilat janë të involvuara në biotransformimin e tyre – pasojave farmakokinetike, farmakologjike dhe toksikologjike të metabolizimit të barnave dhe ksenobiotikëve

	<p>– aplikimit të njohurive dhe shkathtësive profesionale të fituara në shpjegimin e mekanizmit të veprimit, efekteve anësore dhe ndërveprimeve të barnave.</p>		
Rezultatet e pritura të nxënies:	<p>Pas përfundimit të suksesshëm të kësaj lënde studentet do të sigurojnë njohuritë e mjaftueshme mbi: ndryshimet kimike të cilat shoqërohen me biotransformimin e barnave dhe ksenobiotikëve, klasat kryesore të enzimave të cilat janë të përfshira në biotransformimin e barnave si dhe farmakogjenetiken e tyre, implikimet klinike të biotransformimit të barnave përfshirë detoksikimin, aktivizimin metabolik si dhe ndërveprimet e barnave të cilat lidhën me biotransformimin e barnave, inhibimin dhe induksionin enzimatik, implikimet e biotransformimit të barnave në dizajnin dhe zhvillimin e produkteve medicinale të sigurta dhe efikase.</p>		
Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënës të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithsej
Ligjërata	1	15	15
Ushtrime teorike/laboratorike			
Punë praktike			
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	2	4	8
Ushtrime në teren			
Kollokfiume,seminare	1	15	15
Detyra të shtëpisë			
Koha e studimit vetanë të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	1		20
Përgaditja përfundimtare për provim			15
Koha e kaluar në vlerësim (teste, kuiz,provim final)	2		2
Projektet, prezantimet ,etj			
Totali			75
Metodologjia e mësimdhënies:	<p>Aktivitetet teorike dhe të mbikëqyrura: ligjërata, aktivitetet praktike të tutoruara: praktikat laboratorike,</p>		

	seminaret, vëmendje personale (individuale), mësim i tutoruar, aktivitetet praktike te pavarura, zgjidhja e problemeve
Metodat e vlerësimit:	Vlerësimi i vazhdueshëm: pjesëmarrja ne seminare dhe mësim te mbikëqyrur kolektiv apo individual, realizimi i se paku tre testeve kontrolluese Praktikat laboratorike Provimi me gojë
Literatura	
Literatura bazë:	1. Bernard Testa and Stefanie Kraemer. The Biochemistry of Drug Metabolism: Principles, Redox Reactions, Hydrolyses. Wiley-VCH; 1 edition (2010)ISBN-10: 3906390551
Literatura shtesë:	1. Dashnor Nebija. Biokimia e barnave, kapituj te zgjedhur. Permbledhje Leksionesh. Prishtine 2015. 2. Richard B. Silverman. The Organic Chemistry of Drug Design and Drug Action. Third Edition. Academic Press, 2014.ISBN 978-0-12-382030-3.
Plani i dizajnuar i mësim:	
Java	Ligjërata që do të zhvillohet
Java e parë:	Biotransformimi i barnave, koncepti dhe karakteristikat e përgjithshme. Ksenobiotikët në kontekstin e gjerë të metabolizmit fiziologjik,
Java e dytë:	Vështrim mbi proceset e dispozicionit dhe metabolizmit të barnave, përmbledhja e pozicioneve mikro dhe makroskopike të metabolizmit ne kafshë dhe njerëz
Java e tretë:	Pasojat farmakokinetike, farmakologjike dhe toksikologjike të metabolizmit të barnave dhe ksenobiotikëve, metabolizmi i barnave në kontekstin e hulumtimeve farmaceutike (<i>drug research</i>), me fokus në Kiminë terapeutike
Java e katërt:	Roli i oksidoreduktazave si agjente kryesore të metabolizmit të barnave dhe ksenobiotikeve (Citokromet P450, shumëllojshmeria, struktura, mekanizmat katalitike dhe reaksionet që katalizojnë ato)
Java e pestë:	Oksidoreduktazat tjera, si p.sh. flavinmonooksigjenazat, MAO-t, aldehid oksidaza
Java e gjashtë:	Klasifikimi, tiparet dhe mekanizmi katalitik i hidrolazave, prezantimi sistematik i klasave të ndryshme të substratëve, p.sh.

	esteret karbonike, amidet, peptidet, laktamet, laktonet, esteret e acideve inorganike, alkenet, aren epoksidet
Java e shtatë:	Transferazat dhe reaksionet e konjugimit (metilimi, sulfatimi, glukuronimi, acetilimi, konjugimi me glutation, konjugatet ksenobiotik-koenzimë A si udhëkryq i reksioneve të ndryshme metabolike.
Java e tetë:	Konsekuencat e metabolizmit të barnave dhe ksenobiotikeve nga perspektiva farmakologjike dhe toksikologjike (prodrugs dhe toksifikimi i ksenobiotikeve
Java e nëntë:	Faktoret interindividual dhe intraindividual të cilët influencojnë metabolizmin e barnave, diferenca e specieve të ndryshme në metabolizimin e barnave dhe polimorfizmi në kuadër të një species të caktuar, enzimet polimorfike më relevante, dallimet etnike, dallimet farmakokinetike, reaksionet metabolike të varura nga seksi
Java e dhjetë:	Mekanizmat të cilët sjellin deri të rritja ose zvogëlimi i aktivitetit enzimatik, si p.sh koncepti i induksionit enzimatik përmes receptorëve nukleare, mekanizmat e ndryshëm të inhibimit enzimatik.
Java e njëmbëdhjetë:	Faktoret që ndikojnë në rritjen ose zvogëlimin e aktivitetit enzimatik, duke përfshirë konditat patologjike dhe fiziologjike, si dhe barnat tjera, nutrientet, agjentet e mjedisit, me theks të veçantë në ndërveprimet bar/bar.
Java e dymbëdhjetë:	Manifestimet klinike të inhibimit të metabolizmit të barnave
Java e trembëdhjetë:	Promedikamentet (Prodrugs) dhe Drug Delivery sistemet. Aktivizimi enzimatik i barnave
Java e katërbëdhjetë:	Promedikamentet e lidhura me grupet transportuese (<i>carrier-linked prodrugs</i> dhe bioprekursorët
Java e pesëmbëdhjetë:	Terapitë Enzimë-Promedikament (<i>Enzyme-Prodrug Therapies</i>), EPT; Enzimë prodrug-terapia e drejtuar nga antittrupat. Antibody Directed Enzyme Prodrug Therapy (<i>ADEPT</i>); Abzimë prodrug-terapia e drejtuar nga antittrupat. Antibody Directed Abzyme Prodrug Therapy (<i>ADAPT</i>)

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:

Vijimi i rregullt i ligjëratave, ushtrimeve dhe te gjitha obligimeve te parapara me programin studimor; respektimi i konsideratave etike, barazisë gjinore.

35. FARMACIA E BAZUAR NË EVIDENCË

Informatat themelore për lëndën			
Njësia akademike:	Fakulteti i Mjekësisë, Dega Farmaci		
Titulli i lëndës:	Farmacia e Bazuar ne Evidence		
Niveli:	MPharm		
Statusi i lëndës:	zgjedhore		
Viti i studimeve:	Viti i III-të Semestri i V-të		
Numri i orëve në javë:	1+1+0		
Kreditë ECTS:	3 ECTS		
Koha / Vendi:	Salla F1, sipas orarit		
Mësimdhënësi:	Prof Asoc Dr Kreshnik Hoti		
Të dhënat kontaktuese:	Kreshnik.hoti@uni-pr.edu , 044045173		
Përshkrimi i lëndës:	<p>Kjo lëndë shtjellon konceptin e mjekësisë së bazuar në evidencë në kontekstin farmaceutik. Në këtë aspekt mirren parasysh preferencat e pacientit dhe aftësitë profesionale të farmacistit gjatë marrjes së vendimeve për pacientin. Këtu përfshihen hulumtimi i informatave shëndetësore, hulumtimi dhe vlerësimi i evidencës shëndetësore dhe aplikimi i kësaj evidence në aspektin vendimmarrës tek pacienti në raport me barnat.</p>		
Qëllimet e lëndës:	<p>Qëllimi i kësaj lënde është të njoftojë studentat me metodat e vlerësimit të evidencës, literaturës mjekësore/farmaceutike dhe shërbimeve farmaceutike.</p>		
Rezultatet e pritshme të nxënies:	<p>Me përfundimin e kësaj lënde, studentët duhet të jenë në gjendje të:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Kuptojnë konceptin e mjekësisë së bazuar në evidencë • Kuptojnë përkujdesin e orientuar tek pacienti • Zhvillojnë aftësitë e nevojshme për gjetjen dhe vlerësimin e evidencës klinike • Aplikojnë evidencën klinike gjatë vendimmarrjes me qëllim të optimizimit të terapisë së pacientit 		
Obligimet e studentit (duhet të jetë në përputhje me Rezultatet e Nxënies të studentit)			
Aktiviteti	Orë mësimore	Ditë/Javë	Gjithsej
Ligjëratat	1	1/15	15
Seminar	1	1/15	15
Kolloqium/	1	1/5	3

Konsultime me mësuesin	0.5	1/15	4
Detyrë shtëpie	2	5	5
Mësimi individual (në bibliotekë apo në shtëpi)	1	1/14	10
Përgatitja për provimin final	3	2	3
Koha e vlerësimit (testi, kuizi, provimi final)	1	5	5
Total			75

Metodat e mësimit: Mësimi do të mbahet në formën e ligjeratave interaktive, prezentimeve dhe diskutimeve në klase të seminareve, mësimi i vetëdrejtuar.

Metodat e vlerësimit: Studentët do të vlerësohen vazhdimisht. Vlerësimet specifike do të bëhen nëpërmjet 2 komponenteve: 1) punës seminarike (20%) dhe 3) provimit përfundimtar (80%). Nota përfundimtare e studentit do të llogaritet në bazë të mesatares nga tre komponentet e sipërsënuara.

Literatura primare:

1. Ligjeratat të përgatitura nga mësuesi
2. Sharon Straus. Evidence based medicine 5th Edition. 2018. Elsevier
3. The Centre for Evidence Based Medicine. <https://www.cebm.net/>

Literatura shtesë:

1. Guyatt G, et al. *Users' Guide to the Medical Literature: A Manual for Evidence-based Clinical Practice*. 2nd Edition. McGraw-Hill Professional Publishing; New York, NY. 2015.

Hartimi i planit mësimor

Java	Titulli i ligjeratës
Java 1:	Hyrje në evidencën mjekësore
Java 2:	Kërkimi i evidencës rreth barnave
Java 3:	Gjeneralizimi dhe interpretimi i evidencës
Java 4:	Përmbledhja e evidencës: Rishikimet sistematike dhe meta-analizat
Java 5:	Përmbledhja e evidencës: studimet tjera
Java 6:	Aplikimi i evidencës: Diagnostifikimi, Skriningu dhe Prognozimi
Java 7:	Aplikimi i evidencës mjekësore në farmaci: pacienti
Java 8:	Aplikimi i evidencës mjekësore në farmaci: shërbimet farmaceutike
Java 9:	Rishikimi i sigurisë së barnave duke aplikuar evidencën 1
Java 10:	Rishikimi i sigurisë së barnave duke aplikuar evidencën 2
Java 11:	Temat bashkëkohore farmaceutike nga aspekti i evidencës
Java 12:	Prezentime dhe diskutime të seminareve 1
Java 13:	Prezentime dhe diskutime të seminareve 2
Java 14:	Prezentime dhe diskutime të seminareve 3
Java 15:	Përmbledhje e lëndës

Politikat akademike dhe Kodi i Sjelljes

Ora mësimore fillon dhe përfundon me kohë.

Mjetet që përdorën gjatë orëve të mësimit duhet të pastrohen dhe të ruhen në fund të orës mësimore. Telefonat mobil/të mençur dhe pajisjet tjera elektronike (p.sh. iPod-ët) duhet të fikën (apo të kurdisen në vibrim) dhe të mos ekspozohen gjatë orëve të mësimit.

Laptopët dhe kompjuterët tabletë lejohen të përdorën vetëm në heshtje; aktivitetet tjera siç janë kontrollimi i e-mailit personal apo shfletimi i ueb-faqeve në internet janë të ndaluara.

Plagjjarizmi

Plagjjarizmi do të monitorohet me rreptësi në këtë lëndë. Plagjiati ndodh kur puna ose prona e një studenti apo individit tjetër paraqitet si punë vetanake pa referim adekuat. Prandaj, punimet që dorëzohen në këtë lëndë do t'i nënshtrohen detektimit për plagjjarism.

36. FARMAKOLOGJI EKSPERIMENTALE

Informatat themelore për lëndën

Njësia akademike:	Fakulteti i Mjekësisë/Dega e Farmacisë
Titulli i lëndës:	Farmakologji Eksperimentale
Niveli:	BA
Statusi i lëndës:	Zgjedhore
Viti i studimeve:	Viti i III-të Semestri V-të
Numri i orëve në javë:	1+1+0
Kreditë ECTS:	3 ECTS
Koha / Vendi:	Dega Farmaci Sipas orarit
Mësimdhënësi:	Prof.Ass.Dr. Armond Daci
Të dhënat kontaktuese:	armond.daci@uni-pr.edu
Përshkrimi i lëndës:	-Lënda është dizajnuar të ofrojë njohuri në vlerësimet paraklinike të barnave dhe teknikat e fundit eksperimentale që përdoren gjatë zbulimit dhe zhvillimit të barnave. Përmbajtja e lëndës ndihmon studentëve të kuptojnë mirëmbajtjen e kafshëve laboratorike sipas udhërrëfyesve respektiv, njohuri bazike të proceseve vlerësuese paraklinike të barnave në modele in-vitro dhe in vivo.

<p>Qëllimet e lëndës:</p>	<ul style="list-style-type: none"> -Të vlerësojë rregullat dhe kërkesat etike për përdorimin e kafshëve eksperimentale. -Të përshkruaj përdorimin e kafshëve të ndryshme laboratorike që përdoren në zbulimin e barnave dhe proceseve të ndërlidhura, praktikën e mirë laboratorike të tyre gjatë mirëmbajtjes dhe kujdesit të kafshëve laboratorike. -Përshkruaj metodat e reja shqyrtuese që përfshihen në procesin e zhvillimit të barnave -Të vlerësoj dhe të korreloj nga të dhënat paraklinike me humane klinike.
<p>Rezultatet e pritshme të nxënies:</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Të vlerësoj aplikimin e kafshëve të ndryshme laboratorike -Të vlerësoj aplikimet e procedurave të anestezionit të kafshët kryesore laboratorike. -Të vlerësojë dhe të demonstroj eksperimente me preparate të krijuara nga izolimi organeve me sistemin e banjës organeve indore si dhe imazheri intravitale. -Të vlerësoj dhe të demonstroj induktimin e modeleve të ndryshme eksperimentale në sëmundje të ndryshme. -Të vlerësoj dhe demonstroj metoda të ndryshme shqyrtuese që përdoren në kërkimin para klinik. -Të dizajnoj dhe të ekzekutoj hipoteza kërkimore në mënyrë të pavarur.



Obligimet e studentit (duhet të jetë në përputhje me Rezultatet e Nxënies të studentit)			
Aktiviteti	Orë mësimore	Ditë/Javë	Gjithsej
Ligjëratat	1	15 Javë	15
Teori/Punë në laborator/Ushtime			
Punë praktike			
Konsultime me mësimdhënësin			6
Puna në terren			
Testi, punimi seminarik	1	15	15
Detyrë shtëpie	1	3 Javë	3
Mësimi individual (në bibliotekë apo në shtëpi)	1	10 Javë	10
Përgatitja për provimin final			20
Koha e vlerësimit (testi, kuizi, provimi final)	2	2 ditë	4
Projektet, prezantimet, etj.	1	2 Javë	2
Total			75
Metodat e mësimdhënies:	Ligjëratat, ushtrimet gjatë orëve të mësimit dukepërdorë materiale të ndryshme, punë interaktive si seminarike, grupe të studentëve sipas (PBL).		
Metodat e vlerësimit:	Vlerësimi fillestar i studentit: 20 % Vlerësimi sekondar i studentit: 20 % Seminarët dhe kuizi: 10 % Pjesmarrja e studentëve 10 % Provimi final: 40 % Total: 100 %.		
Literatura primare:	1. <i>Lectures Material from Prof.ass.dr.Armond Daci</i> 2. <i>Henningfield, J. E., London, E. D., & Pogun, S. (2009). Handbook of Experimental Pharmacology: Preface. Handbook of Experimental Pharmacology, 192</i> 3. <i>Drug Discovery and Evaluation: Pharmacological Assays by Vogel & Vogel</i> 4. <i>Joshi A et al., Principles of Experimental Pharmacology 2017. Edition: FirstPublisher</i>		
Literatura shtesë:	1.R.K. Tiwari. <i>Understanding Experimental Pharmacology</i> Paperback – March 30, 2019 2.Dhadde Sh et al., <i>Handbook of Experimental Pharmacology</i> .2019. Edition: FirstPublisher. 3.S.K. Gupta <i>Drug Screening Methods</i> Paperback – 1 January 2016		
Hartimi i planit mësimor	SEMESTRI I PARË		
Java	Titulli i ligjëratës		
Java 1:	Hyrje në farmakologji eksperimentale		
Java 2:	Instrumentet kryesore që përdoren në farmakologjiekperimentale		

Java 3:	Kafshët eksperimentale kryespre që përdoren në farmakologji eksperimentale dhe udhërrëfyesit CPCSEA për mirëmbajtjen e laboratorit të kafshëve eksperimentale
----------------	---



Java 4:	Teknikat për anestezionin dhe eutanazia në farmakologji eksperimentale
Java 5:	Eksperimente në Preparatet e Izoluara Indore (Ex-Vivo)
Java 6:	Imazheria intraviteale e mikroqarkullimit
Java 7:	Vlerësimi i parë intermediar
Java 8:	Skriningu para klinik i substancave të reja për aktivitetin farmakologjik: Aktiviteti anti-inflamator i barnave duke përdorur modelin e indukuar me LPS dhe eksperimente kardiovaskulare në zemrat e izoluara të perfuzionuara përmes aparatit të langendorfit.
Java 9:	Skriningu para klinik i substancave të reja për aktivitetin farmakologjik të barnave: Aktivitetin anti-ulcer dhe anti-diabetik i barnave duke përdorur ulcer gastrike induktuar me BAIJS, kolit ulceroz me TNBST dhe model me STZ.
Java 10:	Skriningu para klinik i substancave të reja për aktivitetin farmakologjik të barnave në memorie dhe epilepsi duke përdorur sistemin e ngritur plus – aparati maze dhe MES, PTZ modeli
Java 11:	Skriningu paraklinik i substancave të reja për aktivitetin farmakologjik të barnave në sistemin respirator duke përdorur pletizmografinë t rupore nën presione të ndryshme të oksigjenit në modele eksperimentale respiratore.
Java 12:	Skriningu paraklinik i substancave të reja për vlerësimin e dëmtimit të ADN me Komet Assay
Java 13:	Skriningu paraklinik i substancave të reja për vlerësimin e eksperimenteve në kultura qelizore dhe indore dhe principet gjenerale të immunoassay, protein dhe DNA gjel elektroforez: western, northern, southern blot hibridizim dhe teknika të PCR.
Java 14:	Modelet për vlerësimin e Farmakokinetikës së Barnave
Java 15:	Vlerësimi sekondar i ndërmjetëm

Politikat akademike dhe Kodi i Sjelljes

Ora mësimore fillon dhe përfundon me kohë.

Mjetet që përdoren gjatë orëve të mësimit duhet të pastrohen dhe të ruhen në fund të orës mësimore. Telefonat mobil/të mençur dhe pajisjet tjera elektronike (p.sh. iPod-ët) duhet të fikën (apo të kurdisen në vibrim) dhe të mos ekspozohen gjatë orëve të mësimit.

Laptopët dhe kompjuterët tabletë lejohen të përdoren vetëm në heshtje; aktivitetet tjera siç janë kontrollimi i e-mailit personal apo shfletimi i ueb-faqeve në internet janë të ndaluara.

Prishja e sjelljes penalizohet nga komisioni diciplinor i përcaktuar sipas rregullores në fuqi të përcaktuar nga senati dhe parlamenti i studentëve. Në lidhje me vendimet e marrura studentët kanë të drejtën e ankimit për gjatë 15 ditëve. Komisioni i studimeve është obliguar të raportoj vendimin te njësia akademike përgjatë 30 ditëve të punës pas marrjes së ankesës. Kurse senati vendos në lidhje me ankesën duke bazuar në vendimin në instancën e parë.

Shënim | Nëse 3 detyra të klasës të një studenti vlerësohen nën 50%, atëherë ai/ajo do ta humb të drejtën që t'i nënshtrohet provimit final. Vlerësimi bëhet nga 0-100 %

37. Sigurimi i cilesise se barnave

Informatat themelore për lëndën			
Njësia akademike:	Fakulteti i Mjekesise – Departamenti Farmacise		
Titulli i lëndës:	Sigurimi i cilesise se barnave		
Niveli:	Studime themelore		
Statusi i lëndës:	Zgjedhore		
Viti i studimeve:	Viti i III -rë Semestri i V-rë		
Numri i orëve në javë:	1+1+0		
Kreditë ECTS:	3 ECTS		
Koha / Vendi:	Klasa F1 Sipas orarit		
Mësimdhënësi:	Prof.ass.dr Adnan Bozalija		
Të dhënat kontaktuese:	adnanbozalija@uni-pr.edu		
Përshkrimi i lëndës:	Njoftim i studentët me rregulloret në fushën farmaceutike dhe produkteve mjekësore, procedurat e regjistrimit të barnave (Kosove, BE), dhe harmonizimi i dokumenteve mbështetëse në nivel ndërkombëtar		
Qëllimet e lëndës:	Lënda “Sigurimi i cilesise se barnave” për studentët e farmacisë ka synim procesin e prezantimit, zhvillimin dhe përmirësimin e cilësisë në fushën e prodhimit dhe regjistrimit të barnave.		
Rezultatet e pritshme të nxënies:	Sigurimi i cilësisë është një koncept i gjerë, i cili mbulon të gjitha çështjet, të cilat individualisht ose kolektivisht ndikojnë në cilësinë e një produkti. Kjo është shuma e përgjithshme e marrëveshjeve të organizuara të bëra me qëllim të sigurimit që produktet medicinale janë të cilësisë së kërkuar për përdorimin e tyre të synuar.		
Obligimet e studentit (duhet të jetë në përputhje me Rezultatet e Nxënies të studentit)			
Aktiviteti	Orë mësimore	Ditë/Javë	Gjithsej
Ligjëratat	1	15	15
Seminare	1	15	15
Teori/Punë në laborator/Ushtime			
Punë praktike			
Konsultime me mësimdhënësin	0.5	8/15	4
Puna në terren			
Kollokvium/ punimi seminarik	1	1/5	5
Detyrë shtëpie	2	4	8
Mësimi individual (në bibliotekë apo në shtëpi)	1	1/15	15
Përgatitja për provimin final	3	3	9
Koha e vlerësimit (testi, kuizi, provimi final)	2	2	4
Total			75

Metodat e mësimdhënies:	Ligjerata (metoda interaktive dhe monologe) , punim seminarik.
Metodat e vlerësimit:	Aktiviteti ne ligjerata 5, Seminaret 20,Provimi perfundimtar 75.

Literatura primare:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Quality assurance of pharmaceuticals, Volume 2, 2nd updated edition, Good manufacturing practices and inspection, World Health Organization, Geneva, 2007. 2. Pharmacopea Europiane (Eu Ph) , 2008., vol. 6.
Literatura shtesë:	<ol style="list-style-type: none"> 3. Organisation of the Common Technical Document for the Registration of Pharmaceuticals for Human Use; M4, ICH,2004.

Hartimi i planit mësimor	
Java	Titulli i ligjëratisë
<i>Java 1:</i>	Përbërsit e cilësisë
<i>Java 2:</i>	Menaxhimi i cilësisë
<i>Java 3:</i>	Çmimi optimal i cilesise
<i>Java 4:</i>	Elementet e sistemit të cilësisë
<i>Java 5:</i>	Sigurimi i cilesise ne laboratorin analitik
<i>Java 6:</i>	Parimi i sigurimit të cilësisë së të dhënave te matjeve
<i>Java 7:</i>	Sistemi i sigurimit te cilesise ne procesin e prodhimit
<i>Java 8:</i>	Kontrolli i cilësisë
<i>Java 9:</i>	Praktika e mire laboratorike PML
<i>Java 10:</i>	Udhezimi administrativ per garantimin e sigurise se barit ne Kosove
<i>Java 11:</i>	Validimi
<i>Java 12:</i>	Dokumentacioni
<i>Java 13:</i>	Validimi i metodologjise
<i>Java 14:</i>	Vleresimi i cilesise
<i>Java 15:</i>	Materiali referent

Politikat akademike dhe Kodi i Sjelljes
Mësimdhënësi dhe asistentët njoftojnë studentët për kriteret e vijueshmërisë së rregullt në ligjerata dhe ushtrime teorike dhe praktike. Ata caktojnë rregullat e mirësjelljes, mbajtje të qetësisë në ligjerata dhe ushtrime, ç'kyqjen e celularëve, ardhjen me kohë në ligjeratë/ushtrim, etj.

Mësimdhënësi duhet të tregojë sjellje intelektuale, pragmatike dhe kolegjiale. Ai duhet të jetë i gatshëm t'i përgëzojë studentët për suksesin e tyre.

Studentët janë të obliguar të mësimin teorik dhe praktik në përputhje me rregulloret e lëshuara nga Universiteti i Prishtinës dhe rregullorja për studime themelore e Fakultetit të Mjekësisë.

38. TEKNOLOGJIA FARMACEUTIKE 1

Informatat themelore për lëndën	
Njësia akademike:	Fakulteti i Mjekësisë, Dega Farmaci
Titulli i lëndës:	Teknologjia Farmaceutike 1
Niveli:	Studime bazike te integruara
Statusi i lëndës:	Obligative
Viti i studimeve:	Viti i IV-rë Semestri i II-të
Numri i orëve në javë:	2+1+3
Kreditë ECTS:	6 ECTS
Koha / Vendi:	Klasa F1 Sipas orarit
Mësimdhënësi:	Arlinda Daka Grapci
Të dhënat kontaktuese:	Arlinda.daka@uni-pr.edu 044199193
Përshkrimi i lëndës:	Lënda Teknologji farmaceutike do t'u ofroj studentëve njohuritë mbi zhvillimin e barnave, formave farmaceutike dhe kushteve për prodhim.; bazat teorike të formave farmaceutike të barnave, vetitë e tyre, parimet dhe teknologjitë e prodhimit, kontrollin e cilësisë; poashtu edhe substancat ndihmëse, për të vlerësuar ndikimin e tyre në veprimin dhe qëndrueshmërinë e barit dhe në vetitë e formave farmaceutike të barnave.
Qëllimet e lëndës:	Qëllimi i kursit është njohja e studentëve me format farmaceutike dhe procedurat teknologjike që mundësojnë prodhimin e tyre, duke marrë parasysh vetitë fiziko-kimike të përbërësve aktivë dhe lëndëve ndihmëse. Vlerësimi dhe zbatimi në mënyrë kritike i njohurive shkencore dhe të dhënave të disponueshme për zhvillimin e formave moderne të barnave dhe përmirësimi i teknologjive ekzistuese dhe të reja për prodhimin e tyre.
Rezultatet e pritshme të nxënies:	Pas përfundimit të këtij kursi (lënde) studentët duhet të jenë në gjendje të: Të përcaktojnë dhe identifikojnë format farmaceutike të barnave dhe të njohin epërsitë dhe të metat e përdorimit të tyre. Të klasifikojnë ekscipientët bazë dhe sekondarë, përshkruajnë përdorimin e tyre në prodhimin e formave farmaceutike të barnave dhe të vlerësojnë ndikimin e tyre në stabilitetin dhe efikasitetin e barit. Të njohin procedurat teknologjike për zhvillimin e grupeve individuale të formave farmaceutike, epërsitë dhe të metat e tyre, si dhe ndikimin e tyre në stabilitetin dhe efikasitetin e barit. Të zgjedhin procedurën e duhur të

	formulimit të barnave në varësi të vetive fiziko-kimike të barit dhe substancave ndihmëse, mënyrës së administrimit të tij dhe grupit të synuar të pacientëve. Procedurat për kontrollin e cilësisë së formave të farmaceutike. Të identifikojnë papajtueshmëritë e rëndësishme teknologjike të barit dhe / ose substancave ndihmësve dhe / ose paketimit.		
Obligimet e studentit (duhet të jetë në përputhje me Rezultatet e Nxënies të studentit)			
Aktiviteti	Orë mësimore	Ditë/Javë	Gjithsej
Ligjëratat	2	15	30
Teori/Punë në laborator/Ushtrime	3	15	45
Punë praktike			
Konsultime me mësimdhënësin	1	4	4
Puna në terren			
Testi, punimi seminarik	1	15	15
Detyrë shtëpie			
Mësimi individual (në bibliotekë apo në shtëpi)	2	15	30
Përgatitja për provimin final	2	10	20
Koha e vlerësimit (testi, kuizi, provimi final)	3	2	6
Projektet, prezantimet, etj.			
Total			150
Metodat e mësimdhënies:	Mësimi është i rregullt dhe organizohet në formë të ligjëratave dhe seminareve në grupe më të mëdha duke shfrytëzuar metodat moderne të mësimdhënies si diskutimin interaktiv, ndërsa praktika laboratorike (ushtrimet) organizohen me grupe të vogla të studentëve.		
Metodat e vlerësimit:	Pjesëmarrja dhe angazhimi në ligjerata dhe ushtrime 10% Pjesëmarrja dhe angazhimi në seminare 30% <u>Provimi final</u> 60% <u>Gjithsej</u> 100%		
Literatura primare:	Teknologjia Farmaceutike, Prof. Dr. Skënder Durrësi. Tiranë 2008 M.E. Aulton: Pharmaceutics: The science of dosage form design, 2nd Edition, Churchill Livingstone, Edinburgh 2002. Florence AT, Attwood D. Physicochemical principles of pharmacy: In manufacture, formulation and clinical use. Pharmaceutical press; 2015.		
Literatura shtesë:	Përgatitjet galenike dhe kozmetike në laborator, Prof. Dr. Skënder Durrësi. Tiranë 2005 Gibson, Mark, ed. Pharmaceutical preformulation and formulation: a practical guide from candidate drug selection to commercial dosage form. CRC Press, 2016.		

Hartimi i planit mësimor	
Java	Titulli i ligjëratorës
<i>Java e parë:</i>	Barnat, format farmaceutike/ Biodisponibiliteti dhe barasvlershmëria biologjike
<i>Java e dytë:</i>	Paraformulimi i barnave
<i>Java e tretë:</i>	Tretësirat
<i>Java e katërt:</i>	Tretësirat ujore, alkoolike dhe vajore/Ujërat aromatike
<i>Java e pestë:</i>	Shurupet
<i>Java e gjashtë:</i>	Përgatesat parenterale, njohuri të përgjithshme
<i>Java e shtatë:</i>	Përgatitja e përgatesave parenterale
<i>Java e tetë:</i>	Përgatesat parenterale me veprim të zgjatur
<i>Java e nëntë:</i>	Perfuzionet
<i>Java e dhjetë:</i>	Përgatesat oftalmike
<i>Java e njëmbëdhjetë:</i>	Format farmaceutike që përfitohen me anë të ekstraktimit
<i>Java e dymbëdhjetë:</i>	Format farmaceutike që përfitohen me anë të ekstraktimit me ujë
<i>Java e trembëdhjetë:</i>	Format farmaceutike që përfitohen me anë të ekstraktimit me alkool
<i>Java e katërbëdhjetë:</i>	Sistemet e shpërndara heterogjene
<i>Java e pesëmbëdhjetë:</i>	Emulsionet

Politikat akademike dhe Kodi i Sjelljes

*Ora mësimore fillon dhe përfundon me kohë.
Mjetet që përdorën gjatë orëve të mësimi duhet të pastrohen dhe të ruhen në fund të orës mësimore.
Telefonat mobil/të mençur dhe pajisjet tjera elektronike (p.sh. iPod-ët) duhet të fikën (apo të kurdisen në vibrim) dhe të mos ekspozohen gjatë orëve të mësimi.
Laptopët dhe kompjuterët tabletë lejohen të përdorën vetëm në heshtje; aktivitetet tjera siç janë kontrollimi i e-mailit personal apo shfletimi i ueb-faqeve në internet janë të ndaluara.*

39. KUJDESI PRIMAR NË BARNATORE

Informatat themelore për lëndën	
Njësia akademike:	Fakulteti i Mjekësisë, Dega Farmaci
Titulli i lëndës:	Kujdesi Primar në Barnatore
Niveli:	MPharm
Statusi i lëndës:	zgjedhore
Viti i studimeve:	Viti i III-të Semestri i VI-të
Numri i orëve në javë:	1+1+0
Kreditë ECTS:	3 ECTS
Koha / Vendi:	Salla F1, sipas orarit
Mësimdhënësi:	Prof Asoc Dr Kreshnik Hoti

Të dhënat kontaktuese:	Kreshnik.hoti@uni-pr.edu , 044045173		
Përshkrimi i lëndës:	Kujdesi primar në barnatore shtjellon rolin specific të farmacistit në barnatoren komunitare. Në këtë lëndë shtjellohen intervenimet e farmacistëve në barnatore komunitare në lidhje me gjendjet minore shëndetësore si: lëndimet e lehta, kokëdhimbja, sëmundja e udhëtimit, djegja nga dielli, dhimbja e fytit, kolli dhe rinitisi, reaksionet alergjike, çrregullimet minore të syve dhe lëkurës si tharja e syve, konjuktivitin , tharja e lëkurës, rashi tek foshnjët, infeksionet tinea, përdorimi i kontakt lenseve. Kujdesi primarë në këtë lëndë nënkupton edhe ekzaminimin e pacientit në barnatore, diagnostifikimin, menaxhimin në raport me gjendjet shëndetësore minore të sipërshënuara si dhe referimin e pacientit tek profesionistët përkatës shëndetësorë.		
Qëllimet e lëndës:	Qëllimet kryesore të kësaj lënde janë që studentët të arrijnë njohuritë adekuate për të vlerësuar pacientin në lidhje me shenjat dhe simptomat e gjendjeve minore që zakonisht prezantohen në barnatore si dhe të jenë në gjendje të zgjedhin intervenimin e duhur në raport me gjendjen e prezentuar, duke përfshirë referimin.		
Rezultatet e pritshme të nxënies:	<p>Me përfundimin e kësaj lënde, studentët duhet të jenë në gjendje të:</p> <ul style="list-style-type: none"> -Komunikojnë dhe vlerësojnë në mënyrë bazikë pacientin në barnatore -Vlerësojnë simptomat dhe shenjat e nevojshme për diagnostifikimin e gjendjeve minore shëndetësore -Menaxhojnë gjendjet minore në barnatore -Këshillojnë pacientët në lidhje me gjendjet minore shëndetësore -Monitorojnë gjendjet minore shëndetësore të pacientit -Referojnë pacientin tek profesionistët përkatës shëndetësorë 		
Obligimet e studentit (duhet të jetë në përputhje me Rezultatet e Nxënies të studentit)			
Aktiviteti	Orë mësimore	Ditë/Javë	Gjithsej
Ligjëratat	1	15	15
Teori/Punë në laborator/Ushtime			
Seminar	1	15	15
Konsultime me mësimdhënësin	0.5	6	3
Puna në terren	2	1	5
Testi, punimi seminarik			
Detyrë shtëpie	1	5	5
Mësimi individual (në bibliotekë apo në shtëpi)			15

Përgatitja për provimin final			5
Koha e vlerësimit (testi, kuizi, provimi final)			2
Projektet, prezantimet, etj.			10
Total			75
Metodat e mësimdhënies:	Mësimi do të mbahet në formën e ligjeratave dhe seminarit që e përmbyll mësimin në këtë lëndë. Secila temë e seminareve, prezantohet para klasës për 10-15 minuta dhe pastaj në mënyrë interaktive mësimdhënësi diskuton temën me klasën.		
Metodat e vlerësimit:	Studentët do të vlerësohen vazhdimisht. Vlerësimet specifike do të bëhen nëpërmjet tre komponenteve: 1) detyrat individuale të shtëpisë dhe pjesëmarrja aktive në klasë (20%), 2) Prezantimi seminarit (10%) dhe 3) provimit përfundimtar (70%). Nota përfundimtare e studentit do të llogaritet në bazë të mesatares nga tre komponentet e sipërsënuara.		
Literatura primare:	<p>1. Ligjëratat të përgatitura nga Prof. Asoc. Dr. Kreshnik Hoti</p> <p>2. Symptoms in the Pharmacy, 8th edition. Alison Blenkinsopp and Paul Paxton. Wiley-Blackwell 2018.</p> <p>3. Regjistri i Barnave. Agjensioni i Kosovës për Produkte Medicinale. Prishtinë, Kosovë (versioni i fundit)</p>		
Literatura shtesë:	British National Formulary 2021. Royal Pharmaceutical Society of Great Britain. London, UK.		
Hartimi i planit mësimor			
Java	Titulli i ligjëratisë		
<i>Java 1:</i>	Roli i farmacistit në barnatore		
<i>Java 2:</i>	Komunikimi me pacientin në barnatore		
<i>Java 3:</i>	Egzaminimi i pacientit në barnatore		
<i>Java 4:</i>	Referimi i pacientit tek profesionistët përkatës shëndetësorë		
<i>Java 5:</i>	Principet e këshillimit të pacientit në barnatore		
<i>Java 6:</i>	Kokëdhimbja		
<i>Java 7:</i>	Djegja nga dielli		
<i>Java 8:</i>	Menaxhimi i gjendjeve minore respiratore në barnatoren komunitare 1		
<i>Java 9:</i>	Menaxhimi i gjendjeve minore respiratore në barnatoren komunitare 2		
<i>Java 10:</i>	Menaxhimi i gjendjeve minore gastrointestinale në barnatoren komunitare 1		
<i>Java 11:</i>	Menaxhimi i gjendjeve minore gastrointestinale në barnatoren komunitare 2		
<i>Java 12:</i>	Menaxhimi i gjendjeve minore të syrit në barnatoren komunitare		
<i>Java 13:</i>	Menaxhimi i gjendjeve minore të lëkurës në barnatoren komunitare		
<i>Java 14:</i>	Menaxhimi i gjendjeve minore pediatrike në barnatoren komunitare		
<i>Java 15:</i>	Ndalja e duhanit dhe shëndeti oral		

Politikat akademike dhe Kodi i Sjelljes

Ora mësimore fillon dhe përfundon me kohë.

Mjetet që përdorën gjatë orëve të mësimit duhet të pastrohen dhe të ruhen në fund të orës mësimore. Telefonat mobil/të mençur dhe pajisjet tjera elektronike (p.sh. iPod-ët) duhet të fikën (apo të kurdisen në vibrim) dhe të mos ekspozohen gjatë orëve të mësimit.

Laptopët dhe kompjuterët tabletë lejohen të përdorën vetëm në heshtje; aktivitetet tjera siç janë kontrollimi i e-mailit personal apo shfletimi i ueb-faqeve në internet janë të ndaluara.

Plagjiazmi

Plagjiazmi do të monitorohet me rreptësi në këtë lëndë. Plagjiati ndodh kur puna ose prona e një studenti apo individit tjetër paraqitet si punë vetanake pa referim adekuat. Prandaj, punimet që dorëzohen në këtë lëndë do t'i nënshtrohen detektimit për plagjiazm.

40. Farmakovigjilenca dhe Farmakoekonomia

Informatat themelore për lëndën	
Njësia akademike:	Fakulteti i Mjekësisë
Titulli i lëndës:	Farmakovigjilenca dhe farmakoekonomia
Niveli:	MPharm
Statusi i lëndës:	Zgjedhore
Viti i studimeve:	3-të, semestri VI-të
Numri i orëve në javë:	1+1+0
Kreditë ECTS:	3 ECTS
Koha / Vendi:	Salla F1 Sipas orarit
Mësimdhënësi:	Prof.ass.dr.Mimoza Basholli-Saliu
Të dhënat kontaktuese:	mimoza.basholli@uni-pr.edu
Përshkrimi i lëndës:	<p>Kjo lëndë ofron njohuri themelore në principet e farmakovigjilencës së barnave për përdorim njerëzor, duke i bërë studentët të njihen me legjislacionin që ofron njohuri praktike për krijimin e një sistemi të përshtatshëm të farmakovigjilencës..</p> <p>Principet e farmakoekonomisë , analizat farmakoekonomike (analizat kost minimizim, analizat kost efektivitet, analizat kost benefit dhe analizat cost utilizim), modelimi në farmakoekonomi.</p>
Qëllimet e lëndës:	<p>Njohjen e studentit me principet e farmakovigjilencës, raportimin spontan, reaksionet e padëshirueshme dhe anësore të barnave dhe rregullret dhe udhëzimet në farmakovigjilencë.</p> <p>Principet e farmakoekonomisë , analizat farmakoekonomike (analizat kost minimizim, analizat kost efektivitet, analizat kost benefit dhe analizat cost utilizim), modelimi në farmakoekonomi.</p>
Rezultatet e pritshme të nxënies:	Përcakton dhe krahason konceptet e farmakovigjilencës, farmakoepidemiologjisë dhe farmakoekonomisë

	Vlerëson klasifikimin e reaksioneve/ngjarjeve të padëshiruara Diskuton dhe analizon parimet dhe praktikat e marketingut farmaceutik Përcakton procedurën e tërheqjes së produktit Shpjegon rolin e profesionistit farmaceutik në sigurinë e barnave		
Obligimet e studentit (duhet të jetë në përputhje me Rezultatet e Nxënies të studentit)			
Aktiviteti	Orë mësimore	Ditë/Javë	Gjithsej
Ligjëratat	1	15	15
Seminar	1	15	15
Punë praktike			
Konsultime me mësimdhënësin	0.5	1/15	4
Puna në terren			
Testi, punimi seminarik	1	1/5	5
Detyrë shtëpie	2	4	8
Mësimi individual (në bibliotekë apo në shtëpi)	1	1/15	15
Përgatitja për provimin final	3	2	6
Koha e vlerësimit (testi, kuizi, provimi final)	2	2	4
Projektet, prezantimet, etj.	1	3	3
Total			75 (3ECTS)
Metodat e mësimdhënies:	Ligjëratat, seminar, detyrë shtëpie individuale, projekte prezantime		
Metodat e vlerësimit:	Punimi seminarik 25% Detyrat e shtëpise 15% Provimi final 60%		
Literatura primare:	<ol style="list-style-type: none"> 1. <i>Ligjeratat e pergatitura nga mesimdhenesi</i> 2. <i>Patric Waller: Pharmacovigilance. Wiley Blackwell, 2010.</i> 3. <i>Karen Rascati. Essentials of pharmacoconomics. Wolters Klawer/Lippincott Williams and Wilkins, 2009.</i> 		
Literatura shtesë:	3. <i>Brian L. Strom. Pharmacoepidemiology. John Wiley & Sons, 2006.</i>		
Hartimi i planit mësimor			
Java	Titulli i ligjëratës		
<i>Java 1:</i>	Hyrje në farmakovigjilencë dhe siguri të barnave		
<i>Java 2:</i>	Reaksionet anësore të barnave		
<i>Java 3:</i>	Reaksionet anësore të barnave sipas sistemeve kryesore të organizmit		
<i>Java 4:</i>	Siguria e barnave në hulumtimet klinike		

Java 5:	Rregullativa dhe udhëzimet në farmakovigjilencë
Java 6:	Farmakoepidemiologjia
Java 7:	Menaxhimi i rrezikut në farmakovigjilencë
Java 8:	Komunikimi në farmakovigjilencë
Java 9:	Hyrje në farmakoekonomi
Java 10:	Metodat farmakoekonomike
Java 11:	Vlerësimi i teknologjisë shëndetësore (HTA)
Java 12:	Mjekësia e bazuar në fakte (EBM)
Java 13:	Metodologjitë për përcaktimin e çmimit të barit
Java 14:	Marketingu farmaceutik
Java 15:	Vlerësimi ekonomik në sistemin e kujdesit shëndetësor

Politikat akademike dhe Kodi i Sjelljes

Ora mësimore fillon dhe përfundon me kohë.

Mësimdhënësi dhe asistentët njoftojnë studentët për kriteret e vijueshmërisë së rregullt në ligjerata dhe ushtrime teorike dhe praktike. Ata caktojnë rregullat e mirësjelljes, mbajtje të qetësisë në ligjerata dhe ushtrime, ç'kyqjen e celularëve, ardhjen me kohë në ligjeratë/ushtrim.

Laptopët dhe kompjuterët tabletë lejohen të përdorën vetëm në heshtje; aktivitetet tjera siç janë kontrollimi i e-mailit personal apo shfletimi i ueb-faqeve në internet janë të ndaluara.

41. Receptura magjistrale

Informatat themelore për lëndën	
Njësia akademike:	Fakulteti i Mjekësisë
Titulli i lëndës:	Receptura magjistrale
Niveli:	Mpharm
Statusi i lëndës:	Zgjedhore
Viti i studimeve:	3-të, semestri VI-të
Numri i orëve në javë:	1+1+0
Kreditë ECTS:	3 ECTS
Koha / Vendi:	Salla F1 Sipas orarit
Mësimdhënësi:	Prof.ass.dr.Mimoza Basholli-Saliu
Të dhënat kontaktuese:	mimoza.basholli@uni-pr.edu
Përshkrimi i lëndës:	Organizimi i barnatores, receta, përshkrimi dhe dispensimi i barit, literatura profesionale dhe zyrtare në barnatore, përgatitja, ruajtja dhe dispensimi i përgatesave magjistrale, dozologjia.
Qëllimet e lëndës:	Qëllimi i kursit është që të fitojnë njohuri dhe aftësi në fushën e recetave, lëshimin dhe ruajtjen e barit dhe përgatitjen e përgatesave magjistrale

	<p>Njohuritë dhe aftësitë e fituara të sigurojë bazën për lëndet farmaceutike kujdesit farmaceutik, praktikës profesionale dhe trajnimit të farmacistëve.</p> <p>Duke njohur dhe duke shmangur gabimet me barna dhe papajftueshmërinë farmaceutike të rëndësishëm në përshkrimin e përgatesave magjistrale.</p>
Rezultatet e pritshme të nxënies:	<p>Aftësohet në organizimin e barnatores, vlerësimin e recetave, përshkrimit dhe dispensimit të barit.</p> <p>Analizon literaturën profesionale dhe zyrtare në barnatore.</p> <p>Vlerëson dhe përgatit përgatesën magjistrale të përshkruar në recetë.</p> <p>Tregon principet bazë lidhur me rregullimin e dozës për pacientët e moshave të ndryshme si dhe përgatit përgatesë individuale nga produktet komerciale në dispozicion.</p> <p>Llogaritjet në recetën magjistrale (doza e kontrollit, isotonizimi). Dozimi i barit, hollimi; individualizimi i terapisë, mënyra për të përshtatur dozen me nevojat e pacientëve dhe parimet për përgatitjen e një përbërje të përshtatshme të dozimit nga format e gatshme të barit .</p>

Obligimet e studentit (duhet të jetë në përputhje me Rezultatet e Nxënies të studentit)

Aktiviteti	Orë mësimore	Ditë/Javë	Gjithsej
Ligjëratat	1	15	15
Seminare	1	15	15
Teori/Punë në laborator/Ushtime			
Punë praktike			
Konsultime me mësimdhënësin	0.5	8/15	4
Puna në terren			
Kollokvium/ punimi seminarik	1	1/5	5
Detyrë shtëpie	2	4	8
Mësimi individual (në bibliotekë apo në shtëpi)	1	1/15	15
Përgatitja për provimin final	3	2	6
Koha e vlerësimit (testi, kuizi, provimi final)	2	2	4
Projektet, prezantimet, etj.	1	3	3
			75

Metodat e mësimdhënies:	Ligjëratat, seminar, detyrë shtëpie individuale, projekte prezantime
Metodat e vlerësimit:	Punimi seminarik 20% Detyrat e shtëpise 5% Prezantimi 5% Kollokvium 30% Provimi final 40%

Literatura primare:	<p>1. Ligjëratat të përgatitura nga Prof.ass.dr.Mimoza Basholli</p> <p>2. Bećirević Laćan, Mira; Begović-Dolinić, Vlasta; Buhać, Ines; Colnago, Franjka; Jurišić, Blaženka; Medić-Šarić, Marica; Nevečerel, Mirjana; Smolčić-Bubalo, Asja; Šušteršić, Tanja; Vrsalović, Mirjana, Formulae Magistrales Croaticae, Hrvatska ljekarnička komora, Zagreb, 2010.</p>
----------------------------	---

Literatura shtesë:	Materiale të siguruara nga revistat shkencore
---------------------------	---

Hartimi i planit mësimor

Java	Titulli i ligjëratës
Java 1:	Barnatorja ,praktika e mire ne barnatore.
Java 2:	Hyrje ne recepturen magjistrale
Java 3:	Dozimi i barnave dhe rregullimi i dozës
Java 4:	Etiketimi dhe ruajtja e barnave dhe substancave farmaceutike ne barnatore
Java 5:	Përgatitja dhe dhenia e barnave magjistrale dhe galenike
Java 6:	Ambalazhimi dhe etiketimi
Java 7:	Kalkulimet e dozës
Java 8:	Format farmaceutike /preparatet farmaceutike
Java 9:	Pergatitja e pluhurave per perdorim oral dhe per perdorim ne lekure
Java 10:	Preparatet e lengeta per perdorim ne lekure dhe per perdorim oral
Java 11:	Preparatet per vesh,hunde dhe mukozen orale
Java 12:	Përgatitja e përgatesave nga produktet komerciale në dispozicion
Java 13:	Recetat per diskutim –format e lëngëta
Java 14:	Receta për diskutim-format e buta
Java 15:	Receta për diskutim-format e ngurta farmaceutike

Politikat akademike dhe Kodi i Sjelljes

Ora mësimore fillon dhe përfundon me kohë.
Mësimdhënësi dhe asistentët njoftojnë studentët për kriteret e vijueshmërisë së rregullt në ligjerata dhe ushtrime teorike dhe praktike. Ata caktojnë rregullat e mirësjelljes, mbajtje të qetësisë në ligjerata dhe ushtrime, ç'kyqjen e celularëve, ardhjen me kohë në ligjeratë/ushtrim.
Laptopët dhe kompjuterët tabletë lejohen të përdorën vetëm në heshtje; aktivitetet tjera siç janë kontrollimi i e-mailit personal apo shfletimi i ueb-faqeve në internet janë të ndaluara.

42. KIMI FARMACEUTIKE 2

Informatat themelore për lëndën	
Njësia akademike:	Fakulteti i Mjekësisë/Departamenti i Farmacisë
Titulli i lëndës:	Kimi Farmaceutike 2
Niveli:	Studimet themelore
Statusi i lëndës:	I obligueshëm
Viti i studimeve:	Viti i IV Semestri i VII-të,
Numri i orëve në javë:	Semestri i VII-të 2+1+2
Kreditë ECTS:	5 ECTS
Koha / Vendi:	Departamenti i Farmacisë Sipas orarit
Mësimdhënësi:	Prof. Asist. Pranvera Breznica Selmani
Të dhënat kontaktuese:	Pranvera,breznica@uni-pr.edu
Përshkrimi i lëndës:	<p>Subjekt fundamental që merret me studimin e kimisë dhe vetive të barnave si në aspektin teorik ashtu edhe në atë praktik. Studimi i koncepteve dhe aspekteve të përgjithshme mbi barnat dhe veprimin e tyre, klasifikimin e nomenklaturën si dhe rrugët e ndryshme të zbulimit, dizajnit dhe zhvillimit. Gjithashtu në këtë kurs do të trajtohen edhe disa aspekte të sintezës dhe analizës së barnave. Kjo lëndë rezultojnë të ketë një rol esencial për tu kuptuar studimi sistematik i grupeve të ndryshme të barnave në bazë të lidhjes strukturë kimike, mekanizëm të tyre të veprimit dhe përdorimit terapeutik.</p>
Qëllimet e lëndës:	<p>Qëllimi i lëndës është të fitohen njohuri të nevojshme mbi barnat, kryesisht në aspektin kimik të barnave si dhe përfitimin dhe vlerësimin e kualitetit të tyre.</p> <p>Të fitohen njohuri të nevojshme që të arrihet lidhja mes të dhënave kimike dhe atyre biologjike respektivisht sqarimet mes strukturës kimike dhe përgjigjes në nivel molekular. Po ashtu fitimi i njohurive mbi mënyrat e ndryshme të zhvillimit të barnave të reja dhe atyre ekzistuese duke bërë modifikime strukturore për qëllim të përmirësimit të vetive fiziko-kimike ose profilit farmakokinetik dhe farmakodinamik që reflekton në përmirësimin e efikasitetit të barit. Këto njohuri ndihmojnë dhe sigurojnë që farmacisti të merr pjesë aktive në dizajnin, përfitimin dhe zhvillimin e barnave të reja.</p>
Rezultatet e pritshme të nxënies:	<ul style="list-style-type: none"> • Të fitohen njohuri për profilin farmakokinetik dhe farmakodinamik të barit. • Të fitohen njohuri rreth grupeve individuale terapeutike të barnave dhe efektet e tyre siç janë efektet sterike, induktive, elektronike dhe implikimet e tyre në veprimin e barit. • Të fitohen njohuri për modifikimet strukturore/zëvendësimi i grupeve funksionale me

	<p>qëllim të përmirësimit të vetive fizikokimike ose profilit farmakokinetik dhe farmakodinamik që reflekton në përmirësimin e efikasitetit të barit</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të fitohen njohuri të nevojshme për përdorimin e metodave analitike respektivisht metodave spektrale për identifikimin e strukturës grupeve funksionale, përcaktimin kuantitativ të lëndëve aktive si dhe përcaktimin e shkallës së pastërtisë. • Njohuri për mbledhjen dhe shfrytëzimin e informacionit kimik dhe farmaceutik në lidhje me një bar të caktuar. 		
Obligimet e studentit (duhet të jetë në përputhje me Rezultatet e Nxënies të studentit)			
Aktiviteti	Orë mësimore	Ditë/Javë	Gjithsej
Ligjëratat	2	15	30
Teori/Punë në laborator/Ushtrime	2	15	30
Punë praktike			
Konsultime me mësimdhënësin	1	5	5
Puna në terren			
Testi, punimi seminarik	1	15	15
Detyrë shtëpie			
Mësimi individual (në bibliotekë apo në shtëpi)			25
Përgatitja për provimin final			15
Koha e vlerësimit (testi, kuizi, provimi final)			3
Projektet, prezantimet, etj.	1	2	2
Total			125
Metodat e mësimdhënies:	Mësimi do të jetë i rregullt, dhe do të organizohen ligjëratat grupe, punë seminarike në grupe të vogla, zbatim i metodës PBL (problem-based learning), dhe në kuadër ushtrimeve do të aplikohen metoda analitike dhe spektrale për identifikimin e strukturave kimike të barnave, grupeve funksionale, përcaktimin kuantitativ të lëndëve aktive si dhe përcaktimin e shkallës së pastërtisë.		
Metodat e vlerësimit:	Vlerësimi i parë 15%; vlerësimi i dytë 15%; prezantimet 20%; vijimi i rregullt 10%; provimi final 40%.		
Literatura primare:	<ol style="list-style-type: none"> 7. J.M. Beale; J.Block. Wilson and Gisold's Textbook of Organic Medicinal and Pharmaceutical Chemistry; Lippincott Williams & Wilkins; 12-th Edition (March 2, 2010) 8. Richard, B. Silverman. The organic Chemistry of Drug Design and Drug Action. 2-nd edition. Academic Press. 2004. 9. Lemke TL, Williams DA, editors. Foye's principles of medicinal chemistry. Lippincott Williams & Wilkins; 2012 Jan 24. 		

Literatura shtesë:	<ol style="list-style-type: none"> 4. Wermuth CG, editor. The practice of medicinal chemistry. Academic Press; 2011 May 2. 5. Dashnor Nebija. Analiza farmaceutike farmakopeale. Manual laboratorik. Universiteti i Prishtines. 2005. 6. European Pharmacopoeia 5.0; British Pharmacopoeia; USP/NF; other national Pharmacopoeias and Compendiums
Hartimi i planit mësimor	
Java	Titulli i ligjeratës / Semestri i parë
Java 1:	Klasifikimi i hormoneve dhe barnat me veprim hormonal- Peptidet dhe hormonet peptide. Hormonet e hipofizës, hormonet e hipotalamusit. Hormonet e pankreasit. Proteinat enzimet dhe hormonet peptide-Lipotropine; Enkefalinat; Endorfinat; Oksitocina; Vazopresina;
Java 2:	Barnat për trajtimin e hipotireoidizmit dhe hipertireoidizmit- hormonet e gjëndrës tiroide; Gonadorelina dhe analogët; Somatostatina; Glukagoni; Sekretin; Gastarina
Java 3:	Histamina- barnat antihistaminke -H1 dhe H2 antihistaminikët Stabilizatorët e mastociteve; Plazmakininat Inhibitorët e kalikreine; frenuesit e leukotrieneve.
Java 4:	Antibiotikët peptidikë. Bacitracina, tirotricina, polimiksinat, Kolistine; fusafungina. Ansamicinat: rifabutine, rifamicine SV, rifampicine.
Java 5:	Lipopeptid; Fosfomicine; Antibiotiket e ndryshëm: Mupirocine; Quinupristin/Dalfopristin; Antibiotikët glikopeptide: vankomicina, teikoplanina
Java 6:	Kinolinat dhe akridinat; Antimikotikët; Anthelmintikët; Fluorokinolonet; Sulfonamidet. Imunobiologjikët
Java 7:	Barnat që veprojnë në sistemin gastrointestinal; enzimat, antacidet; Barnat antiulçeroze; frenuesit e pompës protonike; piranzepina dhe proglumidi
Java 8:	Barnat kundër kolitit ulçeroz Olsalazina; Laksativët: bulk, antrakineton, fenolftaleinë, bisakodil, glicerine, dokusat, Nitrofurantoinet; antidiarrikët; Hepatikët; Acidet Biliare Koleretikët dhe kolekinetikët.
Java 9:	Zëvendësuesit e plazmës së gjakut (volum-ekspanderët, plasma-ekspanderët; celuloza, Hipromeloza, NaCMC, alginatet pektinat; Kardiotoniket glikozide; Metilksantinat; Frenuesit e fosfodiesterazes II
Java 10:	Antiaritmiket; Aktivatorët e kanaleve të K; Lipidet në gjak, antihiperlipidemikët
Java 11:	Barnat për trajtimin e gihtit; Urikosurikët; Barnat për trajtimin e osteoporozës; Glikozaminglikanet, hijaluronanet; hijaluronidaza, hondroitinsulfat
Java 12:	Vitaminat liposolubile; Acidi orotik, ubikinonet;

Java 13:	Miorelaksantët me veprim qëndror; terapia për trajtimin e alkoolizimit; ; terapia për trajtimin e varshmërisë së nikotinës
Java 14:	Mjetet e kontrastit; Zëvendësuesit e sheqerit, ëmbëltuesit artificial
Java 15:	Seminare

Politikat akademike dhe Kodi i Sjelljes

- Këshilli i njësisë akademike i përjashton nga Universiteti përgjithmonë ose përkohësisht studentët që i shkelin rëndë rregullat. Studentët e akuzuar për shkelje kanë të drejtë të dëgohen nga komisioni disiplinor i cili e këshillon këshillin e njësisë akademike. Studentët e përjashtuar kanë të drejtë t'i ankohen Senatit i cili mund të konfirmojë ose të refuzojë vendimin e këshillit të njësisë akademike.
- Rregulloret që i elaborojnë këto procedura nxirren nga Senati pasi të jenë konsultuar me parlamentin e studentëve.
- Studentët kanë të drejtë të ankohen kundër vendimit të marrë prej organeve të Universitetit, të njësisë akademike dhe njësisë organizative që kanë të bëjnë me të drejtat, obligimet dhe përgjegjësitë e tyre.
- Ankesat e tilla i dorëzohen komisionit të studimeve të njësisë akademike brenda 15 ditëve të punës pas shpalljes së vendimit.
- Komisioni i studimeve është i obliguar t'ia dorëzojë raportin për vendimin e marrë këshillit të njësisë akademike brenda 30 ditëve të punës pas pranimit të ankesës.
- Ankesa rreth vendimit në shkallë të parë vendoset nga Senati.

43. BIOFARMACI ME FARMAKOKINETIKË

Informatat themelore për lëndën	
Njësia akademike:	Fakulteti i Mjekësisë, Dega Farmaci
Titulli i lëndës:	BIOFARMACI ME FARMAKOKINETIKË
Niveli:	Studimet bazike te integruara
Statusi i lëndës:	I obligueshëm
Viti i studimeve:	Viti i IV-rë Semestri i I dhe II-të
Numri i orëve në javë:	2+1+2/2+1+2
Kreditë ECTS:	5+5 ECTS
Koha / Vendi:	Klasa F1 Sipas orarit
Mësimdhënësi:	Prof.ass.dr.Arlinda Daka Grapci
Të dhënat kontaktuese:	Arlinda.daka@uni-pr.edu 044199193
Përshkrimi i lëndës:	Përshkrimi kualitativ dhe kuantitativ i kinetikës së përthithjes, shpërndarjes, metabolizmit dhe eliminimit të barnave, duke përfshirë edhe faktorët fiziologjikë të cilët influencojnë secilin proces. Biofarmacia adreson vetitë fiziko-kimike të barnave, formën e dozimit farmaceutik dhe biodisponibilitetin e barnave në formën e tyre farmaceutike dhe mënyrën e arritjes së bio-disponibilitetit optimale përmes studimit të ndërveprimeve midis barit, formës së tij të dozimit dhe substratit biologjik

	Farmakokinetika studion rrjedhën kohore të përqendrimit të barit në gjak në aspektin matematikor, prandaj një performancë e formave të dozimit mund të vlerësohet në terma të shpejtësisë dhe sasisë së barit që arrin në gjak dhe regjimi i dozimit mund të rregullohet duke synuar të arrihet përqendrimi efektiv terapeutik i barnave në organizëm.		
Qëllimet e lëndës:	Qëllimi primar i këtij kursi është të ofroj një bazë konceptuale dhe kuantitative në teorinë dhe aplikimet farmakokinetike/biofarmaceutike të nevojshme për vazhdimin e studimeve me te avansuara farmakokinetike klinike dhe biofarmaceutike.		
Rezultatet e pritshme të nxënies:	Sigurimi i njohurive të mjaftueshme mbi ndryshimin e përqendrimit të barit në materialin biologjik. Kalkulimi i parametrave farmakokinetike duke u nisur nga përqendrimet e barit në lëngjet biologjike Dizajnimi i regjimeve adekuate të dozimit për arritjen e përqendrimeve terapeutike në një pacient . Sigurimi i njohurive të nevojshme për aplikimin e principeve fizikokimike dhe teknologjike për arritjen e biodisponibilitetit optimal të barnave.		
Obligimet e studentit (duhet të jetë në përputhje me Rezultatet e Nxënies të studentit)			
Aktiviteti	Orë mësimore	Ditë/Javë	Gjithsej
Ligjëratat	2	30	60
Teori/Punë në laborator/Ushtime	2	30	60
Punë praktike			
Konsultime me mësimdhënësin	0.5	12	6
Puna në terren			
Testi, punimi seminarik	1	30	30
Detyrë shtëpie	1	14	14
Mësimi individual (në bibliotekë apo në shtëpi)	1	40	40
Përgatitja për provimin final	5	8	40
Projektet, prezantimet, etj.			
Total			250
Metodat e mësimdhënies:	Mësimi është i rregullt dhe organizohet në formë të ligjëratave dhe seminareve në grupe më të mëdha duke shfrytëzuar metodat moderne të mësimdhënies si diskutimin interaktiv, ndërsa praktika laboratorike (ushtrimet) organizohen me grupe të vogla të studentëve.		
Metodat e vlerësimit:	Pjesëmarrja dhe angazhimi në ligjerata dhe ushtime 10% Pjesëmarrja dhe angazhimi në seminare 30% Provimi final 60% Gjithsej 100%		

Literatura primare:	<i>L. Shargel, A. Yu. Applied Biopharmaceutics & Pharmacokinetics, McGraw-Hill Medical 7-th Edition</i>
Literatura shtesë:	Rosenbaum SE, editor. Basic pharmacokinetics and pharmacodynamics: An integrated textbook and computer simulations, John Wiley & Sons 2nd Edition, 2016. M. Gibaldi, D. Perrier. Pharmacokinetics. Informa Healthcare, 2-nd Edition (1982) ISBN 13: 13-978-0824710422. Dashnor Nebija. Biofarmacia me Farmakokinetikë. Kapituj të zgjedhur. Dispenca. Prishtinë, 2010
Hartimi i planit mësimor	
Java	Titulli i ligjëratës
<i>Java 1:</i>	Biofarmacia dhe Farmakokinetika bazike: koncepti dhe objektivat e përgjithshme.
<i>Java 2:</i>	Kinetika e proceseve LADME.
<i>Java 3:</i>	Lakoret e nivelit plazmatik dhe ekskrecionit urinar.
<i>Java 4:</i>	Modele kompartmentale në farmakokinetikë
<i>Java 5:</i>	Analiza jokompartimentale dhe modelimi fiziologjik.
<i>Java 6:</i>	Kinetika e dozave unike. Bolusi intravenoz. Modeli njekompartimental.
<i>Java 7:</i>	Bolusi intravenoz. Modeli multikompartimental
<i>Java 8:</i>	Infuzioni intravenoz
<i>Java 9:</i>	Eliminimi i barit, klirensi dhe klirensi renal
<i>Java 10:</i>	Administrimi i barnave dhe përthithja e barnave
<i>Java 11:</i>	Administrimi ekstravaskular. Modeli njekompartimental
<i>Java 12:</i>	Administrimi ekstravaskular. Modeli bikompartimental.
<i>Java 13:</i>	Kinetika e dozave të shumfishta. Regjimet e dozimit.
<i>Java 14:</i>	Farmakokinetika jolineare
<i>Java 15:</i>	Distribucioni fiziologjik i barnave dhe lidhja me proteina
<i>Java 16:</i>	Eliminimi i barnave dhe klirensi hepatic
<i>Java 17:</i>	Hyrje në Farmakogjenetikë
<i>Java 18:</i>	Metabolizmi i Barnave
<i>Java 19:</i>	Faktorët fiziologjikë që lidhen me përthithjen e barnave
<i>Java 20:</i>	Modele që përdoren për të parashikuar ndërveprimet bar– bar për barnat e administruara oral
<i>Java 21:</i>	Modelimi farmakokinetik i bazuar në fiziologji
<i>Java 22:</i>	Konsideratat biofarmaceutike në dizajnin e barnave dhe performancën e barnave in vitro
<i>Java 23:</i>	Biodisponibiliteti
<i>Java 24:</i>	Metodologjia e studimit të Bioekuivalences
<i>Java 25:</i>	Ndikimi i biofarmaceutikës në cilësinë e barnave dhe efikasitetin klinik
<i>Java 26:</i>	Barnat me çlirim të modifikuar
<i>Java 27:</i>	Marrëdhënia midis farmakokinetikës dhe farmakodinamikës
<i>Java 28:</i>	Monitorimi i përqendrimeve plazmatike të barnave.

Java 29:	Zbatimi i farmakokinetikës në grupet specifike të popullatës: pacientët geriatrik, obez dhe pediatrik
Java 30:	Rregullimi i dozës në sëmundjen renale dhe hepatike

Politikat akademike dhe Kodi i Sjelljes

Ora mësimore fillon dhe përfundon me kohë.

Mjetet që përdorën gjatë orëve të mësimit duhet të pastrohen dhe të ruhen në fund të orës mësimore. Telefonat mobil/të mençur dhe pajisjet tjera elektronike (p.sh. iPod-ët) duhet të fikën (apo të kurdisen në vibrim) dhe të mos ekspozohen gjatë orëve të mësimit.

Laptopët dhe kompjuterët tabletë lejohen të përdorën vetëm në heshtje; aktivitetet tjera siç janë kontrollimi i e-mailit personal apo shfletimi i ueb-faqeve në internet janë të ndaluara.

44. Teknologji Farmaceutike 2

Informatat themelore për lëndën	
Njësia akademike:	Fakulteti i Mjekësisë
Titulli i lëndës:	Teknologji Farmaceutike 2
Niveli:	Studime te integruara
Statusi i lëndës:	I obligueshëm
Viti i studimeve:	IV, semestri VII
Numri i orëve në javë:	2+1+2
Kreditë ECTS:	5 ECTS
Koha / Vendi:	Salla F1 Sipas orarit
Mësimdhënësi:	Prof.ass.dr.Mimoza Basholli-Saliu
Të dhënat kontaktuese:	Mimoza.basholli@uni-pr.edu
Përshkrimi i lëndës:	Lënda Teknologji Farmaceutike është shkencë e cila studion formulimin (dizajnimin dhe evaluimin), përgatitjen/prodhimin dhe vlerësimin e formulimeve farmaceutike, për të siguruar që bari të arrijë në vendin e veprimit në kohën e duhur dhe në përqendrimin terapeutik. Për më tepër studion principet themelore të eksipientëve, ndërveprimet në mes tyre dhe me lëndën aktive, si dhe ndikimin e tyre në qëndrueshmërinë dhe efektshmërinë e barit si dhe në karakteristikat e formave farmaceutike.
Qëllimet e lëndës:	Njohja e studentit me format farmaceutike makroheterogjene, tipet kryesore, karakteristika fiziko-kimike të tyre si dhe ndikimin e eksipientëve në karakteristikat dhe qëndrueshmërinë. Zhvillimin e aftësisë së studentit në formulimin, përgatitjen dhe vlerësimin e sistemeve makroheterogjene. Aftësimi në dizjnimin, paraformulimin, formulimin dhe përgatitjen e formave të ngurta farmaceutike (pluhurat dhe granulat). Përmes përfshirjes së nanoteknologjisë farmaceutike (nano sistemet), studenti do të aftësohen në dallimin e formave standard dhe novele të dozimit të barnave.

Rezultatet e pritshme të nxënies:	<p>Përcakton dhe krahason formulime të ndryshme të të barnave dhe rendit përparësitë dhe të metat e përdorimit të tyre;</p> <p>Përshkruan dhe analizon zbatimin e eksipientëve të ndryshëm farmaceutikë në prodhimin e produkteve farmaceutike dhe ndikimin e tyre në stabilitetin dhe efikasitetin terapeutik të barnave;</p> <p>Përcakton dhe përshkruan metodat e përgatitjes së formave të ndryshme të dozimit të barnave, analizon avantazhet / disavantazhet e tyre dhe vlerëson ndikimin e tyre në stabilitetin dhe efikasitetin terapeutik të barnave;</p> <p>Përzgjedhn kushtet dhe teknologjinë e duhur të përgatitjes bazuar në vetitë fiziko-kimike të barnave / lëndëve ndihmësve, rrugën e aplikimit dhe grupet e synuara të pacientëve;</p> <p>Vlerëson papajtueshmëritë përkatëse teknologjike midis barnave, lëndëve ndihmësve dhe / ose materialit ambalazhues;</p> <p>Planifikon, organizon dhe siguron procedurat e paraformulimit, formulimit dhe karakterizimit të sistemeve standarde dhe të reja të shpërndarjes së barit.</p> <p>Jep shembuj të pluhurave medicinale, që përshkruhen në recetë dhe produkte pa recetë.</p>
--	---

Obligimet e studentit (duhet të jetë në përputhje me Rezultatet e Nxënies të studentit)

Aktiviteti	Orë mësimore	Ditë/Javë	Gjithsej
Ligjëratat	2	15	30
Teori/Punë në laborator/Ushtime	2	15	30
Seminare	1	15	15
Punë praktike			
Konsultime me mësimdhënësin	0.5	8/15	4
Puna në terren			
Testi, punimi seminarik	1	4	4
Detyrë shtëpie			
Mësimi individual (në bibliotekë apo në shtëpi)	2	15	30
Përgatitja për provimin final	2	4	8
Koha e vlerësimit (testi, kuizi, provimi final)	1	4	4
Projektet, prezantimet, etj.			
Total			125

Metodat e mësimdhënies:	Ligjëratat, ushtrimet laboratorike, seminar, detyra grupore
Metodat e vlerësimit:	Punimi seminarik 10% Provimi praktik 10% Aktiviteti në ligjërata 5% Provimi final 75% Në provimin teorik studenti mund të hyjë, nëse paraprakisht ka arrit 51% të provimit praktik. Vlerësimi përfundimtar:

	55-64%-6 65-74%-7 75-84% -8 85-94% - 9 95%-100% -10
Literatura primare:	1. <i>Ligjëratat të përgatitura nga Prof.ass.dr.Mimoza Basholli</i> 2. <i>Teknologjia Farmaceutike, Prof. Dr. Skënder Durrësi</i> 2. <i>Pharmaceutical dosage form and drug delivery system, Loyd V. Allen, Nicholas G. Popovich, Hoëard C. Ansel</i>
Literatura shtesë:	1. <i>Pharmaceutics, The science of dosage form design, M.E. Aulton</i> 2. <i>Encyclopedia of Pharmaceutical Technology, volume 17, James Boylan, James Blertrick</i> 3. <i>The science and practice of Pharmacy, Remington, 21st edition</i> 4. <i>Përgatitjet galenike dhe kozmetike në laborator, Prof. Dr. Skënder Durrësi</i> 5. <i>Pharmaceutical preformulation and formulation, Mark Gibson</i>
Hartimi i planit mësimor	
Java	Titulli i ligjëratës
<i>Java 1:</i>	Sistemet makroheterogjene, faktorët që ndikojnë në vetitë reologjike-Lëndët aktive sipërfaqësore
<i>Java 2:</i>	Emulsionet – formulimi dhe përgatitja
<i>Java 3:</i>	Vetitë reologjike, stabiliteti fizik dhe kontrolli i cilësisë së emulsioneve
<i>Java 4:</i>	Suspensionet, formulimi dhe përgatitja
<i>Java 5:</i>	Vetitë reologjike, stabiliteti fizik dhe kontrolli i cilësisë së suspensioneve
<i>Java 6:</i>	Mikro dhe nanoemulsionet, mikro dhe nano suspensionet
<i>Java 7:</i>	Aerosolet- formulimi, përgatitja dhe kontrolli i cilësisë
<i>Java 8:</i>	Aerosolet inhaluese (të lëngëta dhe të ngurta)
<i>Java 9:</i>	Dizajnimi dhe zhvillimi i formave të ngurta farmaceutike
<i>Java 10:</i>	Pluhurat farmaceutikë, përgatitja e tyre
<i>Java 11:</i>	Karakteristikat fiziko-kimike, madhësia e grimcave dhe vetitë reologjike të pluhurave
<i>Java 12:</i>	Pluhurat e dozuar dhe të padozuar
<i>Java 13:</i>	Mikrogramet dhe nanogramet-përgatitja dhe aplikimi
<i>Java 14:</i>	Granulat
<i>Java 15:</i>	Lipozomet, metodat e përgatitjes, analiza farmaceutiko-teknologjike dhe biofarmaceutike, aplikimi
Politikat akademike dhe Kodi i Sjelljes	
<i>Ora mësimore fillon dhe përfundon me kohë.</i> Mësimdhënësi dhe asistentët njoftojnë studentët për kriteret e vijueshmërisë së rregullt në ligjerata dhe ushtrime teorike dhe praktike. Ata caktojnë rregullat e mirësjelljes, mbajtje të qetësisë në ligjerata dhe ushtrime, ç'kyqjen e celularëve, ardhjen me kohë në ligjeratë/ushtrim.	

Laptopët dhe kompjuterët tabletë lejohen të përdorën vetëm në heshtje; aktivitetet tjera siç janë kontrollimi i e-mailit personal apo shfletimi i ueb-faqeve në internet janë të ndaluara.

45. BROMATOLOGJI

Informatat themelore për lëndën	
Njësia akademike:	Fakulteti i Mjekësisë, Dega e Farmacisë
Titulli i lëndës:	Bromatologji
Niveli:	Diplomë universitare
Statusi i lëndës:	I obligueshëm
Viti i studimeve:	Viti i IV-të Semestri i VII-të dhe VIII-të
Numri i orëve në javë:	Semestri VII: 2+0+2 Semestri VIII: 2+1+1
Kreditë ECTS:	8 ECTS
Koha / Vendi:	Sipas orarit
Mësimdhënësi:	Prof.ass.dr. Zana Sulejmani-Ibraimi
Të dhënat kontaktuese:	Email: zana.ibraimi@uni-pr.edu Tel: +38344330362
Përshkrimi i lëndës:	Bromatologjia është shkencë që merret me studimin e ushqimit në përgjithësi dhe në veçanti ajo bën zbulimin dhe seleksionimin e materieve të papërpunuara të tij, duke përfshirë këtu përbërjen, vlerat ushqyese, përpunimin, prodhimin, paketimin, ruajtjen dhe sigurinë e tyre, si dhe përgatit produkte të gatshme për analiza ndijimore dhe për konsum të gjerë njerëzor. Bromatologjia është një disiplinë që ka lidhje të ngushta me shkencat farmaceutike e mjekësore. Ajo jep një kontribut të çmuar në edukimin korrekt të të ushqyerit, përmes ushqimeve të sigurta e cilësore, duke parandaluar dhe menaxhuar rastet e ndërveprimeve në mes të barnave dhe ushqimit, si dhe mbipeshës, obezitetit, anoreksive, alergjive ushqimore e intolerancave ndaj ushqimeve të veçanta.
Qëllimet e lëndës:	Qëllimet e kësaj lënde janë njohja dhe aftësimi i studentëve me parimet bazë të Bromatologjisë, përforcimi i njohurive të fituara nga mësimi teorik, duke i zbatuar ato në praktikë. Kjo disiplinë me rëndësi ka për objektive të transmetojë te studentët njohuri të plota e bashkëkohore mbi: <ul style="list-style-type: none"> - shkencën e të ushqyerit (nutricionizmin) dhe zinxhirin ushqimor, llogaritjet energjitike për metabolizmin bazë; - sistemet kryesore biokimike ushqimore dhe rolin e tyre në organizmin e njeriut – strukturën e ushqimeve që bëjnë pjesë te këto sisteme, sterilizimin, paketimin, konservimin dhe ruajtjen, aspektet e sigurisë dhe cilësisë; - produktet dietetike, përzgjedhjen, konsumin dhe rolin e tyre në organizëm; - lidhjet dhe ndërveprimet e mundshme në mes të produkteve ushqimore dhe barnave.

Rezultatet e pritshme të nxënies:	<p>Studentët duhet të mësojnë të bëjnë kontrollin cilësor dhe sasior të parametrave të ndryshëm të produkteve ushqimore.</p> <p>Të njihen me problemet e ndryshme që mund të dalin dhe ndryshimet që mund të ndodhin gjatë ruajtjes së produkteve ushqimore në kushte normale dhe ato të vështira jo normale.</p> <p>T'i mësojnë vlerat ushqyese të produkteve ushqimore dhe ndërlihdjet/ndërveprimet e tyre me barnat.</p> <p>T'i mësojnë principet ushqimore dhe domosdoshmërinë që organizmi ka për to, në mënyrë që të arrijnë të transmetojnë te të tjerët kulturën e të ushqyerit në dobi të shëndetit dhe mirëqënies së organizmit.</p>
--	--

Obligimet e studentit (duhet të jetë në përputhje me Rezultatet e Nxënies të studentit)

Aktiviteti	Orë mësimore	Ditë/Javë	Gjithsej
Ligjëratat	2	30	60
Teori/Punë në laborator/Ushtime	2	30	60
Punë praktike			
Konsultime me mësimdhënësin	1	3	3
Puna në terren			
Testi, punimi seminarik	1	15	15
Detyrë shtëpie			
Mësimi individual (në bibliotekë apo në shtëpi)	2	15	45
Përgatitja për provimin final	2	15	30
Koha e vlerësimit (testi, kuizi, provimi final)			2
Projektet, prezantimet, etj.			
Total			200 orë

Metodat e mësimdhënies:	<p>Ligjeratat mbahen në formë interaktive. Prezentimi bëhet në LCD projektor, ndërsa ushtrimet mbahen çdoherë në laborator dhe janë gjithmonë të mbikëqyrura. Puna laboratorike zhvillohet në grupe, duke diskutuar me studentë lidhur me problematikën e paraqitur të kontrollit të cilësisë, sasisë dhe freskisë së produkteve ushqimore. Studentët punojnë në grupe nga dy, së pari shqyrtohen principet bazë për punën që do të kryhet dhe pastaj shtjellohen problemet individuale që hasen gjatë punës praktike.</p>
--------------------------------	--

Metodat e vlerësimit:	<p>Metoda e vlerësimit bëhet me teste dhe kollokfiume. Provimi zhvillohet me shkrim, ku çdo pyetje në test dhe kollokfium vlerësohet me një numër pikësh.</p> <p>Komisioni i provimit përbëhet nga 2 pedagogë (profesori dhe asistenti i lëndës).</p> <p>Mënyra e vlerësimit:</p> <table> <tr> <td>Provimi praktik</td> <td align="right">20 %</td> </tr> <tr> <td>Kollokfiumi</td> <td align="right">10 %</td> </tr> <tr> <td>Seminaret apo angazhime tjera</td> <td align="right">10 %</td> </tr> <tr> <td>Vijimi i rregullt në ligjërata dhe ushtime</td> <td align="right">10 %</td> </tr> </table>	Provimi praktik	20 %	Kollokfiumi	10 %	Seminaret apo angazhime tjera	10 %	Vijimi i rregullt në ligjërata dhe ushtime	10 %
Provimi praktik	20 %								
Kollokfiumi	10 %								
Seminaret apo angazhime tjera	10 %								
Vijimi i rregullt në ligjërata dhe ushtime	10 %								

	Provimi final Gjithsej:	50 % 100 %
	Konsultimet me studentë bëhen 2(dy) herë në javë. Seminaret organizohen 2(dy) gjatë një viti shkollor.	
Literatura primare:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Belitz HD, Grosch W, Schieberle P. Food Chemistry, 4th ed. Berlin 2009. 2. Nielsen SS. Food Analysis Laboratory Manual, 2nd ed. SHBA 2010. 3. Leea DH, Rhods and Stoch RD, Biochemistry. Londër 2002. 4. Fidanza F. "Alimentazione e Nutrizione Umana" Idelson Gnocchi, 2005. 5. Shewfelt RL, Orta-Ramirez A, Clarke AD. Introducing food science. CRC Press; 2015 Aug 28. 6. Edelstein S, editor. Food science: An ecological approach. Jones & Bartlett Publishers; 2014. 7. Troja R. Kimia dhe Teknologjia e Ushqimeve. Tiranë 2001. 8. Troja R. Praktikum i Biokimisë Ushqimore. Tiranë 2001. 9. Papas AM, editor. Antioxidant status, diet, nutrition, and health. CRC press; 2019 Oct 16. 	
Literatura shitesë:	Nga publikimet në internet (PubMed, MedLine, etj)	
Hartimi i planit mësimor		
Java	Titulli i ligjëratës	
<i>Java 1:</i>	Hyrje, objekti i studimit dhe rëndësia e shkencës së Bromatologjisë	
<i>Java 2:</i>	Lidhja e Bromatologjisë me Farmacinë	
<i>Java 3:</i>	Komponentët e ushqimit	
<i>Java 4:</i>	Rëndësia e ujit në trupin e njeriut	
<i>Java 5:</i>	Uji në produktet ushqimore	
<i>Java 6:</i>	Yndyrnat dhe vajrat	
<i>Java 7:</i>	Karbohidratet	
<i>Java 8:</i>	Proteinat dhe aminoacidet	
<i>Java 9:</i>	Vitaminat e tretshme në yndyrna	
<i>Java 10:</i>	Vitaminat e tretshme në ujë	
<i>Java 11:</i>	Kripërat minerale	
<i>Java 12:</i>	Ndërveprimet në mes të lëndëve ushqyese dhe vitaminave e mineraleve (makro dhe mikronutrientëve)	
<i>Java 13:</i>	Energjia për metabolizmin bazë, vlerat energjetike-kalorike dhe formulat për llogaritjet energjetike	
<i>Java 14:</i>	Suplementet ushqimore	
<i>Java 15:</i>	Fitokemikalet dhe antioksidantët	
<i>Java 16:</i>	Qumështi dhe produktet e tij, struktura dhe përmbajtja; vetitë dhe vlerat ushqimore	
<i>Java 17:</i>	Mishi dhe produktet e tij, struktura dhe përmbajtja; vetitë dhe vlerat ushqimore	
<i>Java 18:</i>	Mishi i peshkut, struktura dhe përmbajtja; vetitë dhe vlerat ushqimore	
<i>Java 19:</i>	Veza dhe vlerat ushqyese të saj; përbërja, konsumi dhe ruajtja	

Java 20:	Vajrat e ngrënshme ushqimore dhe klasifikimi. Hidrogjenimi i yndyrave dhe prodhimi i margarinës
Java 21:	Drithërat dhe fibrat ushqimore
Java 22:	Mjalta, përbërja, vlerat ushqyese dhe roli i saj në organizëm
Java 23:	Pemët, përbërja kimike e tyre dhe vlerat ushqyese
Java 24:	Perimet, përbërja kimike e tyre dhe vlerat ushqyese
Java 25:	Pijet alkoolike dhe uthulla
Java 26:	Aditivët ushqimorë, klasifikimi - grupet kryesore, roli në ushqime dhe organizëm
Java 27:	Ndotja e produkteve ushqimore, agjentët e shkatërrimit të produkteve ushqimore dhe mekanizmat e shkatërrimit
Java 28:	Konzervimi, sterilizimi dhe ruajtja e produkteve ushqimore
Java 29:	Ndërveprimet në mes të ushqimeve dhe barnave
Java 30:	Alergjitë dhe intolerancat ushqimore

Politikat akademike dhe Kodi i Sjelljes

Ora mësimore fillon dhe përfundon me kohë.

Mjetet që përdoren gjatë orëve të mësimit duhet të pastrohen dhe të ruhen në fund të orës mësimore. Profesori dhe asistenti i informojnë studentët për kriteret e pjesëmarrjes së rregullt në ligjërata dhe ushtrime. Ata i përcaktojnë rregullat e sjelljes, siç janë mbajtja e qetësisë gjatë ligjëratave dhe ushtrimeve, saktësia e ardhjes në kohë të duhur në ligjërata dhe ushtrime, fikja e telefonave celularë, apo ndonjë mjeti tjetër të mençur, etj.

Profesori dhe asistenti duhet të tregojnë qëndrim intelektual, pragmatik dhe kolegial, duke i inkurajuar gjithnjë studentët drejt suksesit.

Shënim | Nëse 3 detyra të klasës të një studenti vlerësohen nën 50%, atëherë ai/ajo do ta humbë të drejtën që t'i nënshtrohet provimit final. Vlerësimi bëhet nga 0-100 %.

46. KIMI TOKSIKOLOGJIKE

Informatat themelore për lëndën	
Njësia akademike:	Fakulteti i Mjekësisë, Dega e Farmacisë
Titulli i lëndës:	Kimi toksikologjike
Niveli:	Diplomë universitare
Statusi i lëndës:	I obligueshëm
Viti i studimeve:	Viti i IV-të Semestri i VII-të dhe VIII-të
Numri i orëve në javë:	Semestri VII: 2+0+2 Semestri VIII: 2+1+2
Kreditë ECTS:	9 ECTS
Koha / Vendi:	Sipas orarit
Mësimdhënësi:	Prof.ass.dr. Zana Sulejmani-Ibraimi
Të dhënat kontaktuese:	Email: zana.ibraimi@uni-pr.edu Tel: +38344330362
Përshkrimi i lëndës:	Kimia toksikologjike është disiplinë shkencore, e cila merret me studimin e efekteve toksike të substancave të ndryshme në organizmat e gjallë dhe pasojave që mbesin pas këtyre helmimeve. Kjo disiplinë shpjegon ndërveprimet në mes të substancave kimike dhe sistemeve biologjike, të cilat shkaktojnë efekte të

	dëmshme që ndikojnë në jetën apo funksionimin normal të organizmave të gjallë. Kimia toksikologjike, gjithashtu studion natyrën, mekanizmat e veprimit dhe faktorët që ndikojnë në zhvillimin e këtyre dëmeve, trajtimin e helmimeve dhe kundrahelmet përkatëse, metodat e marrjes së mostrave, identifikimin dhe përcaktimin e substancave toksike në mostrat biologjike dhe mjedisore, si dhe metodat e përcaktimit të helmeve në mjedis.
Qëllimet e lëndës:	Qëllimet e kësaj lënde janë njohja dhe aftësi i studentëve me parimet bazë të Kimisë toksikologjike, aftësi i tyre për kryerjen e analizave rutinore të karakterizimit të faktorëve, të cilët mund të ndikojnë në efektin toksikologjik, siç janë: mënyra e ekspozimit të helmit (rruga e futjes së helmit), njohja e specifikave të një substance të huaj në trup dhe simptomave të helmimit, duke parashikuar mekanizmin e veprimit të helmit, metabolizmin dhe llojin e metabolitit, mënyrën e eliminimit nga trupi, sigurimin e ndihmës së parë dhe gjetjen e antidotit përkatës, njohjen e metodave analitike të marrjes së mostrave dhe përcaktimin e helmeve në mostrat biologjike e mjedisore.
Rezultatet e pritshme të nxënies:	Studentët do të mësojnë konceptet themelore toksikologjike dhe parimet e bashkëveprimit të toksinave e toksikantëve me trupin e njeriut (përthithjen, shpërndarjen, metabolizmin dhe eliminimin e toksinave nga trupi). Ata do të kuptojnë mekanizmat biokimikë të toksicitetit të helmit, do të njohin llojet e ndryshme të efekteve anësore, përshkruajnë karakteristikat toksikokinetike të helmeve dhe do të kuptojnë procedurat themelore terapeutike, si ndihma urgjente në helmime dhe antidotët. Studentët do të jenë në gjendje të lidhin vlerësimin e rrezikut dhe sigurinë nga helmet me shëndetin e njeriut dhe mjedisin. Ata gjithashtu do të njihen me klasifikimin dhe etiketimin e kimikateve, menaxhimin dhe trajtimin e sigurte.

Obligimet e studentit (duhet të jetë në përputhje me Rezultatet e Nxënies të studentit)

Aktiviteti	Orë mësimore	Ditë/Javë	Gjithsej
Ligjëratat	2	30	60
Teori/Punë në laborator/Ushtime	2	30	60
Punë praktike			
Konsultime me mësimdhënësin			3
Puna në terren			
Testi, punimi seminarik	1	15	15
Detyrë shtëpie			
Mësimi individual (në bibliotekë apo në shtëpi)	2	15	45
Përgatitja për provimin final	1	1	40

Koha e vlerësimit (testi, kuizi, provimi final)			2												
Projektet, prezantimet, etj.															
Total			225												
